

MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE TË SHQIPËRISË ME AUTORITET E HUAJA NË PROCESIN PENAL

(Fokusuar në letërporositë ndërkombëtare
për periudhën pas ndryshimeve demokratike të viteve '90)

Ermira Tafani

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në “Shkencat
Juridike”, me profil “E drejtë penale”, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Numri i fjalëve: 53243

Tiranë, Janar 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë Ermira Tafani, në cilësinë e autores së këtij studimi, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë, që ky studim është një punë origjinale e imja, duke pasqyruar me korrektësi referencat, citimet dhe burimet e informacionit të marrë.

ABSTRAKTI

Letërporositë ndërkombëtare, sinjenga format e bashkëpunimit midis shteteve në procesin penal, kanë vëmendje mbarëbotërore dhe paraqesin interes për t'u studiuar, sepse përmes tyre arrihet bashkëpunim i mirë me autoritetet e huaja dhe efikasitet në luftën kundër krimit. Hipoteza e këtij studimi **“Pavarësisht arritjeve në përpunimin e një kuadri juridik të plotë dhe të përshtatshëm përsa i përket zbatimit të letërporosive ndërkombëtare si një nga format e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, praktika dëshmon ende mangësi, kapërcimi i të cilave do të kërkonte përf forcimin e dijeve dhe përkushtimit për zbatimin e akteve dhe dispozitave ekzistuese apo edhe ndërhyrjen në legjislacion për plotësimin e vakumeve eventuale”** është vërtetuar nëpërmjet një metodologjie të përbërë nga metodat e kërkimit shkencorë e krahasimit, pasi që cilësore që janë bazuar fillimisht mbi forma deduktive logjike, duke pasur parasysh qëllimin kryesor të përgjithësimin të faktit të ekzistencës së legjislacionit të plotë në fushën e studimit, fakt ky që ka qënë i parashikuar, shpjegohet me anë të studimit dhe vërtetohet nga ai. Nëpërmjet kësaj metodologjie është bërë analiza e bazës ligjore, jo vetëm në aspektin teorik dhe atë përshkrues, por edhe duke krahasuar legjislacionin shqiptar me aktet ndërkombëtarë dhe legjislacionet e Italisë dhe Maqedonisë në fushën objekt studimi. Hipoteza është testuar gjatë analizës në studim duke përdorur edhe të dhënat e mbledhura nga instrumenti i pyetsorit, nëpërmjet të cilit janë identifikuar

problemet e praktikës. Në përfundim të studimit është provuar hipoteza, duke arritur në konkluzionin, se kuadri ligjor i Shqipërisë në fushën e studimit është i plotë, por në praktikë ndeshen mjaft probleme për zgjidhje. Në lidhje me këto probleme janë dhënë edhe sugjerimet përkatëse.

Fjalë Kyçe: *letërporosi ndërkombëtare, proces penal, bashkëpunim gjyqësor, autoritete të huaja, marrëdhënie juridiksionale*

ABSTRACT

International rogatory letters, as one of the cooperation forms among states in criminal process, have worldwide attention and are of great interest for further studies, due to their effectiveness in the struggle against crime, if a good cooperation with the foreign authorities is reached. The hypothesis of this study is: “Regardless of the achievements in elaborating a complete and appropriate juridical framework concerning the implementation of international rogatory letters as one of the judicial relations with foreign authorities in criminal process, practice shows that there are still deficiencies, which seek a better professional education and a strong commitment for the implementation of the existing acts and laws and the changes of the legislation for completing the eventual vacuums”. The researcher tries to prove this hypothesis through a variety of research methods as: comparative method, qualitative and quantitative research methods, which are based on logical deductive forms, keeping in mind the existence of the complete legislation in the field of study, a fact which has been foreseen, explained and proven by the study. Through this methodology of study the analysis of the legal framework is done, not only theoretically and descriptively, but at the same time comparing the Albanian legislation with the international acts and the legislation of Italy and Macedonia in this field of study. The hypothesis is tested and proven through analysis of the data gathered from research

instruments as questionnaires, surveys and interviews, which helped to identify the problems of the judicial practice.

Key words: *international rogatory letters, criminal process, judicial cooperation, foreign authorities, jurisdictional relations*

DEDIKIMI

*Dedikuar vetes, për të treguar që asnjëherë nuk është vonë t'i rikthehesh pasionit dhe se
çdo gjë arrihet pavarësisht vendit dhe rrethanave...*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kapitulli I

1. Hyrja	faqe 1
1.1. Elementët kryesorë të studimit, qëllimi, problematika, rëndësia dhe domosdoshmëria e tij.....	faqe 1
1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit.....	faqe 5
1.3. Metodologjia e studimit.....	faqe 7
1.3.1. Hulumtimi i literaturës ekzistuese dhe analiza e saj.....	faqe 7
1.3.2. Metodat e kërkimit shkencor.....	faqe 9
1.3.2.1. Metodatkërkimore-shkencoresasiorredhecilësore.....	faqe9
1.3.2.2. Metodakërkimore-shkencore e krahasimit.....	faqe 11
1.3.3. Kërkimi me karakter empirik, fokusuar në instrumentin e pyetsorit...	faqe 12
1.4. Struktura e studimit.....	faqe 14

Kapitulli II: Kontekstihistorik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet

e huajanë procesin penal	faqe 18
2.1. Domosdoshmëria e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.....	faqe 18

- 2.2. Lindja dhe evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja
në procesin penal në botë.....faqe 22
- 2.3. Lindja dhe evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja
në procesin penal në Shqipëri.....faqe 33
- 2.4. Analizë e zhvillimeve të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja
në procesin penal në Shqipëri në raport me vende të ndryshme tëbotës.....faqe 46

**Kapitulli III: Trajtimi juridik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet
e huaja në procesin penaldhe letërporosive ndërkombëtare
si pjesë e tyre.....faqe 49**

- 3.1. Koncepti juridik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në
procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre, trajtimi i
tyre në doktrinë apo literaturën bashkëkohoredhe diskutim kritik i tyre.....faqe 49
- 3.2. Parimete marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin
penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre.....faqe 55
- 3.3. Drejtimet e zhvillimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja
në procesin penal.....faqe 60
- 3.4. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në
Shqipëri dhe baza ligjore e tyre.....faqe 65

3.4.1. Legjislacioni i brendshëm i aplikueshëm në fushën e marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal.....	faqe 66
3.4.1.1.Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.....	faqe 67
3.4.1.2.Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.....	faqe 70
3.4.1.3.Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.....	faqe 79
3.4.1.4.Ligjet e tjera.....	faqe 93
3.5. Aktet ndërkombëtare të aplikueshëm në fushën e marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri.....	faqe 96

Kapitulli IV: Analizë krahasuese e trajtimit juridik tëletërporosive ndërkombëtare

në fushën penale në legjislacionin shqipëtar në raport me aktet

ndërkombëtare dhe me legjislacionet e shteteve të tjerë.....faqe 109

4.1. TrajtimitjuridiktëletërporosivendërkombëtarengaKonventae KE “Përndihmën e ndërsjelltëjuridike” dhedyprotokollet e sajshitesë.....	faqe109
4.2. Krahasim itrajtimitjuridiktëletërporosivendërkombëtarenga e drejtashqiptareme trajtimin e tyre nëaktetndërkombëtare.....	faqe121
4.3. Krahasimi i trajtimit juridik të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Itali.....	faqe 140
4.3.1. Një historik i shkurtër e zhvillimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja midis Shqipërisë dhe Italisë.....	faqe 140

- 4.3.2. Analizë krahasuese e bazës ligjore të Shqipërisë me atë të Italisë
në lidhje me letërporositë ndërkombëtare penale.....faqe 141
- 4.3.3. Aktet ndërkombëtare të përfunduar nga Republika e Shqipërisë
dhe Republika e Italisë në fushën e marrëdhënieve juridiksionale
me autoritetet e huaja në procesin penal.....faqe 147
- 4.4. Krahasimi i trajtimit juridik të marrëdhënieve juridiksionale me
autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Maqedoni.....faqe 150
- 4.4.1. Analizë krahasuese e bazës ligjore të Shqipërisë me atë të
Maqedonisë në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me
autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporositë
ndërkombëtare penale si pjesë e tyre.....faqe 150
- 4.4.2. Aktet ndërkombëtare të nënshkruara midis Republikës së
Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë në fushën e marrëdhënieve
juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.....faqe 155

Kapitulli V: Problemet e praktikës në fushën e letërporosive

- ndërkombëtare.....faqe 157**
- 5.1. Rezultatet e të dhënave të grumbulluara nga pyetsori apo intervistat,
vlerësimi dhe interpretimi i tyre.....faqe 157
- 5.2. Rezultatet e të dhënave në lidhje me nga raportet dhe interpretimi

i tyre.....	faqe 187
5.3. Efektiviteti i letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.....	faqe 193
Kapitulli VI: Përfundimet.....	faqe 199
6.1. Përmbledhje e koncepteve kryesorë të studimit.....	faqe 199
6.2. Kufizime dhe vështirësi për realizimin e këtij studimi.....	faqe 208
6.3. Sugjerime dhe rekomandime.....	faqe 210
Shtojca 1: Pyetsor në gjuhën shqipe.....	faqe 214
Shtojca 2: Pyetsor në gjuhën angleze.....	faqe 217
Bibliografia.....	faqe 219

LISTA E GRAFIKËVE

- Grafiku 1 Pasqyrë e dispozitave respective që parashikojnë përcaktime në lidhje me letërporositë ndërkombëtare penale nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm
- Grafiku2 Personat shqipëtarë të intervistuar sipas grup profesioneve
- Grafiku3 Përqindja e personaveqë i janë përgjigjur pyetsorit sipas grup profesioneve
- Grafiku4 Përqindja e personave që i janë përgjigjur plotësisht pyetsorit sipas grup profesioneve
- Grafiku5 Rezultatet e pyetsorit për plotshmërinë e legjislacionit penal shqipëtar dhe efektivitetin e procedurave aktuale ligjore
- Grafiku 6 Ndryshimi i numrit të letërporosive ndër vite (2007 – 2013)
- Grafiku 7 Trendi i numrit të letërporosive nga dhe për jashtë shtetit nga viti 2007 në vitin 2013
- Grafiku 8 Trendi i llojeve të ndihmës së ndërsjellë juridike nga viti 2007 në vitin 2013

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Numri i personave të pyetur sipas grup profesioneve
Tabela 2	Numri i personave të pyetur specifikuar sipas profesioneve
Tabela 3	Rezultatet e përgjigjeve për pyetjet 1, 2, 3 të pyetsorit, specifikuar sipas grup profesioneve
Tabela 4	Rezultatet e përgjigjeve për pyetjet 4, 5, 6 të pyetsorit, specifikuar sipas grup profesioneve
Tabela 7	Të dhënat në lidhje me letërporositë ndër vite (2007 – 2013)

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Europian
DNP	E drejta ndërkombëtare penale
DP	E drejta penale
JIT	Joint Investigation Team (Skuadrat e përbashkëta hetimore)
FYROM	Former Yugoslav Republic of Macedonia (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë)
KE	Këshilli i Europës
KP	Kodi penal
KPP	Kodi i procedurës penale
KSBE	Konferenca mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Europë (Helsinki 1975)
GJEDNJ	Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut
GjK	Gjykata Kushtetuese
MD	Ministria e Drejtësisë
RI	Republika e Italisë
RSh	Republika e Shqipërisë

KAPITULLI I: HYRJE

1.5. Elementet kryesore të studimit, qëllimi, problematika, rëndësia dhe domosdoshmëria e tij

Zhvillimi i gjithanshëm i shoqërisë ka sjellë krijimin e shteteve moderne e sovrane, që u shoqërua me lindjen e marrëdhënieve ndërshtetërore. Këto marrëdhënie sollën zhvillimin e bashkëpunimit midis shteteve të ndryshme në fushën e së drejtës. “E drejta ndërkombëtare ka lindur si nevojë e rregullimit të marrëdhënieve midis shteteve sovrane” (Zaganjori, 2012:9). Në këtë këndvështrim, edhe e drejta ndërkombëtare penale (DNP), si pjesë e së drejtës ndërkombëtare, ka lindur si nevojë e rregullimit të marrëdhënieve midis shteteve në fushën e së drejtës penale (DP). Në kuadër të globalizimit në botë, bashkëpunimi midis shteteve në fushën e DNP-së, si edhe në fusha të tjera, është zhvilluar nga dita në ditë. Ky bashkëpunim është rritur ndjeshëm këto dekadat e fundit.

Arsyeja kryesore e këtij dimensionit të ri është vullneti gjithnjë e më i madh i shteteve për të bashkëpunuar me njëri – tjetrin në planin dypalësh dhe më gjerë, në funksion të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe garantimit të një zhvillimi sa më të qëndrueshëm në të gjithë sektorët e jetës së vendit. Në qendër të vëmendjes së saj është ndalimi i luftës, ndalimi i dhunës mes shteteve dhe bashkëpunimi gjithnjë në rritje dhe sa më efektiv mes tyre, bazuar në interesin dhe respektin reciprok. Në këtë kuadër, kanë lindur mjaft fusha dhe institute të reja të së drejtës ndërkombëtare, si dhe janë zhvilluar dukshëm dhe janë përsosur ato ekzistuese. (Zaganjori, 2012:3)

DNP është një ndër degët më të rëndësishme të së drejtës në përgjithësi dhe, për shkak të specifikës së marrëdhënieve shoqërore që rregullon, është e lidhur edhe me të drejtën ndërkombëtare. Si e tillë ajo konsiderohet hera-herës si degë e së drejtës ndërkombëtare.

Në këtë vështrim, objekti i saj përfshin rregullimet e marrëdhënieve midis shteteve në fushën penale, marrëdhënie të cilat janë të shumëllojshme dhe ngërthejnë një problem me interes të veçantë për shtetet si subjekte tipike të së drejtës ndërkombëtare. Në morinë e pafundme të këtyre marrëdhënieve që trajtojnë dhe gjejnë zgjidhjen e tyre të përshtatshme nëpërmjet bashkëpunimit midis shteteve, një vend të posaçëm zënë marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, që është edhe objekt i këtij studimi. “Ky instrument lejon shtete të ndryshme të organizojnë ndjekje të përbashkëta të krimeve të caktuara, më specifikisht ato që dëmtojnë interesat e tyre të përbashkëta dhe kanë një dimension të fortë ndërshtetëror” (Cassese et al, 2012:18).

Një nga format e ushtrimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë letërporositë ndërkombëtare. Ato paraqesin mjaft rëndësi, kanë vëmendje mbarëbotërore dhe paraqesin interes për t’u studiuar në një mënyrë të thelluar. Nisur nga zhvillimet e shoqërisë dhe marrëdhënieve ndërshtetërore, zgjerimi i lëvizjes së lirë të shtetasve në botë, bashkimi i një numri të madh shtetesh në sjellin hyerjen e barrierave dhe kufijve midis shteteve, si edhe afron aspiratën e Shqipërisë për t’u bërë pjesë e këtij bashkimi. “Bota po bëhet më e vogël dhe krimi më ndërkombëtar. Nevoja për ndihmë të ndërsjellë për të proceduar kriminelë ndërkombëtarë është me një rëndësi në rritje për të gjithë ne” (Bolt, 1993:1911).

Hetimi sa më i plotë dhe i gjithanshëm i veprave penale, që kërkojnë kryerje veprimesh procedurale nga më shumë se një shtet, si dhe ekzekutimi i vendimeve penale jashtë shtetit

që e jep këtë vendim, janë çështje që nuk mund të zgjidhen brenda kuadrit ligjor penal kombëtar të një shteti të vetëm, por kërkojnë ndërveprim midis shteteve të ndryshëm, duke krijuar një kuadër ligjor ndërkombëtar. Ky kuadër ligjor ka një rëndësi të veçantë për të sotmen dhe për të ardhmen, duke vlerësuar nevojën për funksionimin efikas dhe të paanshëm të drejtësisë penale. “Ndihma e ndërsjellë juridike në fushën penale është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me autoritetet e huaja” (Islami et al, 2012:761).

Qëllimi – Ky studim ka për qëllim të bëjë një trajtim të gjerë juridik të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal, pjesë e të cilave është ndihma e ndërsjellë juridike. Studimi do të përqendrohet më tepër në letërporositë ndërkombëtare si një nga llojet e ndihmës së ndërsjellë juridike, të cilat paraqesin interes për kohën e sotme, për një bashkëpunim sa më të mirë me autoritetet e huaja në procesin penal dhe efikasitet sa më të madh të luftës kundër krimit. Duke iu referuar edhe burimeve kryesorë të së Drejtës Ndërkombëtare, rregullimi ligjor i këtyre problemeve bëhet nga një sërë dispozitash të legjislacioneve të brendshme penale të shteteve dhe akteve ndërkombëtare penale (marrëveshje, konventa etj.).

Objektivat – Në këtë studim do të bëhet analiza e bazës ligjore, që lidhet drejtpërdrejt me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri, më konkretisht:

- Analiza e dispozitave ligjore të së drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen: Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji Nr. 10193 datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar);
- Analiza e akteve juridiko-ndërkombëtare, ku përfshihen: traktatet ndërkombëtare dy- apo shumëpalësh, në të cilat Shqipëria është palë.

Objektiv i këtij studimi është që analiza të mos mbetet vetëm në aspektin teorik dhe atë përshkruar, apo paraqitjen e qëndrimeve të ndryshme doktrinale të trajtimit të problemit, por të bëhet duke krahasuar legjislacionin shqiptar me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionet e shteteve të huaja në fushën objekt studimi, për të evidentuar faktin nëse është i plotë legjislacioni shqiptar në këtë drejtim, cilat janë boshllëqet e tij, si dhe për të përcaktuar modelet më të mira që mund të përdoren nga përvoja e shteteve të tjerë. Përveç anës teorike të problemit, studimi do të shtrihet në analizën e rasteve nga praktika të organeve procedues shqiptarë dhe të huaj, problemet e hasura në praktikë për zbatimin e bazës ligjore në këtë fushë, qëndrimet gjyqësore të mbajtur në zgjidhjen e këtyre problemeve, si dhe në evidentimin e përvojave pozitive të huaja, që nuk janë aplikuar në Shqipëri deri tani.

Shqipëria, si një demokraci e re, që aspiron integrimin e saj në Europë, duhet të jetë krahas demokracive të tjera të zhvilluara në nisma të tilla. Në këtë kontekst, ky studim do të kontribuojë në aspektin teorik të temës dhe njëkohësisht në nivelin empirik të studimit të

rasteve konkrete të sjella për analizë. Ai do të ndihmojë në identifikimin e problematikës në praktikë dhe përqasjen e përvojave më të mira botërore në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, me fokus të veçantë letërporositë ndërkombëtare. Fusha e studimit, sidomos në Shqipëri, është relativisht e re, duke pasur parasysh që marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal kanë marrë fizionominë e tyre në fillim të viteve '90, për rrjedhojë ajo është e paeksploruar gjerësisht dhe ka vend për një studim të thelluar të saj. Ky studim do të shërbejë në mënyrë modeste për të çuar më tej atë që është bërë deri më sot nga studiues të mëparshëm në këtë fushë, duke e pasuruar dhe zgjeruar me opinione personale mbi problemet e diskutueshme të fushës, prurje e ide të reja, sugjerime dhe rekomandime.

1.6. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit

Për këtë studim ka mjaft rëndësi jo vetëm parashtrimi teorik i parashikimeve, që bën e drejta penale shqiptare dhe aktet ndërkombëtare, në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në procesin penal, por edhe raporti midis tyre, problematika e zbatimit të tyre në praktikë dhe gjetja e instrumenteve më të mirë të praktikës botërore, që mund të ndihmojnë në shmangien, apo minimizimin e problemeve të praktikës shqiptare në fushën e letërporosive ndërkombëtare, me qëllim final luftën kundër krimit dhe dhënien e drejtësisë. Të gjitha këto elemente të studimit do t'i shërbejnë hipotezës së tij dhe dhënies së përgjigjeve për pyetjet e ngritura në të.

Duke pasur parasysh sa u përmend derimë tani, hipoteza e këtij studimi është: **Pavarësisht arritjeve në përpunimin e një kuadri juridik të plotë dhe të përshtatshëm përsa i përket zbatimit të letërporosive ndërkombëtare si një nga format e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, praktika dëshmon se ka ende mangësi, kapërcimi i të cilave do të kërkonte përf forcimin e dijeve dhe përkushtimit për zbatimin e akteve dhe dispozitave ekzistuese apo edhe ndërhyrjen në legjislacion për plotësimin e vakumeve eventuale.**

Për vërtetimin e kësaj hipoteze janë studiuar: mënyra se si ka evoluar në Shqipëri kuadri ligjor në këtë fushë, duke e krahasuar edhe me atë të shteteve të ndryshme të botës; aktet ndërkombëtare në këtë kuadër; institucionet që ushtrojnë ndihmën e ndërsjellë juridike si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri (Ministria e Drejtësisë, Gjykata, Prokuroria, Policia), roli i tyre, mënyra e funksionimit, etj; problemet juridiko – penale të aplikimit të tyre në praktikë; praktika gjyqësore e vendit dhe e huaj në këtë fushë.

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të studimit janë:

- Si janë zhvilluar marrëdhëniet juridiksionale në procesin penal në Shqipëri?
- A është i plotë legjislacioni shqiptar përsa i përket letërporosive ndërkombëtare si një nga format e ushtrimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri?

- Çfarë problemesh lindin në praktikë në zbatimin e bazës ligjore të letërporosive ndërkombëtare?
- Sa efektiv është ky legjislacion, duke pasur parasysh procedurat, kohëzgjatjen apo pengesat e ndryshme dhe faktorë të tjerë si këto që shfaqen gjatë ekzekutimit të letërporosive?
- A ka qëndrime të ndryshme të gjykatave shqiptare për raste analoge?
- Si parashikohet ndihma e ndërsjellë juridike si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal në legjislacionet e shteteve më të përparuara, në krahasim me legjislacionin penal shqiptar?
- Cila është përvoja e organeve procedues të huaj, që mund të shërbejë në zgjidhjen e problemeve të praktikës shqiptare?
- A ka instrumente më efektive në botë, që i mungojnë Shqipërisë?

1.7. Metodologjia e studimit

1.7.1. Hulumtimi i literaturës ekzistuese dhe analiza e saj

Ky studim është mbështetur në një literaturë relativisht të gjerë, që përfshin 73 burime parësore, 64 burime dytësore/literature dhe 13 burime nga interneti, nga të cilët janë përfshirë në studim rreth 200 referenca. Burimet parësore mbi të cilat është mbështetur studimi janë: ligjet shqiptarë e të huaj, aktet ndërkombëtare, aktet proceduralë nga praktika, si dhe raportet apo statistikat zyrtare. Është treguar kujdes që burimet nga

interneti të jenë kryesisht burime zyrtare me qëllim që të dhënat e marra prej tyre të jenë serioze, sa më reale dhe me vlera të vërteta shkencore.

Në studim është bërë analizë e akteve të së drejtës së Shqipërisë, të cilët përmbajnë parashikime që gjejnë pasqyrim në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, ose përcaktojnë drejtpërdrejt aspekte të tyre, më konkretisht: Kushtetuta e RSh-së, Kodi Penal i RSh-së, Kodi i Procedurës Penale i RSh-së, ligji Nr. 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, datë 03.12.2009 (i ndryshuar), etj. Këto akte ligjorë përfshijnë dispozita që parashikojnë aspekte të ndryshme të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, por analiza e tyre do të fokusohet kryesisht në ato dispozita që përmbajnë parashikime në lidhje me letërporositë ndërkombëtare. Në këtë kategori burimesh janë përfshirë edhe ligjet me të cilët Shqipëria ka ratifikuar akte ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Në studim janë përfshirë edhe akte nga e drejta e brendshme e disa shteteve të huaj, Italia dhe Maqedonia, të cilët janë përdorur për t’i krahasuar me legjislacionin shqiptar në funksion të hipotezës dhe pyetjeve të studimit. Janë zgjedhur këto dy shtete, duke pasur parasysh që janë vende fqinjtë kufitarë, me të cilët Shqipëria ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi të ndërsjellë në fushën penale.

Është zgjedhur Maqedonia si shtet i rajonit me qëllim që të bëhet krahasimi me një shtet në nivel zhvillimi pak a shumë të barabartë me Shqipërinë.

Është zgjedhur gjithashtu Italia, si shtet i zhvilluar demokratik, anëtare e BE që në fillimet e saj, me një të drejtë të lashtë dhe të zhvilluar në veçanti. Midis Shqipërisë dhe Italisë ka pasur marrëdhënie mjaft të mira bashkëpunimi në drejtësi e më gjerë që në kohët e hershme, si dhe për arsye se sistemi i drejtësisë penale italiane përfron me atë të Shqipërisë, duke pasur parasysh edhe faktin që legjislacioni italian gjatë historisë është përdorur si model në hartimin e ligjeve të reja të Shqipërisë, sidomos pas ndryshimeve të sistemit nga ai totalitar në atë demokratik në vitin 1990.

Në këtë studim një vend të rëndësishëm zënë aktet ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Në këto akte janë përfshirë aktet juridiko-ndërkombëtare, veçanërisht Konventa e Këshillit të Europës “*Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale*” e 20 prillit 1957 dhe dy protokollet e saj shtesë të datës 17 mars 1978 dhe datës 08 nëntor 2001.

1.7.2. Metodat e kërkimit shkencor

Metodologjia e përdorur në këtë studim i është përgjigjur qëllimit të tij. Ajo përbëhet nga metodat kërkimore-shkencore sasiore dhe cilësore, si dhe metoda kërkimore-shkencore e krahasimit.

1.7.2.1. Metodat kërkimore-shkencore sasiore dhe cilësore

Në këtë studim është përdorur metoda e përzier e kërkimit, duke ndërthurur metoda kërkimi sasiore me ato cilësore. Metodat kërkimore-shkencore sasiore janë bazuar fillimisht mbi forma deduktive logjike. Hipoteza është testuar gjatë analizës në studim, si

dhe duke përdorur të dhënat e mbledhura nga instrumenti i pyetsorit. Në këtë këndvështrim, ato janë përdorur duke pasur parasysh qëllimin kryesor të përgjithësimit të faktit të ekzistencës së legjislacionit të plotë në fushën e studimit, fakt ky që ka qenë i parashikuar, shpjegohet me anë të studimit dhe vërtetohet nga ai. Nëpërmjet metodave cilësore është përfshirë informacioni për çështjen qendrore të studimit, që përfshin: legjislacionin mbi fushën e studimit, përshkrimin e konceptit teorik, mendimet e studiuesve dhe debatet e doktrinės. Ky informacion më pas është analizuar dhe interpretuar në mënyrë subjektive.

Ky studim është shtrirë në organet e drejtësisë, që përfshihen në zhvillimin e procesit të ndihmës së ndërsjellë juridike, kryesisht gjykata dhe prokuroria. Në të janë trajtuar mendime, probleme dhe konkluzione që kanë dalë nga materiale, vendime apo bashkëbisedime me gjyqtarë e prokurorë në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, oficerë të policisë gjyqësore, studiues, si dhe juristë të tjerë me njohuri në këtë fushë.

Ndërthurja e metodave kërkimore-shkencore sasiore dhe cilësore në studim është bërë duke e përdorur hipotezën në mënyrë deduktive, që i paraprin fillimit të planit të studimit. Kjo mënyrë kishte për qëllim verifikimin e hipotezës së studimit “Pavarësisht arritjeve në përpunimin e një kuadri juridik të plotë dhe të përshtatshëm për sa i përket zbatimit të letërporosive ndërkombëtare si një nga format e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, praktika dëshmon ende mangësi, kapërcimi i të cilave do të kërkonte përforsimin e dijeve dhe përkushtimit për zbatimin e akteve dhe dispozitave

ekzistuese apo edhe ndërhyrjen në legjislacion për plotësimin e vakumeve eventuale”, duke filluar me avancimin në aspektin teorik, duke mbledhur të dhënat dhe duke reflektuar së fundmi mbi faktin nëse hipoteza është konfirmuar, apo hedhur poshtë gjatë punës në “terren”, mbledhjes së të dhënave dhe rezultateve të studimit.

Pjesën më të madhe të të dhënave në kuadrin e këtij studimi e kanë zënë: dokumentat e shkruara, zyrtare, parësore (ligjet, aktet ndërkombëtare, akte të prokurorëve në procesin hetimor, vendime gjyqësore për çështje penale konkrete në këtë fushë, raporte dhe statistika zyrtare); dokumentet dytësore (libra, artikuj, studime të autorëve shqiptarë e të huaj, raporte të shoqatave). Këto dokumenta i janë nënshtruar analizës së përmbajtjes, duke i përshkruar, interpretuar e krahasuar ide të ndryshme të hulumtuara në to.

1.7.2.2. Metoda kërkimore-shkencore e krahasimit

Në studim ka zënë vend edhe analiza krahasuese e legjislacionit penal shqiptar me aktet ndërkombëtare, me qëllim analizimin e implementimit të këtyre të fundit në legjislacionin shqiptar. Në të njëjtën kohë, analiza krahasuese është përdorur edhe midis legjislacionit shqiptar dhe legjislacionit të shteteve të huaja (Itali e Maqedoni, siç u përmend më lart), me qëllim evidentimin e ndryshimeve midis procedurave përkatëse në drejtim të letërporosive ndërkombëtare penale dhe risive. Ky krahasim ka shërbyer edhe për të evidentuar faktin se sa i plotë është legjislacioni shqiptar në fushën e studimit dhe se sa i përshtatet ai kërkesave të kohës. Metoda e analizës krahasuese është përdorur për t’i shërbyer verifikimit të hipotezës së studimit.

1.7.3. Kërkimi me karakter empirik, fokusuar në instrumentin e pyetsorit

Në drejtim të vërtetimit të hipotezës së këtij studimi është përdorur kërkimi empirik nëpërmjet instrumentit të pyetsorit, si teknikë e suksesshme të hulumtimit për realizimin e kërkimit shkencor sasior dhe cilësor. Pyetsori i është dërguar në mënyrë elektronike, ose dorazi 295 personave, nga të cilët, 162 prej tyre i janë përgjigjur plotësisht, 84 persona pjesërisht, duke dhënë ndonjë ide, kryesisht nga praktika e tyre, ndërsa 49 nuk janë përgjigjur fare. Janë përgjigjur në mënyrë elektronike (e-mail) 68 persona, ndërsa pjesa tjetër është kontaktuar personalisht, duke i marrë përgjigjet për pyetjet e pyetsorit në formë të drejtpërdrejtë, në disa raste duke i kontaktuar personat më shumë se një herë.

Tabela 1 – Numri i personave të pyetur sipas grup profesioneve

Profesioni	Nr. i personave të pyetur	Përgjigjur plotësisht	Përgjigjur pjesërisht	Pa përgjigje
Studiues/mësimdhënës/doktorantë	30	17	8	5
Gjyqtarë/ Prokurorë/ Oficerë të Policisë Gjyqësore	154	77	48	29
Ministria e Drejtësisë/KLD	5	3	1	1
Avokatë/Avokati i Popullit	52	29	15	8
Të tjera	5	1	3	1
Të huaj	49	35	9	5
Gjithsej	295	162	84	49

Duke pasur parasysh parimet për zgjedhjen e kampionit në këtë lloj instrumenti, është treguar kujdes që personat e pyetur t'i përkasin profesioneve që kanë lidhje me fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në procesin penal. Edhe brenda këtyre profesioneve, janë përzgjedhur persona që kanë/kanë pasur lidhje të drejtpërdrejtë me fushën e studimit, të cilët njihen njëkohësisht për nivel të mirë profesional dhe akademik.

Pyetsori kishte si qëllim mbledhjen e opinioneve të specialistëve të fushës, në lidhje me çështje të tilla, si: nëse kuadri ligjor kombëtar/ndërkombëtar në Shqipëri është i plotë apo jo; nevojën dhe sugjerime për ndryshime në legjislacionin shqiptar; efektshmërinë e mekanizmave ligjore në fushën e ekzekutimit të letërporosive ndërkombëtare penale dhe mjete efektive të përdorura në botë në fushën objekt studimi.

Pyetsori kishte një hyrje të shkurtër, ku përshkruhej: lloji i hulumtimit dhe për se bëhej ky hulumtim; një shënim për konfidencialitetin e informacioneve; një numër kontakti për njerëzit që mund të kishin pyetje pas marrjes së pyetsorit. Është treguar kujdes që pyetjet të ishin të formuluar drejt dhe me një strukturë logjike.

Pjesa e parë e pyetjeve përbëhej nga pyetje të strukturuar, që përfshinin opsionet e përgjigjeve: Po/Jo/Nuk kam informacion. Më tej vazhdohej me pyetje të tjera sqaruese/shpjeguese, të cilat ishin të hapura, me qëllim mbledhjen e opinioneve të të pyeturve, apo informacioneve që kishin ata për çështje të caktuara, në lidhje me studimin.

U tregua kujdes, që pyetsori të ishte i përmbledhur dhe jo shumë i gjatë, i formatuar në mënyrë tërheqëse dhe me font të shkronjave të lexueshëm lehtësisht, me qëllim që pjesëmarrësit në të, të jepnin përgjigje sa më të plota dhe të vlefshme.

Pas shpërndarjes së parë të pyetsorit pak persona nga ata që u kontaktuan kthyen përgjigje për të, kështu që u vazhdua me drejtimin e pyetjeve drejtpërdrejt, duke i plotësuar përgjigjet e pyetjeve gjatë komunikimit me ta.

Të dhënat e mledhura nga pyetsori janë analizuar në mënyrë sasiore, duke përdorur statistikën përshkruese (mesataret dhe përqindjet e llojeve të përgjigjeve të caktuara) dhe cilësore duke bërë interpretimet e ndryshme në funksion të tematikës së pyetsorit në veçanti, dhe të studimit në përgjithësi. Të gjitha këto janë përfshirë në kapitullin VI, çështja 1 e studimit.

1.8. Struktura e studimit

Struktura e përmbajtjes dhe e formës së studimit është bërë në përputhje me kërkesat e shkollës doktrale të UET-it. Në fillim të tij janë përfshirë deklarata e autorësisë, dedikimi dhe falenderimet, duke u pasuar me listat e grafikëve, tabelave dhe shkurtimeve, si dhe abstraktet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Studimi është menduar i ndarë në 6 kapituj.

Kapitulli I: Hyrja – është menduar e ndarë në 4 çështje. Ato përmbajnë të trajtuara këto çështje: elementet kryesore të studimit, qëllimi, problematika, rëndësia dhe domosdoshmëria e tij; hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit; metodologjia e studimit, duke përfshirë këtu hulumtimin e literaturës ekzistuese dhe analizën e saj, metodat e kërkimit shkencor, duke përfshirë këtu metodat sasiore e cilësore dhe ato të krahasimit, si dhe kërkimi me karakter empirik, fokusuar në instrumentin e pyetsorit; struktura e studimit.

Kapitulli II: Konteksti historik i marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri – është menduar i ndarë në 4 çështje. Në secilën prej tyre janë trajtuar:

domosdoshmëria e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal; lindja dhe evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në botë dhe në Shqipëri; analiza e zhvillimeve të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri në raport me vendet e ndryshme të botës.

Kapitulli III: Trajtimi juridik i marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre– është menduar i ndarë në 4 çështje. Në to janë trajtuar:

3.6.Koncepti juridik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre, trajtimi i tyre në doktrinë apo literaturën bashkëkohore dhe diskutim kritik i tyre;

3.7.Parimet e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre;

3.8.Drejtimet e zhvillimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri;

3.9.Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe baza ligjore e tyre.

Kapitulli IV: Analizë krahasuese e trajtimit juridik të letërporosive ndërkombëtare në fushën penale në legjislacionin shqiptar në raport me aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionet e shteteve të tjerë – Ky kapitull është menduar i ndarë në 4 çështje. Në dy çështjet e para është përfshirë analiza krahasuese e trajtimit juridik të letërporosive

ndërkombëtare në fushën penale në legjislacionin shqiptar në raport me Konventën e KE “Për ndihmën e ndërsjellë juridike” dhe dy protokollat e saj shtesë, duke parashtruar parashikimet e tyre, duke analizuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me aktet ndërkombëtare dhe ekzistencën ose jo të nevojës për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit shqiptar në fushën objekt studimi. Në çështjen e tretë është analizuar në mënyrë krahasuese trajtimi juridik i marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe në Itali, ku pas një historiku të shkurtër të zhvillimit të marrëdhënieve midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në nënçështjen e parë, më pas në nënçështjen e dytë janë trajtuar marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Itali. Këtu është përfshirë trajtimi juridik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në legjislacionin italian, fokusuar në letërporositë ndërkombëtare penale si një nga llojet e tyre, duke e krahasuar me legjislacionin shqiptar. Në nënçështjen e tretë janë trajtuar në mënyrë të përmblodhur aktet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Italisë në fushën e marrëdhënieve juridiksionale në procesin penal. Në të njëjtën mënyrë, në çështjen e katërt janë trajtuar marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Maqedoni.

Në Kapitullin V “Problemet e praktikës në fushën e letërporosive ndërkombëtare” janë trajtuar të dhënat e grumbulluara gjatë studimit, në të cilat janë përfshirë dhe më pas interpretuar rezultatet e të dhënave të grumbulluara nga pyetsori, vlerësimi dhe interpretimi

i tyre (çështja 1) dhe rezultatet e të dhënave të grumbulluara nga raportet (çështja 2). Po në këtë kapitull është analizuar efektiviteti i letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal

Kapitulli VI, që përbën kapitullin e fundit të studimit trajton përfundimet e studimit, duke përfshirë përmbledhjen e koncepteve kryesore të studimit, kufizimet e tij, sugjerimet dhe rekomandimet e studiuesit.

KAPITULLI II: KONTEKSTI HISTORIK I MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË PROCESIN PENAL

2.5. Domosdoshmëria e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal

Shteti dhe e drejta janë produkte dhe premisa të zhvillimit të shoqërisë që prej kohëve më të lashta. Në etapat e para të shoqërisë njerëzore si shteti ashtu edhe e drejta kanë qënë të pazhvilluara, siç ka qënë e pazhvilluar edhe vetë shoqëria, siç kanë qënë të pazhvilluara marrëdhëniet midis njerëzve në këtë shoqëri. Me kalimin e kohës marrëdhëniet zgjerohen gjithnjë e më tepër. Si rezultat, zgjerohet dhe zhvillohet makina shtetërore dhe bashkë me të edhe e drejta, duke përfshirë fusha gjithnjë e më të gjera të veprimtarisë së shoqërisë. (Puto, 2010:5)

Zhvillimi i së drejtës u shoqërua me ndarjen e saj në degë të veçanta, të cilat rregullojnë marrëdhënie shoqërore të një kategorie të caktuar. Këto marrëdhënie shoqërore përfshijnë jo vetëm marrëdhëniet që lindin midis shtetasve brenda një shteti, por edhe marrëdhëniet që lindin midis shteteve të ndryshme, të quajtura ndryshe marrëdhënie ndërkombëtare. Marrëdhëniet ndërkombëtare kanë lindur bashkë me shtetet. Natyrisht në fillim këto marrëdhënie mbanin vulën e kohës dhe ishin të kufizuara, të pazhvilluara dhe primitive, por marrëdhënie të tilla ekzistonin (Puto, 2010:5).

Lindja e marrëdhënieve ndërkombëtare u shoqërua me domosdoshmërinë e krijimit të normave juridike që rregullonin ato, të cilat ishin norma ndërkombëtare, duke u nisur nga vetë natyra e këtyre marrëdhënieve. Çështjet juridike të përcaktimit të marrëdhënieve midis

shteteve të ndryshme nuk mund të mbeten brënda kornizave kombëtare, por kanë përfutur gjithnjë e më shumë një prespektivë ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare shfaqet si një tërësi normash dhe parimesh që zbatohen në marrëdhëniet ndërmjet shteteve sovrane, kurse e drejta e brendshme, si rregull, ka fuqi zbatimi në territorin që shtrihet brenda kufijve të një shteti, duke synuar që të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet shtetasve ose personave që jetojnë në territorin e tij me njëri – tjetrin, me organet e ndryshme të shtetit, si dhe me entet e tjera publike ose private. (Krisafi, 2014 a:34)

Një ndër detyrat e një shteti ka qënë dhe mbetet mbrojtja juridiko – penale e individëve, institucioneve apo vetë shtetit nga veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme që çenojnë interesat e tyre. Përmbushja e kësaj detyre bëhet nëpërmjet të drejtës penale, si degë e së drejtës në përgjithësi. Nga ana tjetër, e drejta penale e shteteve, ashtu si e gjithë e drejta e tyre në tërësi, mbështetet në parimin e sovranitetit. Në të njëjtën kohë, si ligji material penal ashtu edhe ai procedural penal i nënshtrohet parimit të territorialitetit në të gjithë botën.

Në këtë kuptim, nëse do të huazonim terminologjinë e përdorur nga doktrina e së drejtës private, do të konstatonim se veprat penale të kryera mbi një territor të caktuar, i nënshtrohen lex loci, pra kërkesave të ligjit të vendit ku është kryer vepra penale. (Hoxha, 2011:26)

Janë pikërisht këto dy parime të së drejtës penale që pengonin shtetet të procedonin dhe dënonin autorët e veprave penale që largoheshin nga territori i shtetit të tyre.

Duke u nisur nga zhvillimet e kohës, lëvizja e lirë e shtetasve nga njëri shtet në tjetrin është shoqëruar edhe me lëvizjen e lirë të autorëve të veprave penale, dëshmitarëve, mjeteve të kryerjes së veprave penale apo produkteve të përfituara nga kryerja e tyre. Nisur nga ky fakt, nëse parimet e sovranitetit dhe territorialitetit do të absolutizoheshin, do të ekzistonte

rreziku i mosndëshkimit të të gjithë autorëve të veprave penale. Kjo gjë u shoqërua me domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërshtetëror në fushën penale, gjë që gjen shprehje në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Për këtë arsye shtetet filluan të heqin dorë pak nga pak nga parimi i sovranitetit absolut.

Është e kuptueshme që kjo situatë nuk mund të kontrollohej më në mënyrë të kënaqshme duke u bazuar vetëm në parimin e ligjit penal territorial, që ishte reflektim i konceptit të pavarësisë dhe sovranitetit kombëtar që sundonte në vendet europiane në mesin e këtij shekulli. Për këtë shkak lindi nevoja e krijimit të koncepteve dhe aplikimit të formave të reja për të luftuar krimin, edhe për rastet kur ai shtrihej jashtë sovranitetit dhe kufijve të shteteve. (Islami et al, 2012:696)

Pavarësisht se marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale i kanë fillësat e tyre në një periudhë të hershme, fillimisht ato kanë qënë mjaft sporadike. Më pas ato pësuan zgjerim duke u shtrirë edhe në shtete të tjera. Megjithatë deri në shekullin XX ato kanë qënë të kufizuara vetëm në marrëveshjet e ekstradimit, me qëllim dorëzimin e autorëve të veprave penale shteteve kërkues.

Ndryshimet dhe zhvillimet e vrullshme ekonomiko-shoqërore në Evropë, kryesisht në vitet e para të shekullit XX, u shoqëruan me lëvizje masive të njerëzve, çka i shtyu shtetet e Kontinentit të Vjetër të ndërmerrnin nisma për një bashkëpunim gjithnjë e më të gjerë në fushën penale. (Hoxha, 2011:35)

Pra, ishte pikërisht lëvizja e njerëzve nga njëri shtet në tjetrin që solli domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit midis shteteve në fushën penale dhe zgjerimit të formave të këtij bashkëpunimi, duke mos u kufizuar tashmë vetëm tek ekstradimi. Por lëvizja e lirë e njerëzve ishte vetëm njëri faktor, i cili duke u ndërthurur edhe me zhvillimin teknologjik me hapa të shpejtë, ndikuan në krijimin e formave të reja të krimit, më të sofistikuara dhe më të organizuara. Kjo gjë shtoi akoma më tej domosdoshmërinë e bashkëpunimit

ndërkombëtar në fushën penale. Për rrjedhojë, nga mesi i shekullit XX bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale mori një zhvillim të hovshëm.

Është fakt i pamohueshëm sot se, autorët e veprave penale krijojnë struktura të tyre në shumë vende të rajonit, por edhe më gjerë, duke përfutur nga eliminimi i kufijve që shoqërohet me mungesën e kontrollit në lëvizjen e individëve, mallrave dhe shërbimeve; nga zhvillimi i teknologjisë, i cili lehtëson komunikimin si dhe lehtësia e qarkullimit të kapitaleve, e shërbimeve. Këto lehtësira të arritura si rezultat i zhvillimeve politike dhe/apo teknologjike, pa dyshim vështirësojnë hetimet e organeve policore dhe të prokurorisë, duke bërë disa herë të pamundur dhënien e drejtësisë nga ana e autoriteteve gjyqësore. Në këtë realitet, domosdoshmëria e bashkëpunimit gjyqësor penal ndërmjet autoriteteve të vendeve të ndryshme është e pamohueshme. (Hoxha, 2011:37)

Nën frymën e globalizimit, ka ardhur gjithnjë duke u zhvilluar bashkëpunimi midis shteteve në fushën e të drejtës penale, ashtu si edhe në shumë fusha të tjera të së drejtës. Kjo për vetë faktin që zhvillimi i shoqërisë është shoqëruar edhe me përhapjen e formave të zhvilluara dhe të organizuara të kriminalitetit. Thënë ndryshe, në ditët e sotme kryerja e një veprë penale mund të paraqitet në forma më komplekse dhe më të organizuara bashkëpunimi, që shtrihet në disa shtete dhe që sjell si domosdoshmëri kryerjen e veprimeve hetimore dhe procedurale njëkohësisht nga shtete të ndryshëm. Kjo gjë mund të realizohet vetëm nëpërmjet marrëdhënieve juridiksionale midis shteteve të ndryshme në procesin penal, siç është parashikuar në Konventën Europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale. Në këtë kuptim, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal përbëjnë një mundësi të mirë të ndërveprimit midis shteteve të ndryshme në fushën penale, me qëllim final luftën sa më efektive kundër krimit, dhënien e drejtësisë dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale.

2.6. Lindja dhe evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në botë

Zhvillimet e së drejtës në përgjithësi dhe degëve të saj, siç janë e drejta penale apo e drejta ndërkombëtare, kanë kaluar në etapa të njejta me ato të historisë së zhvillimit të shtetit.

Duke qenë produkt i zhvillimit të shoqërisë njerëzore, e lindur dhe e zhvilluar sëbashku me shtetin, e drejta penale ka karakter historik dhe i nënshtrohet procesit të përpunimit e të ndryshimit të vazhdueshëm... Ajo merr kurdoherë atë formë e përmbajtje që u përgjigjet interesave të sistemit shoqëror të epokës historike përkatëse. (Muçi, 2007:12)

Vlen të trajtohet shkurtimisht historiku i zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare, për aq kohë sa ajo përbën rregullatorin normativ të marrëdhënieve midis shteteve, pjesë e të cilave janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

“Për sa i përket të drejtës ndërkombëtare, ka teori dhe pikëpamje të ndryshme në lidhje me kohën dhe origjinën e lindjes së saj. E vërteta është se e drejta ndërkombëtare ka patur zhvillimin e saj historik” (Puto, 2010:34).

Në periudhën e bashkësisë primitive nuk bëhej fjalë për të drejtë, për aq kohë sa nuk kishte filluar krijimi i shteteve. Konfliktet që lindnin në shoqëri zgjidheshin me anë të normave zakonore. Shturja e bashkësive primitive u shoqërua me krijimin e shteteve të para skllavopronare dhe fillesat e para të së drejtës.

Në shtetet e para skllavopronare nuk mund të flitet për ndarje të së drejtës në degë, por në këtë kohë kanë fillesat nocionet e së drejtës, veprave penale dhe dënimeve, si dhe marrëdhënieve të para midis shteteve të ndryshme. “Zakonet u transformuan në lloje

dënimesh penale dhe morën formën e instituteve juridike, duke marrë fund periudha e mbrojtjes private ndaj veprimtarisë antishoqërore” (Muçi, 2007:12). Kjo periudhë në literaturën botërore është quajtur “periudhë e reagimit shtetëror publik kundër kriminalitetit” (Halili, 1985:11), duke i quajtur dënimet penale si mjete të hakmarrjes publike dhe shpagimit.

Duke qenë se kjo periudhë karakterizohet nga luftërat midis shteteve skllavopronare, edhe marrëdhëniet midis tyre fillimisht i përkisnin çështjeve të ndryshme që kishin të bënin me luftën.

Padyshim është herët të flitet për një të drejtë ndërkombëtare në kuptimin e vërtetë në atë kohë. Është fjala për një tog rregullash që përbëjnë atë që mund të quhet e drejta ndërkombëtare embrionale...

...Traktati më i vjetër, gjurmët e të cilit kanë arritur deri në ditët tona është një traktat që i përket shekullit XIII para erës së re. Këtu është fjala për traktatin që u përfundua në vitin 1278 para erës së re midis faraonit të Egjiptit, Ramses II dhe mbretit të hetëve, Hetushilit III. Në bazë të traktatit, palët merrnin përsipër të ndërprisnin veprimet ushtarake, t'i jepnin ndihmë njëri – tjetrit në luftën kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe të dorëzonin dezertorët... Traktati midis Ramsesit dhe Hetushilit ka shërbyer si model edhe për shumë traktate të tjera, që u përfunduan më vonë në kohën e lashtë (Puto, 2010:35-36).

Nisur nga sa parashikohej në traktatin midis Ramsesit dhe Hetushilit në vitin 1278 para erës së re, në të cilin përfshihej, midis të tjerash, dorëzimi i dezertorëve, mund të thuhet që ky traktat përfshinte elemente të institutit të ekstradimit. Në këtë kuptim, gjenezat e konceptit të ekstradimit, si forma të para të bashkëpunimit midis shteteve në fushën penale janë shfaqur pikërisht në vitin 1278 para erës së re. E drejta penale u përpunua në mënyrë të plotë në shtetin e Romës së Lashtë. “Këtu u krijua gjithashtu *jus gentium*, ku përfshiheshin midis të tjerash edhe norma të së drejtës ndërkombëtare, e cila pati një

rëndësi të madhe, ushtroi një influencë të fortë më vonë në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare në Evropën Perëndimore” (Puto, 2010:42).

“Gjatë mësjetës e drejta penale u zhvillua më tej dhe u shtua ideja e frikësimit të kriminelit dhe të personave të tjerë që të mos kryenin krime” (Muçi, 2007:9), duke e quajtur dënimin si mjet për ruajtjen e rendit juridik shtetëror, të rregullit dhe qetësisë publike. Nga ana tjetër, shtetet e hershme feudale përpiqeshin të zgjerinin territoret e tyre, nëpërmjet luftërave pushtuese dhe plaçkitëse.

As në këtë kohë nuk kemi shkencë të vërtetë të së drejtës ndërkombëtare. Baza që jep jeta ndërkombëtare e kësaj kohe, është përsëri e dobët dhe e pamjaftueshme për të ngritur mbi të një degë të veçantë të jurisprudencës. (Puto, 2010:50)

Megjithatë marrëdhëniet midis shteteve në periudhën e mesjetës kanë marrë karakterin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në këtë kohë kanë lindur edhe mjaft institute të së drejtës ndërkombëtare.

Sipas autorit të librit “Ekstradimi dhe urdhëri europian i ndalimit”, gjenezat e konceptit të ekstradimit janë shfaqur duke filluar që nga shekulli XIII, në qytet – shtetet dhe principatat italiane (Hoxha, 2011:30). Në fakt, siç u shpjegua më lart, gjeneza e ekstradimit është pikërisht në traktatin midis Ramsesit dhe Hetushilit në vitin 1278 para erës së re, ndërkohë që mund të thuhet, se në shekullin XIII është formëzuar instituti i ekstradimit, elemente të të cilit kishin lindur më parë. Në hapat e para, marrëdhëniet ndërshtetërore në procesin penal shfaqeshin në forma sporadike, të shkëputura dhe jo me baza ligjore të mirëpërcaktuara. Kjo mënyrë e bashkëpunimit u jepte mundësi monarkëve të ndëshkonin

armiqtë e tyre edhe kur ata ishin larguar nga shtetet e tyre, duke u dorëzuar nga shteti tjetër, gjë për të cilën vendoste nën diskrecionin e tij monarku i shtetit dorëzues.

Duhet theksuar pra, se në periudhën e mesjetës, ekstradimi është përdorur shumë rrallë, duke patur parasysh izolimin e tejskajshëm të shteteve dhe në mënyrë të veçantë traditën që ekzistonte lidhur me parimin e sovranitetit. (Hoxha, 2011:30-31)

Absolutizmi lidhet me zhvillimin e elementeve të kapitalizmit në gjirin e shoqërisë feudale, që u shoqërua me lindjen e ekonomisë së mallrave dhe ndryshime të mëdha sociale. Mbi bazën e këtyre faktorëve u krijuan disa shtete të përqendruar që kishin marrëdhënie tregtare shumë të zhvilluara midis tyre.

Karakteristikë kryesore e politikës së këtyre shteteve ka qenë lufta e ashpër për hegjemoni politike. Kjo është arsyeja që edhe marrëdhëniet ndërkombëtare të kësaj periudhe karakterizohen nga konflikte të pandërprera midis shteteve dhe nga shpërthimi i një vargu luftërash. (Puto, 2010:54)

Në këtë periudhë u krijuan forma të reja të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat u shoqëruan me krijimin e instituteve të rinj të marrëdhënieve ndërkombëtare. Këto institute kanë evoluar me zhvillimin e shoqërisë, por mbeten bazë edhe në të drejtën e sotme ndërkombëtare, siç janë: parimi i sovranitetit, parimi i barazisë së shteteve, etj.

Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare penale është e vështirë të gjesh një datë apo ngjarje që të përcaktojë fillimet e lindjes së të drejtës penale ndërkombëtare. Disa autorë mendojnë se ajo lidhet me shkollën e postglosatorëve në shekullin XVI, të tjerë mendojnë se shfaqja për herë të parë e interesit të përbashkët të shteteve për të dënuar krimet ndërkombëtare ka lindur në shekullin XVII bashkë me piraterinë. (Xhafo, 2012:15-16)

“Megjithë mendimet e ndryshme të doktrinës, është fakt që në periudhën e absolutizmit lind shkenca e së drejtës ndërkombëtare, si degë më vete e jurisprudences” (Puto,

2010:58). Në këtë periudhë dolën edhe një varg autorësh të rëndësishëm që shprehën idetë e tyre mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ato në fushën penale më specifikisht.

... detyrimi për të ekstraduar ose gjykuar – aut dedere aut judicare – parashikohet në forma të ndryshme, në disa konventa dypalëshe...

...Shprehja latine aut dedere aut judicare përfaqëson një përshtatje bashkëkohore të shprehjes origjinale aut dedere aut punire, përdorur për herë të parë nga Hugo Grocious, që do të thotë “ose ekstrado ose ndëshko”. Në veprën e tij “De iure belli ac pacis” ky autor parashikoi për herë të parë parimin aut dedere aut punire, duke mbështetur tezën e tij sipas të cilës të gjitha shtetet janë të detyruara “të dorëzojnë ose ndëshkojnë penalisht çdo person që ka shkelur ligjin”... (Hoxha, 2011:31)

Koha e re me idealet e lirisë dhe demokracisë të revolucionit francez të vitit 1789 tronditi themelet e sistemit feudo – monarkik dhe do të shoqërohej me transformime të thella të organizimit të shteteve, rrjedhimisht të të drejtave të tyre. Në këtë periudhë kishte një kuptim të ri të së drejtës ndërkombëtare që u shoqërua edhe me lindjen e disa instituteve të reja të saj, siç janë: e drejta diplomatike, e drejta e traktateve, etj.

Zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet shteteve në fusha të ndryshme, si dhe rritja e numrit të shteteve të pavarura, shtuan nevojën për krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit edhe në fushën penale. (Hoxha, 2011:33)

Në mesin e shekullit XVIII disa shtete europiane filluan të bashkëpunonin mes tyre mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe të ekstradimit. Më pas lidhja e këtyre lloj marrëveshjesh u shtri gjërësisht në Europë dhe më gjerë. Edhe gjatë shekullit XIX bashkëpunimi në fushën penale vazhdoi me dorëzimin e autorëve të veprave penale të kapur në territorin e një shteti tjetër, që kryhej nëpërmjet institutit të ekstradimit. Ky institut realizohej nëpërmjet marrëveshjeve përgjithësisht dypalëshe midis shteteve.

Vetëm në fundin e shekullit të XIX dhe fillimin e shekullit të XX gjejmë një zhvillim konstant të instrumenteve ndërkombëtare që kanë për qëllim dënimin e sjelljeve të caktuara të

konsideruara kriminale, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve në luftë kundër akteve kriminale...

...Kjo periudhë karakterizohet gjithashtu nga hartimi i një tërësie konventash si Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e të plagosurve dhe të sëmurëve gjatë kohës së luftës 1864, Konventat e Hagës më 1899 dhe 1907, të cilat përcaktuan rregullat dhe parimet me qëllim humanizmin e luftës dhe mënjanimin e mjeteve dhe mënyrave të ndaluara të saj. E drejta penale ndërkombëtare merr zhvillim të plotë pas Luftës së I Botërore ... (Xhafo, 2012:16-17)

Në të njëjtën kohë, në shekullin XIX kanë fillesat bashkëpunimet e ndihmës së ndërsjellë juridike në fushën penale, si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, midis shteteve të Europës dhe më gjerë.

Nga dokumentat e Këshillit të Evropës, na rezulton se traktati më i hershëm ka qenë ai i ekstradimit dhe i ndihmës së ndërsjellë juridike mes Italisë dhe Monakos, që mban datën 19.05.1866. Më tej, duke vazhduar në vitin 1870 me traktatin mes Belgjikës dhe Suedisë, fillon një shkëmbim intensiv traktatesh dy palëshe mes shteteve evropiane...

Traktati më i hershëm i lidhur mes vendeve jo evropiane rezulton të jetë Traktati i Ekstradimit i datës 21.9.1872, lidhur ndërmjet Italisë dhe San Salvadorit. Kjo marrëveshje u pasua pas një viti dhe në vazhdim me lidhjen e mjaft marrëveshjeve mes shteteve të ndryshme të Evropës me vende, si: Kina, Kili, Meksika, Liberia, Peruja, Tanzania, Filipinet, Pakistani, Kenia, Bahamasi, Zambia, SHBA-ja, Xhamajka, etj.

Hap të mëtejshëm në zgjerimin e juridiksionit gjyqësor, tej atij dypalësh, bënë vendet e BENELUKS-it, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu, të cilat marrëveshjet e tyre i zgjeruan nga dy, në trepalëshe, duke zhvilluar konceptin e mundësisë së bashkëpunimit me më shumë se dy shtete. (Islami et al, 2012:697)

Dy luftërat botërore të shekullit XX kanë ndikuar shumë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Periudha pas Luftës së Parë Botërore karakterizohet nga rritja e bashkëpunimit midis shteteve, sidomos atyre që fituan luftën, të cilët synonin të fuqizonin pozitën e tyre nëpërmjet arritjes së stabilitetit. Ky bashkëpunim gjeti shprehjen e tij në krijimin e një sërë organizatash ndërkombëtare dhe jo vetëm.

Organizatat Ndërkombëtare hynë në jetën e bashkësisë ndërkombëtare si bashkime shtetesh sovranë me synimin për të ruajtur paqen dhe sigurinë botërore, për të promovuar bashkëpunimin e shteteve për progresin politik, ekonomik, social, kulturor, etj. (Krisafi, 2014 b: 168)

Kështu, në këtë periudhë u krijuan organizata që kishin karakter tekniko – administrativ (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë, etj.); politik (Lidhja e Kombeve për periudhën 1919 – 1940), etj. Në të njëjtën kohë, pas Luftës së Parë Botërore lindi një institut i ri i së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Ndërkombëtare (1920), që shërbente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve. Po me këtë periudhë përkon edhe lindja e konceptit të marrjes në përgjegjësi penale të personave që kishin provokuar apo urdhëruar luftën nga institucione ndërkombëtare. Në vitin 1919, fituesit e luftës nënshkruan në Versajë traktatin e paqes me Gjermaninë. “Në nenin 227 të tij parashikohej krijimi i një “gjykate speciale” të përbërë nga pesë gjyqtarë (të caktuar nga USA, Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia)” (Cassese et al, 2012:253), me detyrë për të dënuar Perandorin gjerman (Wilhelm II). Edhe më pas vazhduan përpjekjet për krijimin e autoriteteve me juridiksion ndërkombëtar, me qëllim gjykimin dhe dënimin e autorëve të krimeve të luftës në Konferencën e Gjenevës (1937), përpjekje të cilat nuk ishin të suksesshme për një kohë të gjatë.

E drejta ndërkombëtare në shekullin XX është zhvilluar nën shenjë të krijimit dhe të veprimtarisë së organizatave ndërkombëtare. Këto organizata që kanë një numër gjithnjë e më të madh shtetesh anëtare dhe që hyjnë në sfera të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, i japin sot formë të organizuara jetës ndërkombëtare. (Puto, 2010:79)

“Dështimet e pësura pas Luftës së Parë Botërore, siç ishte rasti i Lidhjes së Kombeve, e cila nuk arriti të realizojë objektivat e saj për të shpëtuar njerëzimin nga flakët e luftës dhe për të krijuar një botë të sigurt, pa luftra dhe konflikte” (Krisafi, 2014 b:169), shërbyen që

pas Luftës së Dytë Botërore veprimtaria e organizatave ndërkombëtare të hyjë në një fazë të re, më të zhvilluar dhe të pajisur me kuadrin ligjor përkatës. Në vitin 1945 u krijua Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe më pas Këshilli i Europës në vitin 1949.

Këshilli i Europës, duke marrë përvojën më të mirë të fituar nga marrëveshjet e ngushta, dizenjoi dhe miratoi me vullnetin e mirë të shteteve anëtare të saj, një sërë konventash në fushën penale, të cilat ndër vite bënë të mundur bashkëpunimin e vendeve evropiane në fushën penale, me synimin final të parandalimit më të mirë të krimit, dënimit të fajtorëve dhe administrimit më të mirë të drejtësisë. I gjithë ky proces nuk ka qenë i lehtë dhe ka kaluar në fazat e tij të zhvillimit. (Islami et al, 2012:698)

Gjatë shekullit XX ndodhi gjithashtu një zhvillim i vrullshëm social, ekonomik, politik e teknologjik, që ndikoi shumë në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në të gjitha fushat e jetës, përfshirë këtu edhe në fushën e së drejtës penale. Ky zhvillim i gjithanshëm i shoqërisë u pasua me lëvizje të njerëzve nga njëri shtet në tjetrin, sidomos në drejtim të vendeve më të zhvilluara, duke emigruar atje, me qëllim për të siguruar një jetë më të mirë. Kjo lëvizje e njerëzve u shoqërua edhe me pamundësinë e ndëshkimit të të gjithë autorëve të veprave penale, duke pasur parasysh parimet e sovranitetit absolut dhe të territorialitetit të së drejtës penale.

Për të shmangur dënimin, autorët e veprave penale, duke përfituar nga parimi i sovranitetit dhe juridiksionit territorial, mund të largoheshin lehtësisht nga vendi ku kishin kryer veprën dhe të zhvendoseshin diku tjetër, duke vështirësuar kështu e për të mos thënë, duke e bërë të pamundur, ndjekjen penale dhe dënimin e tyre nga autoritetet kompetente. (Hoxha, 2011:35)

Në të njëjtën kohë, lëvizja e lirë e njerëzve shoqëruar edhe me zhvillimet e vrullshme të teknologjisë ndikuan në krijimin e formave të reja të krimit, më të sofistikuara dhe më të organizuara, që rritën domosdoshmërinë e zgjerimit të bashkëpunimit midis shteteve në procesin penal për të luftuar këto lloj krimesh.

Të gjithë këta faktorë bënë që ky bashkëpunim të mos mbetet tashmë vetëm në kufijtë e ekstradimit, por të zgjerohej me forma të reja bashkëpunimi në fushën penale, gjë që u pasua edhe me krijimin e disa konventave në këtë fushë.

Në përgjithësi shekulli XX është periudha e transformimeve të mëdha në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Intensifikimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, nga njera anë, dhe ndërgjegjësimi i subjekteve për ndërvlerësinë e tyre gjithnjë më të madhe, nga ana tjetër, i kanë dhënë një shtytje të fortë përpunimit normativ të së drejtës ndërkombëtare. (Puto, 2010:82)

Kështu, konventat e para të Këshillit të Europës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin penal, konkretisht ajo “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” datë 20.04.1957 dhe ajo “Për ekstradimin” datë 13.12.1957, u pasuan më vonë me një sërë konventash të tjera me qëllim luftën kundër krimit, veçanërisht format e organizuara të tij që u zhvilluan si pasojë e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi. Nisur nga fusha e studimit, vlen të përmenden, midis të tjerash:

- Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale” në 29.01.1965;
- Konventa “Për vlerën ndërkombëtare të gjyqimeve penale” e vitit 1970;
- Konventa “Për transferimin e procedimeve në fushën penale” 15.05.1972;
- Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” datë 21.03.1983;
- Konventa mbi “Bashkëpunimin Policor të Europës Juglindore” datë 31.03.2006.

Këto konventa janë pasuar edhe me miratimin e protokolleve shtesë të tyre, si instrumente ndërkombëtare të detyrueshme, me qëllim për të lehtësuar aplikimin e tyre.

“Zhvillimi i legjislacionit europian është shoqëruar edhe me përmirësime të legjislacionit të brendshëm të shteteve pjesëmarrëse me qëllim njësimin e legjislacioneve” (Islami et al, 2012:699).

Ndërkohë, në këtë periudhë janë miratuar një sërë konventash për bashkëpunimin në luftën për krime të një fushë të caktuar, si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit” (1977), Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope datë 20.12.1988, Konventa europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” datë 08.11.1990; etj.

Në nivel ndërkombëtar, kriminalizimi i sjelljeve individuale është një fenomen i ri, që doli në pah kryesisht rreth fillimit të viteve '90. Deri në atë kohë, e drejta ndërkombëtare ishte thjesht një mjet i përdorur nga shtetet për të arritur bashkëpunim më të fortë në çështjet ligjore për ndëshkimin e kriminalitetit ndërkombëtar. Gjatë dekadave të para të shekullit të njëzetë, traktatet për luftën kundër krimeve si falsifikimi, shfrytëzimi, trafikimi i grave dhe fëmijëve lindën dhe u zhvilluan përgjatë shekullit deri në ditët e sotme, si për të luftuar krimet e terrorizmit, pastrimin e parave, korrupsionin, etj. (Cassese et al, 2012:18)

Në të njëjtën kohë, pas Luftës së Dytë Botërore u rikthehsua koncepti i krijimit të organizmave ndërkombëtare dhe ndëshkimi i autorëve të krimeve të luftës u kthye në domosdoshmëri. Kështu me marrëveshjen e Londrës, datë 08.08.1945, u vendos formimi i Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake të Nurenbergut për gjykimin dhe ndëshkimin e kriminelëve kryesorë të luftës, duke hartuar edhe statutin e saj. Më pas u krijua Gjykata Ndërkombëtare Ushtarake e Tokios, më 15.01.1946. Veprimtaria e këtyre dy gjykatave shërbeu si bazë për veprimtarinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, veçanërisht

Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare dhe nxjerrjen e akteve të saj. Kjo veprimtari u pasua me miratimin e disa konventave, si psh: Konventa “Mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit” (09.12.1948), katër konventat e Gjenevës mbi të drejtën humanitare (12.08.1949), etj., në të cilat janë sanksionuar parimet e përgjegjësisë penale ndërkombëtare të autorëve të krimeve dhe juridiksionit universal. Më pas Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara krijoi në vitin 1993 Gjykatën Ndërkombëtare Penale për gjykimin e personave për krime të kryera në territorin e ish – Jugosllavisë dhe në vitin 1994, krijoi Gjykatën Ndërkombëtare Penale për gjykimin e personave për krime të kryera në lidhje me gjenocidin në Ruandë. Krijimi i këtyre gjykatave vuri në pah edhe një herë nevojën e krijimit të gjykatave penale ndërkombëtare të përhershme.

Kështu, në Konferencën e mbajtur në Romë më 17.07.1998, u përpilua Statuti për krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare me juridiksion me karakter të përhershëm, “e cila përbën pikën kulminante të zhvillimit të së drejtës penale ndërkombëtare në përgjithësi dhe konceptit të përgjegjësisë penale në veçanti” (Xhafo, 2012:24). Pavarësisht përpilimit në vitin 1998, ky statut ndeshi në vështirësi të shumta, për shkak të rezervave ndaj tij nga ana e disa shteteve dhe u deshën pothuajse katër vjet, që Statuti i Romës të hyjë në fuqi në 01.07.2002, kur daton edhe krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, e cila ka karakter të përhershëm. “E drejta penale ndërkombëtare gjen zhvillim të mëtejshëm në një dimension të ri me lindjen e Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Hagës” (Xhafo, 2012:22).

Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është, pa dyshim, një nga zhvillimet më spektakolare në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Ajo tashmë është një mekanizëm permanent për të gjykuar e dënuar personat që kryejnë krime veçanërisht të rënda, si krime luftime, krime kundër njerëzimit, krimi i agresionit dhe gjenocidit. (Zaganjori, 2012:82)

Pavarësisht krijimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale të përhershme, juridiksioni i saj është i kufizuar në gjykimin e veprave penale me rëndësi ndërkombëtare, konkretisht: genocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, agresioni, tortura dhe terrorizmi. Ndërkohë, aktualisht në botë janë përhapur mjaft vepra penale me rrezikshmëri të madhe, që shtrihen në më shumë se një shtet, siç janë trafiqet e ndryshme, krimet në fushën e korrupsionit, pastrimi i parave dhe produkteve të veprës penale, etj., hetimi dhe gjykimi i të cilave mund të arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit midis autoriteteve gjyqësore të shteteve. Në të njëjtën kohë, edhe për krime më të lehta, shpesh lind nevoja që për grumbullimin e të dhënave dhe provave për akuzën, me qëllim ndëshkimin e autorëve të veprave penale lind nevoja e bashkëpunimit midis autoriteteve gjyqësore të shteteve. Në këtë kontekst, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal mbeten aktualisht një mjet tepër i rëndësishëm në arritjen e qëllimit final të së drejtës penale.

2.7. Lindja dhe evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri

Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera, evoluimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në procesin penal ka kaluar në të njëjtat shkallë si edhe shteti.

Lindja e shtetit lidhet me shthurjen e bashkësive primitive dhe krijimin e shteteve të para skllavopronare.

Në shoqërinë ilire parashtetërore, të organizuar në bazë fisesh, kishte rregulla sjelljeje, zbatimi i të cilave bëhej në mënyrë të ndërgjegjshme, për shkak të forcës së zakonit të trashëguar brez pas brezi... Disa prej tyre u sanksionuan nga shteti dhe morën fuqi të detyrueshme, karakter juridik. (Krisafi, 2014 b:34-35)

Përsa i përket shteteve iliroshqiptare të kësaj kohe, mungojnë burimet dokumentare të së drejtës, por ajo mbështetet në ligjet e pushtuesve, si Kodi i Justinianit, dhe në të drejtën zakonore ilire, rregullat e së cilës shfuqizoheshin apo shndërroheshin në ligje nga ligjet e pushtuesve.

E drejta e shteteve skllavopronare ilire në Shqipëri paraqet përgjithësisht të njëjtat karakteristika me ato të shteteve skllavopronare të botës. Mendohet që edhe shtetet skllavopronare të Shqipërisë kanë krijuar marrëdhënie me shtetet fqinje, por nuk ka të dhëna dokumentare të plota për llojin e marrëdhënieve.

Një fragment “stelle”¹ është gjetur edhe në vendin tonë, në qytetin e vjetër të Durrësit. Duket se është fjala për një marrëveshje të përfunduar midis kolonive helenike të Durrësit, Apolonisë dhe Korinthit. (Puto, 2010:38)

Në mesjetë Shqipëria ka qenë pothuajse gjatë gjithë kohës e pushtuar nga sllavët dhe nga turqit, për rrjedhojë në territorret e saj vepronin normat e së drejtës së pushtuesve. Pavarësisht kësaj, në Shqipëri krahas së drejtës të të huajve, në shekullin XV zinin vend edhe normat e të drejtës zakonore sipas krahinave të ndryshme, siç janë: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Statuti i Shkodrës, etj. Gjatë kësaj periudhe ka pasur përpjekje të shqiptarëve për krijimin e një shteti shqiptar sovran. Lidhja Shqiptare e Lezhës në vitin 1444 ishte vetëm një aleancë politike dhe ushtarake midis zotërve feudalë

¹ **Shënim:** “Stella” ishin pllaka mermeri ose guri në të cilat fiksoheshin marrëveshjet midis shteteve në formë të shkruar, të cilat ekspozoheshin në sheshe ose tempuj.

shqiptarë. Në vitet 1450 – 1453 u krijua një shtet shqiptar i pavarur nën udhëheqjen e Skënderbeut, i cili kishte karakter kryesisht luftarak dhe iu përkushtua ushtrisë dhe ndërtimit të fortifikimeve. Ky shtet pati një organizim qeverisës dhe mbështetjesh mbi të Drejtën Feudale, e cila kishte edhe individualitet kombëtar. E Drejta që vepronte në Shqipëri gjatë periudhës së Skënderbeut ishte e zhvilluar, dhe kishte një varg normash në fusha të ndryshme të jetës, përfshirë këtu edhe në atë të së drejtës penale, duke parashikuar masa shtrënguese për veprat penale. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, Shqipëria nuk arriti të ketë një shtet sovran e të pavarur, për rrjedhojë mund të thuhet që edhe në këtë periudhë karakteristikat e së Drejtës në Shqipëri përputheshin me ato të shteteve feudale të botës, por nuk mund të flitet për marrëdhënie ndërkombëtare të saj.

Në kohën e re, ndërkohë që e drejta ndërkombëtare në përgjithësi, dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale në botë, kishin filluar që në kohë të hershme, Shqipëria vuante sundimin nga pushtues të ndryshëm. Historia e fillimeve të një të Drejte të mirëfilltë dhe të Drejtës Penale si degë e veçantë në Shqipëri, lidhet me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe qeverisë së Vlorës më 1912. Periudha nga viti 1912 deri më 1944 është një nga periudhat më të rëndësishme të shtetit shqiptar, për vetë ngjarjet e rëndësishme historike të kohës, që patën ndikim të madh midis të tjerash edhe në fushën e të drejtës penale. Krijimi i shtetit shqiptar u përball me vështirësi të shumta, për shkak të pengesave që erdhën si pasojë e zhvillimit të Luftës së Parë Botërore, pretendimeve territoriale të disa shteteve ndaj Shqipërisë, si dhe të përçarjes brenda vendit. Përpjekjet e

Qeverisë së Vlorës për organizimin e shtetit të ri shqiptar nuk ishin të suksesshme deri më 30 janar 1920, kur u krijua Qeveria Kombëtare Shqiptare.

Për sistem të drejtësisë penale në Shqipëri, në kuptimin e plotë të fjalës, mund të flitet vetëm pas miratimit të Statutit të Lushnjës (1920) dhe Statutit të zgjeruar të Lushnjës (1922) e në vazhdim deri në vitin 1939. (Elezi, 2001 b:3)

Periudha 1920 – 1924 ishte shembull i funksionimit të demokracisë parlamentare, e cila u shoqërua me konsolidimin e bazës juridike ligjore me Statutin e Lushnjës. Në këtë kohë u miratua një kushtetutë model për kohën, e cila përfshin modelin e demokracisë deri edhe të drejtat e njeriut. Po në këtë periudhë e deri në vitin 1928 u bë i mundur organizimi i drejtësisë, si dhe u plotësua kuadri ligjor, nëpërmjet miratimit të disa ligjeve të rëndësishme, midis të cilëve Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale. Ligjet e miratuara në këtë kohë u orientuan nga parimet e së drejtës europiane, duke ndjekur kryesisht modelin e legjislacionit italian dhe francez. Pikërisht në këtë periudhë, pas pranimi të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në 17 dhjetor 1920, filluan marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë me shtetet e tjera, midis të cilave edhe ato në fushën e së drejtës penale.

Më 25.01.1925 Kuvendi Kushtetues shpalli Republikën Shqiptare dhe Ahmet Zogu u zgjodh kryetar i republikës, duke qenë në të njëjtën kohë edhe kreu i pushtetit ekzekutiv. Gjatë kësaj kohe, Ahmet Zogu riktheu stabilitetin në vend, si dhe mundësoi nënshkrimin e marrëveshjeve të rëndësishme ekonomike, politike e ushtarake që forcuan pozitën e Shqipërisë. Duke pasur tashmë një legjislacion të konsoliduar, si dhe duke pasur vullnet politik për luftën kundër kriminalitetit, në këtë periudhë marrëdhëniet juridiksionale me

autoritetet e huaja në procesin penal morën një zhvillim të rëndësishëm në Shqipëri, kohë kjo që u kurorëzua midis të tjerash me nënshkrimin e disa marrëveshjeve dypalëshe me shtete të tjera për ekstradimin e kriminelëve, konkretisht: Konventa “Mbi ekstradimin e keqbërësve” me Mbretërinë e Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë, e cila është nënshkruar në 7 qershor 1926 në Beograd dhe aprovuar në dhjetor 1926 (Fletore zyrtare nr.221, 18 Dhjetuer 1926:1-4)²; traktati i ekstradimit i nënshkruar me Greqinë më 25.06.1926 (Fletore zyrtare nr.221, 18 Dhjetuer 1926:4-9)³; konventa “Mbi ekstradimin e keqbërësve” me Britaninë e Madhe, e nënshkruar në Tiranë dhe e aprovuar më datë 17.12.1926 (Fletore zyrtare nr.221, 18 Dhjetuer 1926:9-12)⁴. “Gjatë së njëjtës periudhë me Mbretërinë e Serbisë lidhet edhe një traktat i dytë për ndihmën e ndërsjellë në fushën penale” (Hoxha, 2011:72) që është marrëveshja e para e këtij lloji.

Paqëndrueshmëria e stabilitetit politik të vendit në vitet '20, detyroi një grup parlamentarësh të propozonin shqyrtimin e regjimit shtetëror në Shqipëri dhe më 30.08.1928 forma e qeverisjes u ndërrua nga republikë në monarki me mbret të mbretërisë së shqiptarëve Zogun I, i cili ka qenë i suksesshëm në shtetndërtim, në zhvillimin ekonomik, në krijimin e legjislacionit dhe në seriozitetin e organizimit të veprimtarive shtetërore. Gjatë kësaj periudhe, më 01.03.1933 është nënshkruar traktati i ekstradimit me

² **Shënim:** Konventa ka titullin origjinal “*Mbi Exstradimin e keqë-bërësve në mest të Republikës Shqiptare e të Mbretwrisë së Serbëvet, Kroatvet dhe Slovenëvet*”.

³ **Titulli orgjinal:** Traktat ekstradimi në mes të Greqisë e të Shqipërisë

⁴ **Shënim:** Konventa ka titullin origjinal “*Mbi Ekstradimin e keqë-bërsvet në mes të Republikës Shqiptare e të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe*”.

Fletorja Zyrtare nr.221 ku janë botuar aktet e vitit 1926 është marrë nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë.

ShBA-në dhe Konventa me Republikën Çekoslloake mbi ekstradimin dhe ndihmën gjyqësore në çështjet penale, e cila është nënshkruar në Pragë më 14.04.1934, aprovuar në datë 24.02.1938 (Fletorja Zyrtare nr.16, 16 Mars 1938:1-8)⁵. Sipas kësaj Konvente, ndihma gjyqësore në çështjet penale, është parashikuar në Kaptinën e II, nenin 17 të saj, më konkretisht:

Palët Kontraktuese do t'i ndihmojnë njena tjetrës në çështje penale. Posaçërisht do t'i u komunikojnë personave që ndodhen mbi tokën e tyre akte të procedurës penale, do të procedojnë në veprime hetimore, si ndigjim i dëshmitarve, ekspertime, konstatim gjyqsor, përkërkime (perquisitions) dhe sekvestrime sendesh, dhe do t'i dorëzojnë njena tjetrës aktet gjyqsore dhe dokumentat e sendet bindëse. (Fletorja Zyrtare nr.16, 16 Mars 1938:5-6)⁶

Në këtë konventë, ndër të tjera, gjithashtu është parashikuar thirrja dhe paraqitja e personave (neni 19), dorëzimi i dokumentave dhe sendeve bindëse (neni 20), si dhe njoftimi i vendimeve të dënimit dhe i buletineve të gjendjes gjyqsore (neni 21).

Pas largimit të mbretit Zog I në vitin 1939, gjatë Luftës II Botërore Shqipëria ka qenë e pushtuar nga Italia dhe Gjermania. Më tej, pas Luftës së Dytë Botërore, me vendosjen e regjimit komunist totalitar, Shqipëria jetonte në një izolim të plotë të të gjithë shoqërisë, përfshirë edhe atë juridik, duke ndjekur parimin e “mbështetjes në forcat e veta”. Në periudhën 1945 – 1990 në Shqipëri funksiononte pushteti i diktaturës së proletariatit dhe luftës së klasave, ku e drejta i shërbente partisë – shtet. Kodi Penal i vitit 1952 kishte disa dispozita që mbronin parimin e ligjshmërisë, por si në këtë kod, ashtu edhe në ligjet e tjera

⁵ **Titulli origjinal:** Konventë midis Mbretënis Shqiptare dhe Republikës Çekoslloake “Mbi Ekstradimin dhe ndihmën gjyqsore në çështjet penale”

⁶ **Shënim:** Fletorja Zyrtare nr.16 e vitit 1938 është marrë nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë.

penale të kësaj periudhe nuk mund të flitet për parime demokratike që reflektoheshin në të drejtat e shteteve të tjerë të zhvilluar në këtë kohë. Legjislacioni penal cilësohej si armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit në luftën e klasave sipas nenit 1 të Kodit Penal të vitit 1977 (Byroja juridike pranë Këshillit të Ministrave, 1982:401-402). Sipas nenit 2 të po këtij Kodi ai udhëhiqej nga politika e Partisë së Punës së Shqipërisë, si dhe bazohej në ideologjinë e klasës punëtore, në marksizëm-leninizmin. Nisur nga gjithë këto, për sa i përket kësaj periudhe, nuk mund të flitet për marrëdhënie juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Si në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Kodet Penale dhe Kodet e Procedurës Penale të kësaj periudhe nuk përmbanin asnjë parashikim, në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Ky izolim dhe mungesa e marrëdhënieve me autoritetet e huaja pasohej shpesh me mosndëshkim të autorëve të veprave penale, gjë që gjente shprehje edhe në nenin 97/2 të K. Pr. Penale (Byroja juridike pranë Këshillit të Ministrave, 1982:588), sipas të cilit një çështje penale mund të pezullohej edhe në rastet kur autori i veprës penale nuk gjendej. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria ka aderuar në disa konventa, si: Konventa mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit, New York, 09.12.1948 (ratifikuar në 1951); Konventa për mos parashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, New York, 26.11.1968 (ratifikuar në 1971); etj. Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka lidhur disa marrëveshje dypalëshe për ndihmë të ndërsjellë juridike me disa shtete të ish – bllokut komunist, si psh: Çekosllovakinë (1959), Rumaninë (1960), Hungarinë (1960), Rusinë

(1969). Autoriteti që ushtronte kontaktin me autoritetet e huaja në ushtrimin e marrëdhënieve juridiksionale në procesin penal e ushtronte Prokuroria e Përgjithshme. Pavarësisht marrëveshjeve për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën penale të përmendura më lart, të gjitha aktet ndërkombëtare e humbën fuqinë e tyre pas denoncimit të tyre nga pushteti i asaj kohe në Shqipëri.

*Lidhur me konceptin dhe format e bashkëpunimit penal që parashikohen në këto marrëveshje, duhet theksuar së kufizoheshin në detyrimin e ndërsjellë që shtetet merrnin përsipër, në drejtim të dorëzimit të shtetasve të tyre të arratisur dhe që gjendeshin në territorin e shtetit tjetër...
...Megjithatë, sikurse kemi theksuar më sipër, mungesa në kodin e procedurës penale e dispozitave me karakter të përgjithshëm, e bënin thuajse të pamundur bashkëpunimin efektiv qoftë edhe me vendet me të cilat ishin lidhur marrëveshjet dypalëshe. Në këto kushte, edhe pse këto marrëdhënie ekzistonin, marrëdhëniet e ekstradimit kanë qenë minimale, thuajse inekzistente. (Hoxha, 2012:74)*

Në vijim të këtij parashtrimi, vlen të theksohet, se me vendosjen e regjimit komunist, në Shqipëri zhvillimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja pësoi një sprapsje të dukshëm për shkak të izolimit të Shqipërisë dhe ndërprerjes së marrëdhënieve ndërkombëtare të saj.

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal morën zhvillim real vetëm pas ndryshimeve demokratike të Shqipërisë që ndodhën në fillim të viteve '90, kohë që shënoi kalimin nga një sistem totalitar në një sistem demokratik. Këto ndryshime u pasuan me një kthesë rrënjësore në historinë e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij. Orientimi demokratik i shtetit kërkonte kryerjen e reformave të gjithanshme, midis të cilave edhe shndërrimin demokratik të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në kuadër të reformave institucionale, në shtetin e ri demokratik shqiptar, ligjvënësi shqiptar u detyrua

të bënte ndryshime në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë. Në vitin 1995 u miratuan Kodi i ri Penal dhe Kodi i ri i Procedurës Penale, të cilët zënë një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Këto Kode janë ndërtuar sipas modeleve të kodeve penale bashkëkohore të disa shteteve demokratike europiane (kryesisht Itali, Francë, Gjermani). Për kohën në të cilën u miratuan, ata i përgjigjeshin deri diku standarteve ndërkombëtare.

Ligji penal nuk është statik dhe i pandryshueshëm, përkundrazi ai ndryshohet e plotësohet në varësi nga kushtet social ekonomike e politike të vendit dhe nga kërkesat objektive të praktikës gjyqësore.(Elezi et al, 1999:16)

Kështu, pas vitit 1995, me zhvillimet e vrullshme të shoqërisë shqiptare, këto Kode janë ndryshuar dhe plotësuar, me qëllim përmirësimin e tyre dhe përafrimin me nivelet ndërkombëtare.

Megjithëse në vitin 1995 u miratua Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (1998) dhe nevoja e përqasjes së legjislacionit me Kushtetutën dhe konventat e miratuara diktuan nevojën e rishikimit të ligjeve ekzistuese, të miratuara pak kohë më parë, si dhe miratimit të një sërë ligjesh të tjera të reja. (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2006:78)

Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, këto kode u pasuan edhe me miratimin e ligjeve të tjera në këtë fushë, konkretisht: ligji Nr. 10039, “Për ndihmën juridike”, i miratuar në datë 22.12.2008 dhe ligji Nr. 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), i miratuar në datë 03.12.2009.

Nga ana tjetër, hapja e Shqipërisë dhe ndryshimet kushtetuese të vitit 1991, sollën pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konventat ndërkombëtare dy apo shumëpalëshe në fushën e

marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, nga të cilat vlen të përmenden:

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për ekstradimin” e 13 dhjetorit 1957 dhe të tre protokollet shtesë të saj, përkatësisht të 15 tetorit 1957, të 17 marsit 1978 (ratifikuar me ligjin Nr. 8322, datë 09.04.1998) dhe 10 nëntorit 2010 (ratifikuar me me ligjin Nr. 10426, datë 02.06.2011);
- Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e proçedimeve në çështjet penale” (ratifikuar me ligjin Nr. 8497, datë 29.06.1999);
- Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” e 20 prillit 1957 dhe të protokollit të saj shtesë (ratifikuar me ligjin Nr. 8498, datë 29.06.1999, ndryshuar me ligjin Nr.9539, datë 22.05.2006); si dhe protokollit të dytë shtesë (ratifikuar me ligjin Nr.8883, datë 18.04.2002);
- Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” e datës 21.03.1983 (ratifikuar me ligjin Nr. 8499, datë 29.06.1999);
- Marrëveshja Europiane “Për transferimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore” (ratifikuar me ligjin Nr.8705, datë 01.12.2000) dhe protokollit shtesë të saj (ratifikuar me ligjin Nr.8882, datë 18.04.2002);
- Konventa europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht (ratifikuar me ligjin Nr.8724, datë 26.12.2000);

- Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (ratifikuar me ligjin Nr.8984, datë 23.12.2002);
- Konventa Europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale (ratifikuar me ligjin Nr.9068, datë 15.05.2003);
- Konventa mbi bashkëpunimin policor të Europës Jugperëndimore e datës 31.03.2006 (ratifikuar me ligjin Nr.9604 datë 11.09.2006), ku palë janë Republika e Shqipërisë, Bosnia dhe Herzegovina, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania, bashkimi shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi;
- Konventa “Për akses ndërkombëtar në drejtësi” (ratifikuar me ligjin Nr. 9753, datë 14.06.2007).

Përveç këtyre konventave, Shqipëria ka ratifikuar edhe një sërë aktesh të tjera ndërkombëtare mbi luftën kundër krimeve në fusha të caktuara, ndër të cilat:

- Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit” (ratifikuar me ligjin Nr.8642, datë 13.07.2000) dhe protokollit ndryshues të saj (ratifikuar me ligjin Nr.9230, datë 13.05.2004);
- Konventa Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” (ratifikuar me ligjin Nr.8646 datë 20.7.2000);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope (ratifikuar me ligjin Nr.8722, datë 26.12.2000);

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet e saj: protokollin kundër trafikimit të migrantëve dhe protokollit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve (ratifikuar me ligjin Nr. 8920, datë 11.07.2002).
- Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit (ratifikuar me ligjin Nr.8865, datë 14.03.2002);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet e saj shtesë (ratifikuar me ligjin Nr.8920, datë 11.07.2002);
- Konventa penale për korrupsionin (ratifikuar me ligjin Nr.8778, datë 14.04.2005) dhe protokollit të saj shtesë (ratifikuar me ligjin Nr.9245, datë 24.06.2006);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (ratifikuar me ligjin Nr.9492, datë 13.03.2006).

Nga ana tjetër, Shqipëria ka ratifikuar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale në procesin penal, ndër të tjera me shtetet si: Greqia (1993), Turqia (1995), Rusia (1996), Maqedonia (1998), Italia (2004, 2007, 2008), Kosova – UMNİK (2006), Belgjika (2011), etj.

Në të njëjtën kohë Shqipëria ka ratifikuar:

- Marrëveshje bashkëpunimi për luftën kundër krimeve, veçanërisht format e organizuara të tij, me shtetet si: Sllovenia (1998), Bullgaria (1999), Hungaria (2000), Rumania (2002), Republika Arabe e Egjiptit (2002), Maqedonia (2004), Italia (2007);

Spanja (2009); Çekia (2009), Bosnia dhe Hercegovina (2009), Letonia (2010) dhe Serbia (2010); etj.

- Marrëveshje bashkëpunimi policor në luftë kundër krimit, me shtetetet si: Italia (2003), Belgjika (2005), Zvicra (2006), EULEX (2012). Gjithashtu, Republika e Shqipërisë aderon në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL (me ligjin Nr.8427, datë 14.12.1998).

Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu marrëveshje shumëpalëshe me grupe shtetesh, si:

- Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar (ratifikuar me ligjin Nr.8541, datë 21.10.1999), si dhe karta për organizimin e funksionimit të Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar (ratifikuar me ligjin Nr.8639, datë 13.7.2000);
- Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara (ratifikuar me ligjin Nr. 8512, datë 15.07.1999) dhe protokollit shtesë për luftën kundër terrorizmit (ratifikuar me ligjin Nr.9500, datë 03.04.2006);
- Marrëveshja për stabilizim dhe asociim midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre (ratifikuar me ligjin Nr.9590, datë 27.07.2006).

Kjo e fundit është një marrëveshje e rëndësishme në kuadër të procesit të stabilizimit dhe asociimit të shteteve të Europës Lindore për një Europë të stabilizuar. Përmes kësaj marrëveshjeje, synohej forcimi i bashkëpunimit të palëve në disa fusha, veçanërisht në drejtësi. Një nga objektivat e Shqipërisë përmes kësaj marrëveshjeje është zhvillimi i projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, migracionit dhe trafikimit të paligjshëm. Ky objektiv është një faktor kyç në bashkëpunimin midis palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Në përputhje me këtë objektiv, Shqipëria duhet të promovojë aktivisht bashkëpunimin me shtetet e BE-së dhe me shtetet e tjera që janë kandidatë për anëtare në BE. Për të përmbushur këtë objektiv, Shqipëria duhet të ratifikojë një seri marrëveshjesh dy apo shumëpalëshë mbi bashkëpunimin në luftë kundër krimit, veçanërisht format e organizuara të tij, të cilat ndikojnë në çështjet që kanë të bëjnë me ekstradimin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare për procedimin dhe gjykimin e çështjeve penale.

2.8. Analizë e zhvillimeve të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri në raport me vendet e ndryshme të botës

Në analizën e fakteve historike të parashtruara në dy çështjet e mëparshme, vihet re, se:

- ✓ Ndërkohë që në botë e drejta e shteteve ishte zhvilluar prej shekujsh, historia e fillimeve të një të drejte të mirëfilltë dhe degëve të veçanta të saj në Shqipëri lidhet me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar në vitin 1912.

- ✓ Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal përbëjnë një institut të së drejtës që ka lindur dhe është zhvilluar shumë më vonë se shteti dhe e drejta në përgjithësi.
- ✓ Forma e parë e bashkëpunimit midis shteteve në fushën penale ka qenë ekstradimi, institut ky nëpërmjet të cilit shtetet lidhnin marrëveshje për dorëzimin e autorëve të veprave penale të kapur në territorin e një shteti tjetër. Ky institut i ka fillesat e tij në traktatin midis Ramsesit dhe Hetushilit në vitin 1278 para erës së re. Deri në shekullin XIX bashkëpunimi në fushën penale vazhdoi kryesisht të mbetej në kornizat e institutit të ekstradimit, që realizohej nëpërmjet marrëveshjeve përgjithësisht dypalëshe midis shteteve. Si pasojë e zhvillimeve të vrullshme sociale, ekonomike, politike dhe teknologjike, në këtë periudhë, marrëdhëniet juridiksionale midis shteteve në procesin penal u zgjeruan edhe me forma të tjera të bashkëpunimit, siç ishte ndihma e ndërsjellë në fushën penale, e cila krijoi fizionominë e plotë të saj në shekullin XX. Gjithashtu, në marrëveshjet në këtë fushë u përfshinë më shumë se dy palë.
- ✓ Për sa i përket Shqipërisë, pavarësisht ekzistencës së marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri në fillim të shekullit XX, ato morën një zhvillim real vetëm pas kalimit nga sistemi totalitar komunist në sistemin demokratik në vitin 1990. Ky ndryshim u shoqërua me vështirësi të shumta, që kërkonte reforma rrënjësore të së drejtës në Shqipëri. Në vitet e para u bënë përpjekje për ndryshimet e legjislacionit dhe përafrimet e tij me atë të sistemeve demokratike. Kështu që vetëm në fund të viteve '90 u bë i mundur ratifikimi i Konventave dhe

nënshkrimi i marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Nisur nga kjo analizë, nëse në vendet e tjera të botës marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja janë konsoliduar tashmë prej shekujsh, në Shqipëri nuk mund të thuhet që ato janë konsoliduar në këtë periudhë pothuaj 20 vjeçare, ku marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal kanë fillimet e tyre reale. Vlen të theksohet këtu fakti, që pavarësisht arritjeve pozitive, Shqipëria nuk ka marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike me shumë vende të botës, gjë që është pengesë për shtrirjen e tyre gjerësisht. Marrja e statusit të vendit kandidat për në BE sigurisht do të pasohet me zhvillime të reja në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, duke ndikuar pozitivisht për integrimin sa më të plotë të Shqipërisë dhe synimin e saj për t'u bërë pjesë e BE-së.

KAPITULLI III: TRAJTIMI JURIDIK I MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË PROCESIN PENAL DHE LETËRPOROSIVE NDËRKOMBËTARE SI PJESË E TYRE

3.1. Koncepti juridik i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre, trajtimi i tyre në doktrinën apo literaturën bashkëkohore dhe diskutim kritik i tyre

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal studiohen si pjesë e së drejtës penale, ndërthurur me të drejtën ndërkombëtare penale. Nisur nga ky fakt, për trajtimin juridik të marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal, është e udhës referenca me teoritë e së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, të cilat e përkufizojnë ekzistencën e së drejtës ndërkombëtare si “thjesht një nga pasojat e paevitueshme të bashkekzistencës midis shteteve”. (Encyclopedia of Public International Law⁷, 1995:1159)

Pavarësisht përkufizimeve të ndryshme nga autorë të së drejtës, mund të pranohet që “marrëdhëniet ndërkombëtare, midis të tjerash, përbëjnë marrëdhënie midis shteteve të ndryshme. Këto marrëdhënie studiohen nga e drejta ndërkombëtare” (Uka, 2011:437).

Aktet ndërkombëtare janë të detyrueshme për shtetet anëtare, edhe nëse legjislacioni i brendshëm parashikon ndryshe. Në rast se një akt ndërkombëtar është ratifikuar nga një

⁷ **Përkthimi në shqip:** Enciklopedia e së Drejtës Ndërkombëtare Publike

shtet, legjislacioni i brendshëm duhet të ndryshohet në përputhje me aktin ndërkombëtar, me qëllim përafrimin e tij.

Perspektiva të ndryshme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare diktojnë përafrimet individuale të pranuar nga juridiksionet e brendshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit. Nuk ka një pikëpamje të vetme për qëllimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale dhe ka mendime të ndryshme rreth mjeteve më të përshtatshme për të përcaktuar një kornizë legjislative ndërkombëtare për ndihmën e ndërsjellë. (Harfield, 2003:221)

Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare është mjaft i studiuar dhe i debatuar raporti ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme, si dhe vendin që zënë normat e së drejtës ndërkombëtare në kuadrin e hierarkisë së normave të legjislacionit të brendshëm. Në këtë drejtim njihen dy lloj teorish: ajo dualiste ose pluraliste dhe ato moniste. Sipas teorisë dualiste/pluraliste, rendi juridik i brendshëm dhe ai ndërkombëtar kanë hapësira veprimi dhe fusha rregullimi të ndryshme dhe dallimi midis tyre është thelbësor.

Nga kjo pikëpamje, asnjëri prej këtyre dy sistemeve normative nuk ka fuqi të krijojë apo të ndryshojë normat e tjetrit. Kur e drejta e brendshme e një shteti parashikon që brenda juridiksionit të saj të zbatohet tërësisht ose pjesërisht e drejta ndërkombëtare, ky është thjesht një ushtrim i autoritetit të së drejtës së brendshme, që shfaqet në përshtatjen apo transformimin e normave të së drejtës ndërkombëtare. Në rastin kur normat e së drejtës së brendshme parashikojnë një zgjidhje që nuk përkon me atë që parashikohet nga e drejta ndërkombëtare, sipas autorëve të teorisë dualiste, konflikti, do të zgjidhet përgjithësisht duke iu referuar normave të së drejtës së brendshme. (Krisafi, 2014 b:35)

Sipas teorisë moniste, rendi juridik i brendshëm dhe ai ndërkombëtar kanë unitet. Brenda kësaj teorie njihen dy sisteme të ndryshme: ai ndërkombëtarist dhe ai kushtetues ose kombëtarist. “Sistemi ndërkombëtarist njeh përparësinë e të drejtës ndërkombëtare mbi të

drejtën e brendshme, ndërsa ai kombëtarist njih përparësinë e të drejtës së brendshme ndaj të drejtës ndërkombëtare” (Krisafi , 2014 b: 35).

Për sa i përket Shqipërisë, ajo ka pranuar zgjidhjen ndërkombëtariste të sistemit monist që lidhet me epërsinë e së drejtës ndërkombëtare ndaj të drejtës së brendshme. Kjo zgjidhje gjen shprehje në parimet kushtetuese të RSh-së , midis të tjerash edhe në nenin 122 të Kushtetutës së RSh-së (Ligj Nr. 28, 1998:1073), ku parashikohet, se: *çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose ratifikohet me ligj.*

Një debat juridik në literaturën juridike botërore në lidhje me të drejtën ndërkombëtare është ai i mungesës së karakterit jo detyrues të normave të së drejtës ndërkombëtare, për të cilin paraqiten dy pikëpamje të ndryshme:

- a) Pikëpamja e parë ka të bëjë me atë që sistemi juridik i një shteti përbëhet nga norma juridike që janë kthyer si të tilla me miratimin nga pushteti i këtij shteti, të cilat kanë në vetvete edhe karakterin shtrëngues, duke parashikuar sanksione për moszbatimin e tyre. Sipas kësaj pikëpamjeje, e drejta ndërkombëtare ka një karakter të decentralizuar për aq kohë sa bazohet në bashkëpunimin midis shteteve sovrane dhe ajo mbetet e pazbatueshme për aq kohë sa zbatimi i saj mbështetet në vullnetin e vetë shteteve.
- b) “Pikëpamja e dytë e quan sistemin e të drejtës ndërkombëtare një sistem unik dhe si i tillë është e tepërt apo e panevojshme të krahasohet me sistemin e së drejtës së brendshme” (Zaganjori, 2012:13). Zbatimi i normave ndërkombëtare është i

detyrueshëm, përderisa pothuajse të gjithë kushtetutat moderne ato njihen dhe trajtohen si pjesë e së drejtës së brendshme të tyre.

Fakti që e drejta ndërkombëtare rregullon marrëdhëniet mes shteteve, duke shtrirë kështu efektet e saj kryesisht në planin horizontal, nuk do të thotë se zbatimi i saj nuk mund të kërkohej në planin kombëtar, pra edhe në planin vertikal. Përkundrazi, njohja dhe zbatimi i së drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme është sot një realitet i pakundërshtueshëm dhe një kusht i domosdoshëm për garantimin e një rendi ndërkombëtar sa më të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, ajo i shërben natyrshëm edhe rritjes së bashkëpunimit dhe integritetit rajonal e më gjerë. (Zaganjori, 2012:9-10)

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare përfshihen marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, të cilat përkufizohen si:

...marrëdhënie që krijohen ndërmjet shteteve mbi bazën e akteve ndërkombëtare shumëpalëshe ose dypalëshe të cilat kanë për qëllim ndihmën dhe asistencën e ndërsjellë ndërmjet tyre për të luftuar kriminalitetin, për të vënë përpara përgjegjësisë personat fajtorë dhe parandalimin e krimit. (Islami et al, 2012:695)

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal ushtrohen në përputhje me kërkesat, procedurat dhe nga institucionet e përcaktuara me ligj. Ato janë një mundësi e mirë e ndërveprimit midis shteteve të ndryshme në fushën penale, me qëllim final luftën sa më efektive kundër krimit, dhënien e drejtësisë dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale, gjë që përbën edhe një detyrë të legjislacionit penal shqiptar, sipas nenit 1/b të Kodit Penal dhe nenit 1 të Kodit të Procedurës Penale. Në to bëjnë pjesë: ekstradimi, letërporositë ndërkombëtare dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaja.

Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e KE-së “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe të protokollit të saj shtesë me ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999 (i ndryshuar)

(Fletore zyrtare nr. 21, 1999:697), në të cilin pala shqiptare ka shprehur disa rezerva dhe deklarime lidhur me këtë konventë. Autorët e librit “Procedura penale” (Islami et al, 2012:762-763) kanë hapur një debat juridik në lidhje me deklarimin e fundit, sipas të cilit është deklaruar, se autoriteti gjyqësor në kuptim të nenit 24 të Konventës është Ministria e Drejtësisë (MD). Sipas autorëve ky deklarim nuk është i saktë, për arsye se autoriteti gjyqësor dhe MD janë dy gjëra të ndryshme dhe nuk nënkuptojnë njera – tjetrën. Sipas autorëve “autoritet gjyqësor” në kuptim të nenit 24 të konventës, janë organet e procedimit penal, të njohura nga Kodi i Procedurës Penale, të cilat kanë nevojë për ndihmë juridike në çdo fazë të procedimit penal, siç rezulton edhe nga neni 509 i KPP-së. Autorët kanë arsyetuar drejt, duke analizuar edhe dispozitat e tjera të vetë Konventës, deklaratimet e tjera sipas ligjit nr.8498 datë 10.06.1999 (i ndryshuar) si dhe dispozitat përkatëse të KPP-së. Në këtë arsyetim autorët i janë referuar edhe ligjit nr.10193 datë 13.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), i miratuar në datë 03.12.2009, ndërkohë që arsyetimi e ka humbur aktualitetin e tij që në datë 22.05.2006 me miratimin e ligjit 9539 (Fletore zyrtare nr. 57, 2006:1627) “Për disa ndryshime në ligjin nr.8498, datë 10.06.1999 /Për ratifikimin e ‘Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale’ dhe të protokollit shtesë/ (i ndryshuar), ku midis të tjerash është ndryshuar edhe deklarimi i fundit në lidhje me autoritetin gjyqësor, duke parashikuar konkretisht, se: *Autoritetet gjyqësore, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, janë: Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat*

e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

Ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet penale është një mekanizëm i bashkëpunimit, i cili lejon një ndihmë të një natyre të gjerë midis shteteve për mbledhjen e provave, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe eficientë. Siç parashikohet përgjithësisht në traktatet apo marrëveshjet dypalëshe, ose në konventat shumëpalëshe, ndihma e ndërsjellë përbën një mjet të përdorur nga një shtet për të marrë prova nga një shtet tjetër për përdorimin e tyre në një hetim apo procedim penal. (Prost, 2012:15)

Ndihma e ndërsjellë juridike ka rëndësi të madhe për arsye se përcakton bazën ligjore në të cilën shtetet palë mund të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar. Pa bazën ligjore përkatëse shtetet nuk mund të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar dhe as të shkëmbejnë informacion midis tyre.

Së pari, çfarë duhet të kuptojmë me ndihmë të ndërsjellë juridike. Për ta bërë sa më të thjeshtë, ajo përbën kërkesën që një shtet i bën një shteti tjetër për të marrë informacion, prova, masa ose ekstradim në lidhje me procedimet e tij penale. (Bolt, 1993:1911)

Në shumë shtete metodat për të ushtruar këtë lloj ndihme janë komisionet hetimore ose letërkërkesat, të quajtura ndryshe letërporosi. Procedura e një ndihme të ndërsjellë fillon me kërkesën për ndihmë juridike që quhet letërkërkesë (Rogatory Letter). Ajo transmetohet nga shteti kërkues në shtetin në të cilin kërkohet ndihma. Letërkërkesa duhet të përmbajë disa komponentë, si: bazën ligjore, gjuhën, identifikimin e autoriteteve përgjegjës, përmbledhje të fakteve kryesore, përshkrimin e veprimit të kundërligjshëm dhe dënimin për të, kur është e arsyeshme kërkesën për pjesëmarrjen e zyrtarëve të shtetit kërkues gjatë kryerjes së veprimit në ekzekutim të letërkërkesës, etj. Kjo letërkërkesë mund të ekzekutohet nga ekzekutuesi i saj brenda kufijve ligjorë të legjislacionit të tij kombëtar.

Autoritetet kompetente gjyqësore të letërkërkesës përcaktohen nga marrëveshjet dy apo shumëpalëshe. Ato zakonisht mund të jenë autoritete qëndrore, si Ministri i Drejtësisë apo Prokurori i Përgjithshëm. Letërkërkesa më rrallë mund të kalojë në rrugë diplomatike. Në raste urgjente ajo kalon në procedura më të tjeshta, nëpërmjet INTERPOL-it.

“Letërporosia mund të përkufizohet si një mandat i dhënë nga autoritetet gjyqësore të një vendi, autoritetit gjyqësor të vendit tjetër (të huaj), për të kryer ose për të ekzekutuar nga ky i fundit një ose më shumë veprime të caktuara në kërkesë” (Islami et al, 2012:766).

Nisur nga këto përcaktime, letërporositë ndërkombëtare mund të përkufizohen si forma të ndihmës së ndërsjellë juridike midis shteteve, nëpërmjet të cilave shtetet kërkuese autorizojnë shtetet pritëse të letërporosive që të kryejnë veprime procedurale, në lidhje me marrjen e provave për efekte të procedimeve penale të shteteve kërkuese, kryerjen e komunikimit të akteve të ndryshme, si dhe njoftimin e të pandehurve, dëshmitarëve dhe ekspertëve për t’u paraqitur në procedimet penale të shteteve kërkuese.

3.2. Parimet e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporosive ndërkombëtare si pjesë e tyre

Letërporositë ndërkombëtare nuk paraqesin parime të veçanta, por ndjekin parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, ndër të cilat mund të përmenden sa më poshtë vijon:

Parimi i universalitetit – E drejta ndërkombëtare gjen zbatim kryesisht në planin ndërkombëtar, duke paraqitur si subjekte shtetet sovrane dhe organizmat ndërkombëtare.

“E drejta ndërkombëtare klasike përcaktohet si një rend juridik i veçantë, i cili përfshin në vetvete të gjithë shtetet sovrane. Prandaj me të drejtë theksohet, se një nga karakteristikat kryesore të sistemit të së drejtës ndërkombëtare sot është universaliteti i saj” (Zaganjori, 2012:9). Në këtë kuptim, edhe marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporositë ndërkombëtare si pjesë e tyre kanë karakter universal, duke pasur parasysh që ato ushtrohen nëpërmjet marrëveshjeve, ku subjekte janë shtetet sovrane.

Parimi i sovranitetit – Çdo shtet i pavarur ka legjislacionin e tij, i cili vepron brenda kufijve dhe territorit të shtetit që është shprehje e sovranitetit të tij. Procedimi dhe ndëshkimi i krimeve të përhapura në më shumë se një shtet has si pengesë kryesore ndryshimin e legjislacioneve të tyre, posaçërisht ato të fushës penale. Bashkëpunimi ndërkombëtar midis dy shteteve ndihmon që të kapërcehet pengesa që rrjedh nga sovraniteti i shteteve.

Ndihma e ndërsjellë dhe ekstradimi janë mënyra të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, të cilat mund të përdoren për të kaluar pengesat e sovranitetit dhe të lejojnë komunitetin ndërkombëtar që të “luftojë”. Ekstradimi dhe ndihma e ndërsjellë ndihmojnë në ngritjen e urave për të kapërcyer ndryshimet në sistemet e tyre ligjore dhe asistojnë njëri – tjetrin në çështjet e pushtetit ligjor. (Prost, 2012:3)

Nga ana tjetër, në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja dhe letërporositë ndërkombëtare si pjesë e tyre respektohet sovraniteti i shtetit, neni 2/2 i Konventës së KE për ndihmën e ndërsjellë juridike në procesin penal (Fletore zyrtare nr. 21, 1999:697), ku parashikohet, se ndihma juridike mund të refuzohet në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë paragjykim të sovranitetit, të

sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit të saj. Ky parim gjen shprehje në Konventën e KE-së për ndihmën e ndërsjellë juridike në procesin penal edhe në këto aspekte:

- Letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në përgjithësi ushtrohen vetëm për ato çështje penale, që lidhen me fakte që parashikohen si të dënueshme nga legjislacionet e të dy shteteve pjesëmarrëse;
- Pala ekzekutuese e letërporosisë ekzekuton letërporositë që lidhen me një procedim penal të palës kërkuese, i cili kryhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të ekzekutuesit të letërporosisë (neni 3).
- Ekzekutimi i një letërporosie nuk bëhet në rast se në të përfshihen kërkesa të ndaluara nga legjislacioni i brendshëm i shtetit ekzekutues të letërporosisë.

Parimi i barazisë juridike – Konferenca e Helsinkit (Gusht 1975) “Mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Europë” (KSBE) (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 1994:149 – 194), në aktin final të saj ripohoi qëllimin e shteteve pjesëmarrës për përmirësimin e marrëdhënieve të tyre të ndërsjellta, duke respektuar sovranitetin dhe barazinë e shteteve, midis të tjerash barazinë juridike. Në këtë akt u konfirmua, se në kuadër të së drejtës ndërkombëtare të gjithë shtetet pjesëmarrëse kanë të drejta e detyra të barabarta; secili prej tyre ka të drejtën për të përcaktuar e për të zhvilluar sipas dëshirës së vet marrëdhëniet me shtetet e tjera, duke pasur të drejtë midis të tjerash të mos bëjnë pjesë në traktate të dyanshme apo të shumanshme; ata do të përpiqen të çojnë më tej midis të tjerave mirëkuptimin e besimin e

ndërsjellë dhe drejtësinë, duke zhvilluar bashkëpunimin e vet në bazë të barazisë. Edhe në marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal palët pjesëmarrëse kanë të drejta dhe detyra të barabarta, të cilat përcaktohen në marrëveshjet e lidhura midis tyre.

Parimi i reciprocitetit – Parimi i sovranitetit dhe barazisë juridike është i lidhur ngushtë edhe me parimin e reciprocitetit të letërporosive ndërkombëtare që parashikohet në dispozitat e Konventës së KE-së “*Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale*” e datës 20 prill 1957, në të cilën Shqipëria është bërë palë në vitin 1999. Parimi i reciprocitetit është parashikuar si kusht i domosdoshëm për ekzekutimin e letërporosive ndërkombëtare në dispozitat përkatëse të së drejtës së brendshme shqiptare, konkretisht Kodi i Procedurës Penale (neni 505/4) dhe nenit 9 të ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 (i ndryshuar) (Fletore zyrtare nr. 181, 2009:8080).

Parimi i ekzistencës së vullnetit të mirë – KSBE konfirmoi gjithashtu, se “shtetet pjesëmarrëse duhet të plotësojnë me vullnet të mirë (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 1994:158) detyrimet që u bien në bazë të së drejtës ndërkombëtare, si detyrimet që rrjedhin nga parimet e rregullat e së drejtës ndërkombëtare të njohura nga të gjithë, ashtu edhe detyrimet që dalin prej traktateve apo marrëveshjeve të tjera, në të cilat ato janë palë. Në këtë kontekst, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal mund të ushtrohen vetëm me ekzistencën e vullnetit të mirë të palëve. Kjo duke pasur parasysh mungesën e sanksioneve për moszbatim të marrëveshjeve midis shteteve për bashkëpunim në procesin penal.

Shkëmbimi ndërkombëtar i provave në çështjet penale përmes mdihmës së ndërsjellë ligjore formale është një fenomen i kohëve të fundit. Duke realizuar pjesëmarrjen në këto akte formale mund të lejojë autoritetet proceduese të kenë akses të zgjeruar për provat e ndodhura jashtë shtetit. Shtetet kanë shprehur gjithnjë e më tepër vullnetin në tyre për të hartuar traktate të ndihmës së ndërsjellë juridike. (Bantekash et al, 2003:231)

Megjithatë, për aq kohë sa ka ekzistuar vullneti i shteteve për të hartuar një marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim midis tyre në procesin penal, rrjedhimisht pa diskutim që duhet të ekzistojë edhe vullneti i tyre për zbatimin e kësaj marrëveshjeve. Gjithashtu, këtu duhet pasur parasysh që marrëveshjet në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal bëhen në interes të të gjithë palëve pjesëmarrëse, me qëllim efikasitetin e luftës kundër krimit. Në këtë kuptim, nuk ka arsye që shtetet pjesëmarrëse të mos kenë vullnet të mirë për realizimin e këtyre lloj marrëdhëniesh.

Parimi i konfidencialitetit – Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal ushtrohen duke u mbështetur në parimin e konfidencialitetit, që ka për qëllim ruajtjen e sekretit shtetëror dhe mbrojtjen e të dhënave personale të individit, në lidhje me sa është parashtruar në letërkërkesat ndërkombëtare. Në Shqipëri ky parim gjen shprehje në parashikimet e nenit 12 të ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 (i ndryshuar).

Parimi i bazueshmërisë në ligj të provave të marra nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare – Letërporositë ndërkombëtare përbëjnë mjete për marrjen e provave për efekte të një procesi penal në një shtet të huaj dhe me kërkesë të autoritetit të huaj përkatës. Që këto prova të jenë të vlefshme dhe të përdorshme nga kërkuesi i letërporosisë, është e

rëndësishme që marrja e tyre nga ekzekutuesi i letërporosisë të bëhet në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara për marrjen e provës përkatëse.

Marrja e provave në përputhje me ligjin nuk është një kusht abstrakt apo formal. Përkundrazi, ne mendojmë, se ajo është e një rëndësie themelore për drejtësinë e një procesi gjyqësor penal. Asnjë gjykatë nuk mund, pa dhunuar administrimin e drejtësisë, të bazohet në prova të cilat jo vetëm janë marrë me mjete të pandershme, por mbi të gjitha, në mënyrë të paligjshme. Në qoftë se ndodh kështu, gjykimi nuk mund të jetë i drejtë. (GJEDNJ, 2001:659)

3.3. Drejtimit e zhvillimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal zhvillohen në dy drejtime:

- a. procedim (hetim dhe gjykim) i veprave penale;
 - b. zbatim i vendimeve penale kudo në botë.
- a. Procedimi i veprave penale – Si pasojë e zgjerimit të lëvizjes së lirë të shtetasve nga njëri shtet në tjetrin, në jetën e përditshme ndodh shpesh, që një shtetas të kryejë një vepër penale në territorin e një shteti të huaj. Sipas legjislacioneve penale në mbarë botën, shtetasit e huaj përgjigjen penalisht për veprat penale të kryera prej tyre. Neni 7 i KP të RSh-së parashikon, se shtetasi i huaj, që kryen vepër penale në territorin e RSh-së , përgjigjet në bazë të ligjit penal të RSh-së Në të njëjtën kohë, në bazë të nenit 6 të KP-së ligji penal i RSh-së është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që ka kryer një vepër penale jashtë territorit të RSh-së .

Nga ana tjetër, kryerja e një vepre penale mund të paraqitet në forma më komplekse dhe më të organizuara bashkëpunimi, që shtrihet në disa shtete dhe që sjell si domosdoshmëri kryerjen e veprimeve hetimore njëkohësisht nga shtete të ndryshme.

Në këtë kuptim, lufta efikase kundër krimit, sidomos format e organizuara të tij mund të realizohet vetëm nëpërmjet marrëdhënieve juridiksionale midis shteteve të ndryshme në procesin penal.

Gjatë procedimit të veprave penale, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja bazohen në legjislacionin e brendshëm dhe aktet ndërkombëtare, siç janë: traktatet, marrëveshjet, etj. Në këtë proces, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja ushtrohen nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare, si ato nga jashtë shtetit, ashtu edhe ato për jashtë shtetit. Kushtet, procedura dhe autoritetet përgjegjse për kryerjen e tyre në Shqipëri prashikohen në nenet 505 – 511 të KPP-së (Fletore zyrtare nr. 5, 1995:159). Këto dispozita janë referuese, për rrjedhojë ato plotësohen me akte të tjera ligjore kombëtare (ligjet e veçanta) dhe akte ndërkombëtare të ratifikuara nga RSh.

b. Zbatimi i vendimeve penale – Procedimi dhe dënimi penal i shtetasve të huaj shpesh herë bëhet në mungesë të tyre, duke bërë të pamundur ekzekutimin e dënimeve penale nga shtetet që kanë kryer procedimin. Në këtë mënyrë, është e logjikshme që barra e ekzekutimit të vendimeve penale t'i kalojë shtetit të vendbanimit të të dënuarit. Por ç'ndodh me këto vendime gjyqësore të dënimit të një shtetasi të huaj, kur ato nuk janë ekzekutuar? Çfarë fuqie kanë këto vendime në shtetin amë të të dënuarit nga një shtet i

huaj? Si ekzekutohen ato nga shtetet amë, në rastet kur nuk janë ekzekutuar nga vetë shteti procedues, që ka dhënë vendimin e dënimit? Të gjitha këtyre pyetjeve dhe të tjera, që lidhen me to i japin përgjigje institute të tilla të së drejtës, si: “Ekzektim i vendimit penal të huaj”, “Njohje e vendimit penal të huaj” dhe “Ekstradimi”.

Kushtet, procedura dhe autoritetet përgjegjëse për kryerjen së ekzekutimit të vendimeve penale të huaja dhe ekstradimit në Shqipëri prashikohen përkatësisht në nenet 512 – 523 dhe 488 – 504 të KPP-së, të cilët plotësohen me akte të tjera ligjore kombëtare (ligjet e veçanta) dhe ndërkombëtare (traktate, marrëveshje, konventa) të ratifikuara nga RSh.

Në përmbledhje të sa më sipër, llojet e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë: ekstradimi, letërporositë ndërkombëtare dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaj.

Një pjesë e traktateve ndërkombëtare që adresojnë krimet ndërkombëtare, detyrojnë shtetet anëtare të hetojnë dhe procedojnë veprën penale përkatëse, ose të ekstradojnë të dyshuarit në një shtet tjetër palë. (Cryer et al, 2010:69)

Konventa e KE “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” e datës 20 prill 1957 në fakt shkon tej këtyre llojeve, duke parashikuar si forma të ndihmës së ndërsjellë juridike edhe denoncimet me qëllim procedimin penal (neni 21) dhe shkëmbimin e informacionit lidhur me dënimet (neni 22). Një lloj tjetër bashkëpunimi është edhe transferimi i çështjeve penale sipas Konventës së KE-së të 15 Majit 1972, e cila është ratifikuar me ligjin nr.8497 datë 10.06.1999 (Fletore zyrtare nr. 21, 1999:26). Kjo Konventë është miratuar me qëllimin për të arritur një unitet më të madh midis anëtarëve të KE-së, duke dëshiruar

plotësimin e punës së bërë në fushën e të drejtes penale, me synimin e arritjes së sanksioneve më të drejta dhe më frytdhënëse. Kjo Konventë është vlerësuar e dobishme për shmangien e disavantazheve që rezultojnë nga konfliktet e kompetencave, nën frymën e një mirëbesimi reciprok të organizimit të procedimeve penale në nivel ndërkombëtar.

Koncepti juridik i ekstradimit jepet në Konventën Europiane mbi ekstradimin (Fletore zyrtare nr. 10, 1998:353) e Parisit, miratuar në 13 dhjetor 1957, në nenin 1 të së cilës palët kontraktuese zotohen t'i dorëzojnë njëra-tjetrës, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara po nga kjo konventë, ata individë që ndiqen për shkelje të ligjit ose kërkohen nga organet gjyqësore të Palës kërkuese për të vuajtur një dënim ose një masë sigurimi. Këtë përkufizim pak a shumë jep edhe KPP i RSh-së në nenin 488 të tij, i cili e përcakton kuptimin e ekstradimit, si *dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale*. Po kështu, ligji nr.10193 datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), në nenin 31 të tij e përcakton ekstradimin si *dorëzimin e një personi nën hetim, të pandehur apo të dënuar, në drejtim të një shteti të huaj, që kryhet sipas këtij ligji, rregullave të legjislacionit shqiptar dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë*. Nisur nga sa kanë përcaktuar këto akte, mund të thuhet, se:

Me ekstradim kuptojmë dorëzimin e ndërsjellë, sipas kushteve dhe rregullave të caktuara, të personave që ndiqen penalisht për një vepër penale, ose kërkohen me qëllim ekzekutimi të një

vendimi dënimi ose mase sigurimi nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese. (Islami et al, 2012:707)

Letërporositë ndërkombëtare, si një nga format e ndihmës së ndërsjellë juridike rregullohen nga Konventa e KE-së “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” e datës 20 prill 1957, e cila është ratifikuar nga Shqipëria së bashku me dy protokollet shtesë të saj.

Kjo formë përfaqëson ndihmën që një shtet i jep shtetit shqiptar dhe anasjelltas, në çështjet për të cilat ka filluar procedimi në shtetin kërkuës dhe që ndjekja penale dhe dënimi janë nën juridiksionin e atij shteti. (Islami et al, 2012:761)

Në këtë Konventë nuk jepet një përkufizim për letërporositë ndërkombëtare, por në nenin 1 të saj ndihma e ndërsjellë juridike përbën një “bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese”.

Përcaktimet në lidhje me letërporositë ndërkombëtare jepen në nenet në vijim të Konventës, nga të cilët rezulton, se:

Letërporositë ndërkombëtare kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore dhe kalimin e provave materiale, të fashikujve dhe dokumenteve, kryerjen e komunikimeve dhe njoftimeve, dërgimin e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të të pandehurve para autoritetit gjyqësor të huaj, etj. (Islami et al, 2012:765)

Nisur nga këto përcaktime, letërporositë mund të përkufizohen si akte formale zyrtare, nëpërmjet të cilëve shtetet plotësojnë nevojat të ndryshme për ndihmë të ndërsjellë juridike midis tyre. Nëpërmjet tyre shtetet kërkuese autorizojnë shtetet pritëse të letërporosive që të kryejnë veprime procedurale, në lidhje me marrjen e provave për efekte të procedimeve penale të shteteve kërkuese, kryerjen e komunikimit të akteve të ndryshme, si dhe njoftimin e të pandehurve, dëshmitarëve dhe ekspertëve për t’u paraqitur në procedimet

penale të shteteve kërkuese. Në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin e saj nr.23 datë 23.07.2009, konkretisht:

Ndihma e ndërsjellë juridike në fushën penale është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit me autoritetet e huaja. Ndihma që jepet me letërporosi konsiston në a) marrjen e provave, e cila konsiston në dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurit, si dhe në marrjen e provave shkresore apo dokumenteve që lidhen me një çështje penale në shtetin e huaj; b) dorëzimin e akteve, të cilat mund të jenë akte hetimore, prova materiale, dokumente, fashikuj, procesverbale apo vendime gjyqësore; c) njoftimet dhe komunikimet me letërporosi, që mund të jenë komunikim i një vendimi gjyqësor penal, njoftimi për t'u paraqitur si dëshmitar etj; si dhe d) dërgimi i personave autoriteteve të shtetit të huaj si dëshmitarët, ekspertët apo personat e pandehur.

3.4. Marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe baza ligjore e tyre

Kushtetuta e RSh-së, e cila përbën aktin themelor të shtetit shqiptar përmban mjaft parime në lidhje me të drejtën ndërkombëtare, duke parashikuar, se:

- E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (neni 4/1);
- Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të (neni 5);
- Aktet normative, që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, etj. (neni 116).


Parimi themelor kushtetues i sipërpërmendur, në të njëjtën kohë gjen shprehje në pjesën e përgjithshme të KP-së, ku parashikohen parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet e drejta penale, konkretisht në nenin 1/a të KP-së (Fletore zyrtare nr. 4, 1995:100) që parashikon bazat e legjislacionit penal, dispozita e të cilit përcakton:

Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Legjislacioni penal përbëhet nga ky kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale.

Në këtë këndvështrim, marrëdhëniet juridiksionale të shtetit shqiptar me autoritetet e huaja në procesin penal rregullohen nga një sërë dispozitash të legjislacionit penal shqiptar, si dhe akte ndërkombëtare penale (marrveshje, konventa, etj).

Duke u mbështetur në këtë parim kushtetues, në mënyrë grafike burimet e së drejtës penale mund të paraqiten si më poshtë:



3.4.1. Legjislacioni i brendshëm i aplikueshëm në fushën e marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal

Pjesë të legjislacionit të brendshëm të RSh-së, që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me shtetet e huaja në procesin penal janë:

- Kushtetuta e RSh-së;
- Kodi Penal (KP) i RSh-së;
- Kodi i Procedurës Penale (KPP) i RSh-së;
- Ligje të tjera.

Garantimi i drejtësisë penale në nivel ndërkombëtar nuk do të ishte i mundur pa një angazhim total të mekanizmave shtetërore në luftë kundër kriminalitetit. Ndëshkimi i veprave penale me elemente të huaja si dhe bashkëpunimi midis shteteve në zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre realizohet në rradhë të parë me anë të legjislacioneve të brendshme penale dhe procedurale penale. (Xhafo, 2012:25)

3.4.1.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Akti më i rëndësishëm dhe më autoritar që përmban parashikime që gjejnë pasqyrim në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila përbën ligjin më të lartë, gjë që është parashikuar në paragrafin e parë të nenit 4 të saj. Ky përcaktim bën që të gjithë normat juridiko – penale të bazohen në parimet kryesore kushtetuese, duke e bërë Kushtetutën burim bazë të së drejtës penale, ashtu si për të gjithë të drejtën shqiptare në tërësi.

Edhe pse jo një burim i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e ligjit themelor parashikon parimet themelore të cilave i nënshtrohet ekstradimi. (Hoxha, 2011:78)

Pas ndryshimit të sistemit në Shqipëri, parimet demokratike të shtetit të së drejtës fillimisht gjetën vend në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” (i ndryshuar) (Fletore zyrtare nr. 4, 1991:145), ndryshuar me ligjin nr.7561 dt.29.04.1992 (Fletore zyrtare nr. 2, 1992:81), të cilët shërbyen si bazë për Kushtetutën aktuale, e cila është miratuar në vitin 1998. Këto ligje i dhanë fund izolimit disa dekadash të Shqipërisë dhe i hapën rrugë marrëdhënieve juridiksionale të Shqipërisë me shtetet e huaja.

Në Kushtetutën e RSh-së ka një sërë normash, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtën ndërkombëtare dhe atë penale, midis të cilave edhe me marrëdhëniet juridiksionale me

autoritetet e huaja në procesin penal. Kështu sipas saj, RSh zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të (neni 5), ku bëjnë pjesë kryesisht konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga RSh, si dhe traktatet/marrëveshjet dy apo shumëpalëshe të nënshkruara prej saj.

Mënyra e zbatimit të normave të së drejtës ndërkombëtare, roli dhe vendi që i garantohen asaj në të drejtën e brendshme, në çdo rast konkret, varen kryesisht nga kushtetuta e çdo vendi (Zaganjori, 2012:11). Pavarësisht parimeve të pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit shqiptar, aktet ndërkombëtare si pjesë e së drejtës ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë edhe ato akte që rregullojnë institutin e marrëdhënieve juridiksionale në procesin penal, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Shqipëria, gjë që përcaktohet si parim në nenin 116 të saj, ku ndër të tjera, përcaktohet, se Aktet normative, që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSh-së janë: Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, etj. Lidhur me këtë parim të parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës së RSh-së është shprehur edhe GjK e RSh-së në vendimin e saj nr.6 viti 2006.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore përfshirë këtu edhe gjykatat e çdo niveli si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre. (Buna, 2012: 230)

Kushtetuta e RSh-së në nenin 117/3 të saj parashikon edhe mënyrën e shpalljes dhe botimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Më tej, neni 121/b parashikon, se ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga RSh bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të

bëjnë, ndër të tjera me të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve. Në të njëjtën kohë, në nenin 122 të saj parashikohet, ndër të tjera, se çdo marrëveshje ndërkombëtare pasi ratifikohet me ligj, përbën pjesë të sistemit të brendshëm dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Me fjalë të tjera, edhe në rast se ligji i brendshëm nuk është përshtatur me parashikimet e akteve ndërkombëtare të ratifikuar, ato mund të zbatohen drejtpërdrejt.

Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Kjo epërsi e normave të nxjerra prej një organizate ndërkombëtare mbi të drejtën e vendit, shprehet gjithashtu edhe në rast konflikti, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga RSh për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj. Me vendimin e saj nr.23 datë 23.07.2009, GjK e RSh-së ka arsyetuar:

Në bazë të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit juridik shqiptar dhe ato kanë epërsi mbi ligjet e brendshme në kundërshtim me to. Gjithashtu, këto dispozita ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë, me përjashtim të rastit kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe për zbatimin e tyre kërkohet nxjerrja e një ligji.

Të gjithë këto parime të përgjithshme të përcaktuara në Kushtetutën e RSh-së pavarësisht se jo në dukje, ndikojnë drejtpërdrejt dhe janë bazë në të gjitha fushat e së drejtës, pjesë e së cilës janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Ndërkohë, në Kushtetutën e RSh-së ka një parashikim të veçantë për ekstradimin, i cili është një nga format më të rëndësishme të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në nenin 39/2 të saj, ku specifikisht përcaktohet, ekstradimi mund

të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat RSh është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Ky parim krahas akteve ndërkombëtare, i jep një rëndësi të veçantë vendimeve gjyqësore për ekstradimin, duke gjetur shprehje edhe parimet e përgjithshme të së drejtës penale, si: barazia para ligjit e drejtësia në caktimin e fajësisë dhe të dënimit (neni 1/c i KP-së), mosdënimi pa ligj (neni 2 i KP-së), veprimi në kohë i ligjit penal (neni 3 i KP-së), prezumimi i pafajësisë (neni 4 i KPP-së), ndalimi i gjyqimit dy herë për të njëjtën vepër penale (neni 7 i KPP-së), etj.

3.4.1.2.Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ashtu si Kushtetuta e RSh-së, edhe KP i RSh-së në pjesën e përgjithshme të tij parashikon parimet bazë të së drejtës penale, që gjejnë pasqyrim edhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Ndryshimet demokratike që ndodhën në fillim të viteve '90 në Shqipëri dhe kalimi nga një sistem totalitar në një sistem demokratik, shënuan një kthesë rrënjësore në historinë e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij, që u shoqëruan edhe me reformimin e legjislacionit në tërësi. Kodi Penal aktual, i miratuar me ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995, është një akt me rëndësi të madhe politike dhe juridike për vetë kohën në të cilën u miratua, duke materializuar parimet demokratike të shoqërisë. Në pjesën e përgjithshme të tij parashikohen parimet e përgjithshme, mbi të cilat mbështetet e drejta penale shqiptare, disa prej të cilave gjejnë vend edhe për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Këto parime janë përmirësuar me ndryshimet e mëvonshme me ligjin

nr.9686, datë 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 /Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë/” të ndryshuar” dhe ligjin nr. 23 datë 01.03.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 /Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë/ të ndryshuar”.

Neni 1/a i KP-së përcakton, ndër të tjera, se ky kod bazohet në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Vlen të theksohet këtu, që dispozitat e pjesës së përgjithshme të KP parashikojnë rregullime edhe përsa i përket zbatimit të ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë në territore të huaja (neni 6/2); zbatimit të ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj (nenet 7 dhe 7/a), nga personi pa shtetësi (neni 8), personat e huaj që gëzojnë imunitet (neni 9/a).

Në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, KP parashikon institutet e njohjes së vendimeve penale të gjykatave të huaja (neni 10) dhe “Ekstradimi” (neni 11).

Me qëllim që të rritet shkalla e organizimit, koordinimi i masave të përbashkëta me vende të ndryshme dhe efikasiteti i mëtejshëm i luftës së përbashkët kundër organizatave kriminale e terroriste që veprojnë në shkallë rajonale ose ndërkombëtare, me qëllimin e krijimit të bazës ligjore të bashkëpunimit në drejtim të zbulimit, kapjes dhe vënies përpara përgjegjësisë penale të autorëve të krimeve që largohen nga vendet e tyre dhe fshihen në vende të tjera, u vendosën për herë të parë në Kodin Penal edhe dispozitat që rregullojnë fuqinë e vendimeve penale të gjykatave të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe institutin e ekstradimit. (Muçi, 2007:82)

KP i RSh-së përfshin parashikime në lidhje me institutin e njohjes së vendimeve penale të huaja. Kështu, dispozita e nenit 10 të KP-së përcakton, se vendimet penale të dhëna nga

gjykatat e huaja ndaj shtetasve shqiptarë që vërtetojnë kryerjen e një veprë penale, kur nuk është parashikuar ndryshe nga marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, vlejnë në Shqipëri brenda kufijve të ligjit shqiptar.

Nga analiza e kësaj dispozite, vërehet, se në mënyrë që vendimet penale të gjykatave të huaja të njihen nga Shqipëria duhet të plotësohen tre kushte:

- a) Ekzistenca e marrëveshjeve dy/shumëpalëshe me shtetet e tjerë për njohjen e vendimeve penale, që do të thotë që në këto marrëveshje duhet të jenë palë si Shqipëria ashtu edhe shteti që ka dhënë vendimin penal që do të njihet. Në këto marrëveshje respektohet parimi i reciprocitetit të palëve, si dhe përcaktohen kushtet që duhet të përmbushen dhe kufijve që duhet të zbatohen.
- b) Vendimet penale të gjykatave të huaja duhet të vërtetojnë kryerjen e një veprë penale. Ky kusht lidhet ngushtë me parimet: e prezumimit të pafajësisë (neni 4 i KPP-së); e ndalimit të gjykimin dy herë për të njëjtën vepër penale “*ne bis in idem*” (neni 7 i KPP-së); e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor; e mbrojtjes së lirisë personale dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve (neni 1 i KPP-së). “Këto parime në tërësi sigurojnë një ndër të drejtat themelore të njeriut për një proces të drejtë, siç është parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut dhe neneve 2 – 4 të protokollit të saj nr.7” (Gomien, 1998:31). Në të njëjtën kohë, ky kusht lidhet edhe me faktin që sipas legjislacionit penal shqiptar, mban përgjegjësi penale shtetasi shqiptar që ka

kryer një vepër penale jashtë territorit të RSh-së, me kusht që kjo vepër penale të jetë njëkohësisht e dënueshme nga legjislacionet e të dy shteteve (neni 6/2 i KP). Ky parim nuk lejon gjykatat shqiptare që në procesin e njohjes së vendimeve penale të huaja të shqyrtojnë çështjen penale në themel, të verifikojë vërtetësinë e provave të grumbulluara nga gjykatat e huaja apo t'i vlerësojnë ato. Në këtë proces gjykatat shqiptare verifikojnë kushtet e legjislacionit shqiptar, siç u përmendën më lart. Në përmbledhje të kësaj analize, vërehet, se vendimi i gjykatës shqiptare për njohjen e vendimit penal të huaj nuk është një vendim i ri për të dënuarin, por është thjesht një vlerësim dhe konvertim i tij mbi bazën e legjislacionit penal të brendshëm të Shqipërisë. Nisur nga problemet e lindura në praktikë në lidhje me njohjen e vendimeve penale të huaja dhe qëndrimet e mbajtura nga gjykatat shqiptare, Gjykata e Lartë e RSh-së është shprehur disa herë në vendimet e saj për to. Gjykata e Lartë e RSh-së në vendimin unifikues të kolegjeve të bashkuara të saj nr.154 datë 15.04.2000 (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2010:305), ndër të tjera ka përcaktuar, se: *“Për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, vendimi i gjykatës shqiptare për njohjen e vendimit penal të huaj nuk është një vendim i ri. Për këtë shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj”*.

- c) Vendimet penale të gjykatave të huaja duhet të jenë brenda kufijve të ligjit shqiptar. Ky kusht lidhet me zbatimin e parimit të territorialitetit (neni 6 i K.Penal), parimin

e humanizmit (neni 1/c i KP-së) dhe parimin e ligjshmërisë të së drejtës penale (nenet 2 dhe 3 të KP-së) që duhet të jenë të zbatueshëm edhe për vendimet penale të gjykatave të huaja. Më konkretisht, parimi i territorialitetit lidhet me faktin që shtetasit shqiptarë përgjigjen penalisht sipas legjislacionit penal të RSh-së për veprat penale të kryera brenda dhe jashtë territorit të RSh-së. Parimi i ligjshmërisë lidhet me faktet, se askush nuk mund të dënohet për një veprim që nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale në kohën e kryerjes së krimit, si dhe askush nuk mund të dënohet me një lloj apo masë dënimi të paparashikuar në ligj. Përsa i përket parimit të humanizmit, ky është i ndërthurur dhe me parimin e veprimit në kohë të ligjit penal, të cilët lidhen me fuqinë prapavepruese të ligjit të ri që nuk dënon veprën dhe aplikimin e dënimit sipas dispozitave më të favorshme. Sipas nenit 10 të KP-së, moszbatimi i të gjithë këtyre parimeve të përgjithshme në lidhje me kufijtë e ligjit shqiptar, parashikohet si rast përjashtimor, kur një gjë e tillë është parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë rast, vetë marrëveshja duhet të parashikojë specifikisht parimet, kushtet dhe procedurat e njohjes së vendimeve penale.

Këto tre kushte të marra në tërësi bëjnë që procesi i gjykatave shqiptare për njohjen e vendimeve penale të gjykatave të huaja duhet të kryhet në përputhje me parimet e përgjithshme të drejtësisë penale, siç u përmend më lart, dhe dispozitave përkatëse procedurale penale të shqyrtimeve gjyqësore, konkretisht: duke shqyrtuar provat e marra

dhe vërtetimin e kryerjes së veprës penale nga personi i dënuar, duke shqyrtuar faktin e dënueshmërisë së veprës nga legjislacioni shqiptar, duke shqyrtuar nëse vepra penale apo dënimi për të është parashkruar apo jo, duke u shprehur për fajësinë e autorit sipas legjislacionit penal shqiptar dhe duke caktuar dënimin sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin penal shqiptar. Gjykata e Lartë e RSh-së, në vendimin unifikues të kolegjeve të bashkuara të saj nr.154 datë 15.04.2000, është shprehur, se *“gjykata verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit penal të huaj dhe duhet t’i përgjigjet atij vendimi me një vendim që konverton dënimin me një dënim të parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse të cilat aplikohen”*.

Vlen për t’u përmendur këtu rasti kur një shtetas shqiptar është deklaruar fajtor dhe dënuar për disa vepra penale në të njëjtin vendim të huaj, i cili është objekt i njohjes nga gjykatat shqiptare. Në këtë rast, është e nevojshme që për të shmangur problemet e caktimit dhe llogaritjes së dënimeve apo problemet e mëvonshme që mund të lindin gjatë periudhës së ekzekutimit të dënimeve, të verifikohen kushtet për secilën vepër penale, duke u shprehur për fajësinë ose jo dhe duke caktuar llojin e masën përkatëse të dënimit për secilën prej veprave penale. Më pas caktohet një vendim i vetëm për të dënuarin sipas kritereve të përcaktuara në nenin 55 të K.Penal.

Pas njohjes së vendimeve penale të huaja nga gjykatat shqiptare, ato i nënshtrohen procesit të ekzekutimit të tyre. Edhe kjo fazë e fundit e dhënies së drejtësisë lidhet me kufijtë e ligjit

të brendshëm penal shqiptar. Ekzekutimi i vendimeve penale të njohur nga gjykatat shqiptare bëhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm penal shqiptar (nenet 462 – 480 të KPP-së), siç parashikohet edhe në nenin 518/1 të KPP-së. Është e rëndësishme të kuptohet ajo çka ka shprehur Gjykata e Lartë e RSh-së në vendimin unifikues të kolegjeve të bashkuara të saj nr.154 datë 15.04.2000, se *“është vendimi i huaj ai që vihet në ekzekutim dhe jo vendimi i gjykatës shqiptare që ka njohur këtë vendim. Pra, nuk kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës shqiptare që vihet në ekzekutim, por me një vendim të një gjykate të huaj që ekzekutohet në përputhje me legjislacionin shqiptar”*.

Përveç sa u parashtrua më lart, sipas përcaktimeve të nenit 10 të KP-së, vendimet penale të huaja të njohura nga gjykatat shqiptare kanë fuqi edhe për:

- a) Zbatimin e masave të sigurimit (neni 10/c i KPP-së) personal ndaj të dënuarit, qofshin ato shtrënguese apo kufizuese. Këto masa sigurimi, si rregull, duhet të vendosen pasi vendimi gjyqësor shqiptar i njohjes së vendimit gjyqësor penal të huaj të ketë marrë formë të prerë. Por, këto masa sigurimi mund të vendosen edhe para njohjes së vendimit gjyqësor penal të huaj, gjatë kohës së procedimit të autorit të veprës penale nga shteti i huaj, ose gjatë kryerjes së procedurave të njohjes së vendimit penal të huaj, në mbështetje të nenit 515 të KPP-së (*do të sqarohet më tej në punim*) apo marrëveshjeve ndërkombëtare specifike. Gjithsesi, caktimi i masave të sigurimit edhe në këto raste do të bëhet në përputhje me kriteret apo kushtet e

parashikuara në dispozitat përkatëse të KPP-së (nenet 227 – 269), duke pasur gjithnjë parasysh zbatimin e kufijve të ligjit të brendshëm penal shqiptar.

- b) Për zbatimin e vendimeve që përmbajnë dënime plotësuese (neni 10/b i KPP-së), të cilët mund të vendosen ndaj të dënuarit përveç dënimeve kryesore, në përputhje me llojin e veprës penale të kryer. Kuptohet që edhe dënimi plotësues i caktuar nga gjykata e huaj duhet të jetë në kufijtë e ligjit shqiptar (nenet 30, 35 – 43 të KP-së). Pra, që një dënim plotësues të caktohet nga gjykata shqiptare duhet që i njëjti lloj dënim plotësues të parashikohet nga legjislacioni penal shqiptar, si dhe afati i përcaktuar të jetë brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Duhet të mbahen parasysh këtu kriteret e përcaktuara nga neni 44 i KPP-së për mënyrën e vuajtjes së dënimeve plotësuese, të cilët pjesërisht i fillojnë efektet së bashku me vuajtjen e dënimit kryesor me burgim (konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të saj, heqja e dekoratave apo titujve të nderit, detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor, humbja e përgjegjësisë prindërore) dhe pjesërisht pas vuajtjes së dënimit me burgim (ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike, ndalimi për të drejtuar automjete, heqja e të drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie, heqja e të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative, nxjerrja jashtë territorit).

- c) Për shlyerjen e dëmit apo efekteve të tjera civile (neni 10/d i KPP-së) nga autori i veprës penale, që janë shkaktuar nga kryerja e saj. Kjo gjë zakonisht lidhet me rastet kur vendimet e huaja kanë zgjidhur edhe padinë civile në procesin penal, duke e detyruar shtetasin shqiptar të dënuar të paguajë shpërblime për dëmet e shkaktuara nga kryerja e veprave penale. Megjithatë ajo mund të lidhet edhe me efekte të tjera civile të ardhura nga kryerja e veprave penale, siç mund të jenë efektet civile të ardhura për shkak të falsifikimit të dokumentave apo përdorimit të tyre, etj. Nuk duhen përfshirë këtu rastet e konfiskimit të pasurive që kanë shërbyer si mjete për kryerjen e veprës penale apo që kanë rrjedhur nga kryerja e veprës penale, gjë që në legjislacionin shqiptar parashikohet si masë dënimi plotësuese.
- d) Për efekte të cilësimit përsëritës të personit që ka kryer veprën penale (neni 10/a i KPP-së). Kjo gjë lidhet me evidentimin e faktit që personi autor i veprës penale është i dënuar, ashtu si edhe nga vendimet penale shqiptare, gjë që bëhet duke u pasqyruar në regjistrin gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë të RSh-së , siç është përcaktuar në nenet 481 – 482 të KPP-së. Cilësimi përsëritës i autorit të veprës penale lidhet edhe me dispozitën e nenit 6 të KP-së, sipas të cilit ligji penal i RSh-së është i zbatueshëm për shtetasin shqiptar jo vetëm për veprat penale të kryera brenda territorit të RSh-së (neni 6/1), por edhe për krimet e kryera në territorin e një shteti tjetër (neni 6/2), kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm. Në të njëjtën kohë, sipas nenit 6/3 të K.Penal shtetas shqiptarë konsiderohen edhe personat që

përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe një shtetësi tjetër. Cilësimi përsëritës i autorit të veprës penale ndikon në pozicionin e tij shoqëror e të punësimit, si dhe vlerësimin e rrezikshmërisë së tij si individ, fakte këto që merren parasysh nga gjykata si rrethanë rënduese për caktimin e dënimit sipas nenit 50/ç të K.Penal, në rastet e gjykimit dhe fajësisë së personit që kryen vepra penale të mëvonshme (përveç rasteve të rehabilitimit të autorit të veprës penale sipas nenit 69 të KP-së).

KP i RSh-së përfshin gjithashtu parashikime në lidhje me institutin e ekstradimit. Dispozita e nenit 11 të tij përcakton, se *“ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat RSh është palë”*. Siç shihet nga ky përcaktim, KP nuk përfshin parashikime të detajuara për sa i takon ekstradimit, përveç kushtit të ekzistencës së marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me të.

Zbatimi i këtyre dy instituteve, si ekstradimit ashtu edhe njohjes së vendimeve penale të huaja, shoqërohet me shmangie nga parimi i territorialitetit, por nga ana tjetër, nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare ato zbatojnë parimin e reciprocitetit midis palëve pjesëmarrëse në to.

Ndërkohë, procedurat ligjore të zbatimit të instituteve të ekstradimit dhe njohjes së vendimeve penale rregullohen nga Kodi i Procedurës Penale (nenet 488 – 504 dhe 512 – 518) dhe ligje të tjera të posaçme, për të cilat do të flitet në vazhdim.

3.4.1.3.Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës Penale (KPP) është ligji bazë që rregullon marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, ku përcaktohen llojet e tyre, mënyra apo procedura se si do të ushtrohen ato dhe cilët janë autoritetet përgjegjës për ushtrimin e tyre. Në dispozitat e përgjithshme të tij, konkretisht në dispozitën e nenit 10, parashikohet:

Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuara nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi.

Nëpërmjet kësaj dispozite theksohet edhe një herë epërsia e marrëveshjeve ndërkombëtare, parimeve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, të pranuara nga shteti shqiptar, në përputhje kjo edhe me parimin kushtetues të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës së RSh-së që u analizua më lart.⁸

Në titullin X të tij KPP parashikon një sërë dispozitash, në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, të cilat janë ndarë në tre krerë, më konkretisht:

- a) Kreu i parë i këtij titulli përcakton rregullime mbi “ekstradimin”, të ndara në dy seksione: i pari si në lidhje me ekstradimin për jashtë shtetit (nenet 488 – 503) dhe i dyti në lidhje me ekstradimin nga jashtë shtetit (neni 504).

Në këtë kod përcaktohen procedurat që duhet të ndiqen nga organet e drejtësisë në rastet e një ekstradimi (nenet 489, 491, 492, 497 dhe 501), kushtet në të cilat lejohet të kryhet një ekstradim (nenet 489 dhe 490), masat shtrënguese dhe sekuestrimet në

⁸ Shënim: shih çështjen 3.3.1. po në këtë kapitull

rast ekstradimi (nenet 493 – 496), disponimet e gjykatës për ekstradimin (nenet 491, 498 dhe 499, pezullimin e dorëzimit (neni 500), kalimin tranzit (neni 502) si dhe shpenzimet e ekstradimit (neni 503).

- b) Kreu i dytë përcakton rregullime për letërporositë ndërkombëtare, si nga jashtë shtetit (nenet 505 – 508), ashtu edhe për jashtë shtetit (nenet 509 – 511).
- c) Kreu i tretë përcakton rregullime mbi ekzekutimin e vendimeve penale të huaj (nenet 512 – 518), si dhe ekzekutimi jashtë shtetit të vendimeve penale shqiptare (nenet 519 – 523).

Përsa i përket trajtimit të institutit të ekstradimit nga KPP i RSh-së , neni 488 i tij përkufizon kuptimin e ekstradimit. Në paragrafin e parë të nenit 489 të KPP-së parashikohet, se ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa në paragrafin e dytë përcaktohen aktet që i bashkëlidhen kërkesës për ekstradim, konkretisht:

- a) kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;
- b) një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj;
- c) teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;

d) të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

Ndërsa në paragrafin e tretë të nenit 489 të KPP-së parashikohen disa rregulla për rastet kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi.

Në nenin 490 të KPP-së janë pasqyruar kushtet e lejimit të ekstradimit, ndërsa në nenin 491 të tij rastet e mospranimit të kërkesës për ekstradim.

Në nenin 492 të KPP-së përcaktohet procedura që ndiqet në rastet e pranimit të kërkesës për ekstradim nga MD, e cila ia dërgon atë bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente (neni 492/1), që zakonisht është gjykata e shkallës së parë e vendbanimit të personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, më pas me radhë gjykatat e shkallëve të tjera të gjyqimit. Prokurori pasi merr kërkesën urdhëron paraqitjen e të interesuarit për të bërë identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventual për ekstradimin, duke i bërë të ditur edhe se ka të drejtë të ndihmohet nga një mbrojtës (neni 492/2). Prokurori u kërkon autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin dhe informacionin që çmon të nevojshëm (neni 493/3). Brenda tre muajve nga data kur ka ardhur kërkesa për ekstradim, prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për shqyrtim (neni 494/4). Kërkesa e prokurorit depozitohet në sekretarinë e gjykatës bashkë me aktet dhe sendet e sekuestruara (neni 494/5).

Sipas nenit 493 të KPP-së, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa

shtrënguese dhe të vendoset sekuestrimi i provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprës penale, për të cilën është kërkuar ekstradimi (neni 493/1). Për caktimin e masave shtrënguese respektohen dispozitat e titullit V të KPP-së, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit (neni 493/2). Masat shtrënguese dhe sekuestroja nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit (neni 493/3). Masat shtrënguese revokohen kur brenda tre muajve nga fillimi i ekzekutimit të tyre nuk ka përfunduar procedimi para gjykatës. Me kërkesë të prokurorit afati mund të zgjatet, por jo më shumë se një muaj, kur është e nevojshme të bëhen verifikime veçanërisht komplekse (neni 493/4).

Sipas nenit 494 të KPP-së, me kërkesën e shtetit të huaj, të paraqitur nga MD nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente, gjykata mund të vendosë përkohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit (neni 494/1), e cila, sipas 494/2, mund të vendoset në këto raste:

- a) shteti i huaj ka deklaruar se kundër personit është marrë një masë për kufizimin e lirisë personale ose një vendim dënimi me burgim dhe se ka ndër mend të paraqesë kërkesë për ekstradim;
- b) shteti i huaj ka paraqitur të dhëna të hollësishme për veprën penale dhe elemente të mjaftueshme për identifikimin e personit;
- c) kur ka rrezik ikjeje.

MD njofton shtetin e huaj për zbatimin e përkohshëm të masës shtrënguese dhe të sekuestros eventuale (neni 495/5).

Masat shtrënguese revokohen në qoftë se brenda tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithësesi në maksimum dyzet ditë nga njoftimi i mësipërm nuk vjen në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e ekstradimit dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj.

Në nenin 495 të KPP-së parashikohet, se në rastet e ngutshme, policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm, si dhe sekuestrimin e provave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj. Më tej kjo dispozitë parashikon procedurat dhe afatet përkatëse që ndiqen nga prokurori, gjykata dhe MD, në lidhje me miratimin ose jo të arrestimit.

Neni 496 i KPP-së parashikon detyrimin në lidhje me dëgjimin e personit ndaj të cilit është marrë masë shtrënguese, ndërsa nenet 497 dhe 498 përcaktojnë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së ekstradimit nga gjykata dhe vendimin e marrë prej saj.

Autoriteti përgjegjës për disponimin mbi ekstradimin, sipas nenit 499 të KPP-së është MD, e cila disponon për ekstradimin brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. Me mbarimin e këtij afati, edhe kur nuk është disponuar nga ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet, ashtu sikurse edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit. MD i komunikon shtetit kërkesën e vendimit dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet. Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar

dhe me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkues mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Kur ka shkaqe që nuk varen nga palët, mund të caktohet një datë tjetër dorëzimi, por gjithmonë duke u zbatuar afatet e caktuara në këtë paragraf. Vendimi i ekstradimit e humbet fuqinë dhe i ekstraduari lirohet kur shteti kërkues nuk vepron, në afatin e caktuar, për marrjen në dorëzim të të ekstraduarit.

Më tej, në nenin 500 janë parashikuar rastet e pezullimit të dorëzimit, në nenin 501 rastet e zgjerimit të ekstradimit të dhënë dhe riekstradimit.

Në nenin 502 të KPP-së gjëhen pasqyrim instituti i kalimit përmes territorit të shtetit shqiptar i një personi të ekstraduar nga një shtet në tjetrin, i cili autorizohet nga MD nga shteti ku do të kryhet ekstradimi dhe në qoftë se kalimi tranzit nuk prek sovranitetin, sigurimin ose interesat të tjera shtetërore. Po këtu përcaktohen edhe rastet kur nuk autorizohet kalimi tranzit.

Në nenin 504 të KPP-së parashikohen kriteret e kërkesave për ekstradim, për të cilat është kompetente MD. Kjo e fundit i paraqet një shtet të huaj kërkesën për ekstradimin e një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale. Për këtë, prokurori pranë gjykatës në territorin e së cilës procedohet ose është dhënë vendim dënimi, i bën kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke i dërguar aktet dhe dokumentet e nevojshme. Kur nuk e pranon kërkesën, ministria njofton autoritetin që e ka bërë atë. MD është kompetente të vendosë në lidhje me kushtet e vëna eventualisht nga shteti i huaj për të dhënë ekstradimin, kur ato nuk vijnë në kundërshtim

me parimet themelore të rendit juridik shqiptar, të cilat duhet të respektohen nga autoriteti procedues.

Në lidhje me letërporositë ndërkombëtare, në kuptim të dispozitave të KPP-së, letërporositë (njihen ndryshe edhe me termin “letërkërkesa ndërkombëtare”) përbëjnë veprime ndërshtetërore, në lidhje me komunikimet e akteve, njoftimet dhe marrjen e provave në procesin penal. Këto dispozita përcaktojnë: rastet, se kur mund të procedohet me një letërporosi drejtuar autoriteteve të huaja; kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë, e cila përbën organin e vetëm nëpërmjet të cilit përcillen letërporositë drejtuar autoriteteve të huaja dhe anasjelltas; procedurat që duhet të ndiqen për ekzekutimin e letërporosisë së huaj si dhe vlerën e akteve të marra me letërporosi.

Kështu, MD vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit (neni 505/1). MD nuk i jep rrugë letërporosisë në rastet e përcaktuara nga neni 505/2, 3, 4 i KPP-së.

Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet (neni 506). Për këtë, prokurori përkatës pasi merr aktet nga MD, paraqet kërkesën në gjykatë, e cila disponon vendim për ekzekutimin ose jo të letërporosisë. Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet kur janë rastet që MD nuk i jep rrugë letërporosisë, si dhe kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet

nga ligji shqiptar si vepër penale. Në rastet e pranimi për ekzekutim të letërporosisë, gjykata në vendimin e saj cakton trupin gjykues që do të ekzekutojë letërporosinë (neni 507/1). Për kryerjen e veprimeve të kërkuara në letërporosinë që ekzekutohet, zbatohen normat e KPP-së të RSh-së , përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar (neni 507/2). Nëpërmjet letërporosive mund të kërkohet thirrja e dëshmitarëve që kanë vendqëndrimin ose vendbanimin në territorin e shtetit shqiptar për t'u paraqitur në autoritetin gjyqësor të huaj (neni 508). Kërkesa i dërgohet prokurorit të rrethit përkatës, i cili merr masa për njoftimin duke vepruar si në rastin e njoftimit të të pandehurit në gjendje të lirë, bazuar në nenet 140 – 141 të KPP-së.

Në nenet 509 – 511 të KPP-së parashikohen rregullime në lidhje me letërporositë për jashtë shtetit. Letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato (neni 509/1). Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar ministrin e Drejtësisë (neni 509/4). Kur çmon se mund të rrezikohet siguri ose interesat e tjera të rëndësishme të shtetit, Ministria urdhëron, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e letërporosisë, që kësaj të mos i jepet rrugë (neni 509/2). Ministria i komunikon autoritetit procedues që ka bërë kërkesën datën e marrjes së saj dhe nisjen e letërporosisë ose urdhrin për të mos i dhënë rrugë letërporosisë (neni

509/3). Në interpretim të nenit 509 të KPP-së, GJK e RSh-së, në vendimin nr.23 datë 23.07.2009 ka përcaktuar, se:

8. Përmbajtja e letërporosive ndërkombëtare rregullohet edhe nga Kodi i Procedurës Penale (KPP). Neni 509 përfshin kriteret për dërgimin e letërporosive për jashtë shtetit. Sipas këtij neni, letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato.

Në përmbledhje të dispozitave të KPP-së të RSh-së, që lidhen me letërporositë ndërkombëtare, provat e marra nëpërmjet tyre duhet të merren në përputhje me Konventën për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe dispozitat përkatëse procedurale penale për marrjen e provës së caktuar. Për këtë është shprehur edhe GJK e RSh-së në vendimin nr.23 datë 23.07.2009, më konkretisht:

11. Aktet e siguruara me letërporosi kanë vlerën e provës në qoftë se janë marrë në përputhje me normat procedurale shqiptare. Në doktrinën e të drejtës penale, lidhur me marrjen e provave me letërporosi, çështja e ligjit të zbatueshëm është shumë e rëndësishme. Pyetja kryesore që lidhet me këtë çështje është nëse prova merret sipas ligjit të shtetit kërkues, apo në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar. Një shtet mund të kërkojë që disa formalitete të zbatohen në mënyrë që ai shtet ta pranojë provën e mbledhur gjatë procesit.

12. Siç u përmend dhe më sipër, parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Provat trajtohen në Titullin IV të KPP-së. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi (neni 152 i KPP-së). Neni 193 i KPP-së, pjesë e seksionit VIII mbi Dokumentet si lloje provash në një procedim penal parashikon, që si të tilla, mund të merren edhe procesverbale të procedimeve të tjera. Kështu, neni 193/1 parashikon se lejohet marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

13. Nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të dosjes gjyqësore Gjykata vëren, se mënyra e marrjes së provave në procesin gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është bërë në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe me nenet 193, 505 e në vijim të KPP-së. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe jo në përputhje me konventat ndërkombëtare përkatëse, është i pabazuar.

Neni 510 i KPP-së parashikon kushtet për paprekshmërinë e personit të thirrur në bazë të letërporosisë, ndërsa neni 511 parashikon vlerën e akteve të marra me letërporosi. Në lidhje me të GjK e RSh-së në vendimin e saj nr.23 datë 23.07.2009 ka përcaktuar, se:

Neni 511 shprehet për vlerën e akteve të marra me letërporosi. Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t'i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji.

KPP përfshin parashikime në lidhje ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, ku përcaktohen: procedurat ligjore dhe organet kompetente për njohjen e vendimeve penale; kushtet, që duhet të përmbushen për njohjen e vendimeve penale; masat shtrënguese, që mund të vendosen gjatë procesit të njohjes së vendimeve penale; mënyra e caktimit të dënimeve penale; si dhe mënyra e ekzekutimit të tyre. Më konkretisht, neni 512 i KPP-së përcakton procedurat për njohjen e vendimeve penale të huaj, sipas të cilit MD, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe. MD kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit për njohjen e vendimit të huaj dhe nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t'u kërkojë autoriteteve të huaja

informacionet që i çmon të nevojshme. Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet (neni 514) në rastet kur:

- a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;
- b) vendimi përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;
- c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;
- d) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;
- e) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;
- f) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formë së prerë ose zhvillohet një procedim penal.

Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente për njohjen e një vendimi të huaj mund të vendosë një masë shtrënguese ndaj të dënuarit që ndodhet në territorin shqiptar (neni 515), duke marrë masa për identifikimin e personit dhe duke i njoftuar atij të drejtën për të patur mbrojtës. Masa shtrënguese e vendosur në këtë rast revokohet kur nga fillimi i ekzekutimit të saj kanë kaluar tre muaj pa u dhënë vendimi i njohjes nga gjykata e rrethit ose gjashtë muaj pa marrë vendimi formën e prerë.

Kur bën njohjen e një vendimi të huaj, gjykata cakton dënimin që duhet të vuhet në shtetin shqiptar, sipas nenit 516 të KPP-së, i cili përcakton këto kritere për disponimin e gjykatës shqiptare për caktimin e dënimeve në rastet e njohjes së vendimeve penale të huaj:

- a) Gjykata shqiptare konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj në një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar;
- b) Dënimi i gjykatës shqiptare duhet t'i përgjigjet nga natyra dënimit që është dhënë në vendimin e huaj;
- c) Masa e dënimit nuk mund të kalojë kufirin maksimal të parashikuar për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar;
- d) Kur në vendimin e huaj nuk është caktuar masa e dënimit, gjykata e cakton atë mbi bazën e kritereve të Kodit Penal për caktimin e dënimeve, në kreun IV të tij;
- e) Kur ekzekutimi i dënimit të dhënë në shtetin e huaj është pezulluar me kusht, gjykata disponon në vendimin e njohjes, veç të tjerave, edhe pezullimin me kusht të dënimit. Të njëjtën gjë gjykata bën edhe kur i pandehuri është liruar me kusht në shtetin e huaj;
- f) Për të caktuar dënimin me gjobë shuma e vënë në vendimin e huaj konvertohet në vlerë të barabartë me lekë shqiptare, duke zbatuar kursin e këmbimit të ditës në të cilën është vendosur njohja;
- g) Në vendimin e njohjes për ekzekutimin e një konfiskimi, urdhërohet edhe zbatimi i konfiskimit;

- h) Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente mund të vendosë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme, duke respektuar për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat që rregullojnë sekuestron preventive (nenet 274 – 276 të KPP-së).

Në nenin 518 të KPP-së përcaktohet mënyra e ekzekutimit të vendimeve të huaja pasi ka kaluar në procesin e njohjes së tij, gjë që bëhet sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin shqiptar për ekzekutimin e vendimeve penale (titulli IX i KPP-së).

Më tej në nenet 519 – 523 të KPP-së parashikohen procedurat e ekzekutimit jashtë shtetit të vendimeve penale shqiptare, i cili kryhet në rastet parashikuara nga marrëveshjet ndërkombëtare ose nga neni 501/2 i KPP-së, siç u citua më lart. MD është autoriteti përgjegjës që kërkon ekzekutimin jashtë shtetit të vendimeve penale ose jep pëlqimin kur ai kërkohet nga shteti i huaj Neni 519/1). Ekzekutimi jashtë shtetit i një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale mund të kërkohet ose të lejohet vetëm në qoftë se:

- a) I dënuari që ka marrë dënimin për pasojat, ka deklaruar lirisht se jep pëlqimin dhe ekzekutimi në shtetin e huaj është i përshtatshëm për ri-integrimin e tij shoqëror (neni 519/2);
- b) Kur nuk ekzistojnë kushtet e nenit 519/2, në qoftë se i dënuari ndodhet në territorin e shtetit, të cilit i është drejtuar kërkesa dhe ekstradimi është mohuar ose sidoqoftë nuk është i mundur.

Para se të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi, MD i dërgon aktet prokurorit, i cili bën kërkesë në gjykatë. Pëlqimi i të dënuarit duhet të jepet para gjykatës shqiptare. Në

qoftë se ai ndodhet jashtë shtetit, pëlqimi mund të jepet para autoritetit konsullor shqiptar ose para gjykatës së shtetit të huaj (neni 520).

Në nenin 521 të KPP-së parashikohen rastet e moslejimit të ekzekutimit të një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale jashtë shtetit, kur ka arsye të çmohet se i dënuari do t'u nënshtrohet akteve persekutuese ose diskriminuese për shkak të racës, fesë, seksit, kombësisë, gjuhës apo bindjeve ose dënimeve e trajtimeve të egra, çnjerëzore ose poshtëruese.

Në rastet kur kërkohet ekzekutimi i një dënimi me kufizim të lirisë personale dhe i dënuari ndodhet jashtë shtetit, MD kërkon paraburgimin e tij (neni 522/1).

Në kërkesën për ekzekutimin e një konfiskimi, MD ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme (Neni 522/2). Ekzekutimi i dënimit në shtetin shqiptar pezullohet nga çasti kur ka filluar ekzekutimi në shtetin e huaj (Neni 523/1). Dënimi nuk mund të ekzekutohet më në shtetin shqiptar, kur sipas ligjeve të shtetit të huaj ai është shlyer tërësisht (neni 523/2).

3.4.1.4.Ligjet e tjera

Përveç sa përmendëm më lart, kuadri ligjor i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal në Shqipëri plotësohet edhe me ligje të posaçme në këtë fushë.

Ligji Nr. 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i miratuar në datë 03.12.2009 (Fletore zyrtare nr. 181, 2009:8080), ndryshuar me ligjin nr.100/2013 datë 18.03.2013 (Fletore zyrtare nr. 45, 2013:2035) është ligj bazë, që

përfshin parashikime në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale (neni 1). Në përputhje me këtë përcaktim, ky ligj parashikon rregulla më të detajuara, në lidhje me ato çka parashikon KPP, konkretisht: disponimet në lidhjet me llojet, rregullat, procedurat, autoritetet kompetente e përgjegjëse, si dhe efektet që pasojnë nga ekzekutimi e letërkërkesave apo letërporosive, ekstradimi nga/për në Shqipëri, njohja e vendimeve penale të huaj në Shqipëri dhe vendimeve penale shqiptare jashtë shtetit, si dhe transferimi i procedimit penal nga/në një shtet të huaj.

Në këtë ligj gjithashtu parashikohen disa parime të përgjithshme, konkretisht:

a. Në lidhje me ekzekutimin e letërkërkesave:

- Parimi i reciprocitetit (neni 9), sipas pikës 1 të të cilit përcaktohet, se letërkërkesa e autoritetit gjyqësor të huaj pranohet nëse përmban garancitë për reciprocitet, të dhëna nga shteti kërkues, që përfshijnë pritshmërinë që ky shtet të ekzekutojë një kërkesë të ngjashme të drejtuar nga autoritetet gjyqësore vendase. Megjithatë, po në këtë dispozitë parashikohet si përjashtim nga ky rregull rasti kur MD, pavarësisht pikës 1 të këtij neni, mund t'i japë rrugë letërporosive edhe në mungesë të garancive të shprehura për reciprocitet.
- Parimi i konfidencialitetit (neni 12), sipas të cilit MD dhe autoriteti kompetent gjyqësor vendas, me kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, zbatojnë rregullat

për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionin e treguar në letërkërkesë. Nëse kjo kërkesë nuk mund të plotësohet, MD ose autoriteti gjyqësor vendas, njoftojnë brenda 5 ditëve autoritetin gjyqësor të huaj.

b. Në lidhje me ekstradimin:

- Parimi i specialitetit (neni 42), sipas të cilit Ministri i Drejtësisë kërkon nga shteti kërkues që: i ekstraduari nuk duhet të ndiqet penalisht për një vepër tjetër penale të kryer përpara ekstradimit; i ekstraduari nuk duhet t'i nënshtrohet ekzekutimit të një vendimi për një vepër tjetër penale të kryer përpara ekstradimit; ndaj të ekstraduarit nuk duhet të zbatohet një dënim më i rëndë sesa dënimi me të cilin ai është dënuar dhe as dënimi me vdekje; i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij; dhe i ekstraduari nuk duhet të ekstradohet drejt një shteti të tretë, pa pëlqimin e Republikës së Shqipërisë, për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për dënimin me burgim ose për ekzekutimin e një mase sigurimi shtrënguese të karakterit personal për kufizimin e lirisë, të dhënë përpara se ekstradimi të lejohej.

Në lidhje me këtë parim parashikohen përjashtime sipas nenit 490 pikat 2 dhe 3 të KPP-së, konkretisht rastet, kur: kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka

kundërshtim; kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar 45 ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht; si dhe MD mund të vendosë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme.

c. Në lidhje me njohjen e vendimeve penale të huaj:

- E drejta e mbrojtjes me avokat (neni 56) të zgjedhur apo të caktuar nga organi procedues (gjykata) i personit ndaj të cilit kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit penal të huaj.

Pavarësisht rregullimeve që përcakton ky ligj, në nenin 1 të tij përcaktohet, se dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen, kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat RSh është palë. Kjo gjë është shprehje e parimit kushtetues mbi përparësinë e akteve ndërkombëtare.

Në ligjet e tjera në fushën e marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal përfshihen edhe një sërë ligjesh, që kanë ratifikuar akte ndërkombëtare që kanë të bëjnë me këto marrëdhënie, të cilat do të përmenden më poshtë.

3.4.2. Aktet ndërkombëtare të aplikueshme në fushën e marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri

Aktet ndërkombëtare përbëjnë një rëndësi të veçantë në të drejtën e brendshme, gjë që është shprehur edhe në parimet themelore të Kushtetutës së RSh-së. Në përgjithësi marrëveshjet ndërkombëtare përmbajnë detyrimin e përafrimit të legjislacionit me sa është

parashikuar në marrëveshje. Kjo gjë ka sjellë që shpesh herë legjislacioni penal të ketë pësuar ndryshime në përputhje me kërkesat e akteve ndërkombëtare të pranuar apo të ratifikuara nga Shqipëria. “Përgjithësisht vërehet se është bërë kujdes që standartet e parashikuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë të gjejnë pasqyrim edhe në dispozitat ligjore e nënligjore vendase...” (Komiteti shqiptar i Helsinkit, 2006:6).

Sipas nenit 122 të saj parashikohet, ndër të tjera, se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose ratifikohet me ligj. Kjo gjë bën që edhe në raste të boshllëkut të legjislacionit të brendshëm, gjykatat apo organet procedues në një proces penal mund t’i referohen drejtpërdrejt aktit ndërkombëtar përkatës të pranuar apo ratifikuar nga Shqipëria.

Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare nga gjykatat kombëtare mund të ketë efekte dhe funksion të shumëfishtë. Para së gjithash, normalisht një gjë e tillë vjen për shkak të urdhërimit kushtetues, që në planin hierarkik i vendos sipas rastit normat e së drejtës ndërkombëtare pas kushtetutës dhe mbi ligjet e miratuara nga parlamenti (rasti i vendit tonë), ose pas kushtetutës, por në një plan me statutet apo ligjet e zakonshme (rasti i Gjermanisë), e të tjerë. (Zaganjori, 2012:11)

Shqipëria ka ratifikuar një varg aktesh ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, të cilat janë parashtruar në vijim.

Me ligjin Nr. 8322, datë 09.04.1998 (Fletore zyrtare nr. 10, 1998:353) u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës “Për ekstradimin” e 13 dhjetorit 1957 dhe të dy protokolleve shtesë të saj, përkatësisht të 15 tetorit 1957 dhe të 17 marsit 1978. Këto akte ndërkombëtare janë ratifikuar me disa deklarime dhe rezerva që janë parë të arsyeshme nga ligjvënësit shqiptar,

për të cilat i njihet e drejta shteteve palë sipas nenit 9 të Konventës. Ato parashikohen në këtë ligj, lidhur me: rastet e refuzimit të ekstradimit të shtetasve shqiptarë; rastet e moslejimit të ekstradimit të personave; panevojshmërinë e njoftimit paraprak në rastet e tranzitit ajror të të ekstraduarve, që nuk parashikon ulje në territorin shqiptar. Pavarësisht deklarimeve dhe rezervave të parashikuara në këtë ligj, vetë ligji parashikon si përjashtim rastet, kur në marrëveshjet ndërkombëtare është parashikuar ndryshe nga ky ligj.

Më pas, me ligjin Nr. 10426, datë 02.06.2011 (Fletore zyrtare nr. 77, 2011:3134) është ratifikuar protokollin i tretë shtesë i Konventës Europiane “Për ekstradimin” i Strasburgut datë 10.11.2010, i cili kishte për qëllim të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të EU-së, me dëshirën e forcimit të aftësisë së tyre individuale dhe kolektive për t’iu përgjigjur krimit. Ky protokoll e plotëson në disa aspekte Konventën “Për ekstradimin”, në drejtim të lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave të ekstradimit, duke parashikuar ekstradimin me procedura të thjeshtuara, në rastet kur personi i kërkuar jep pëlqimin për ekstradimin.

Me ligjin Nr. 8497, datë 29.06.1999 (Fletore zyrtare nr. 21, 1999:681) u ratifikua Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e proçedimeve në çështjet penale”. Bazuar në nenin 18 paragrafi 2 të Konventës, ky ligj parashikon deklarin, se kërkesat dhe çdo dokument tjetër që lidhet me to, në qoftë se nuk janë paraqitur në njërën nga gjuhët zyrtare të KE-së, duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën shqipe ose në njërën nga ato

gjuhë. Ky ligj ka parashikuar në të njëjtën kohë disa rezerva, lidhur me refuzimin e transferimit të procedimeve penale për disa raste, konkretisht për:

- Procedimet për vepra penale të një natyre thjesht fetare;
- Procedimet e akteve, sanksionet, për të cilat, sipas ligjit shqiptar, mund të kërkohet të zbatohen vetëm nga autoritet administrative;
- Procedimet e veprave penale, për të cilat është filluar hetimi nga një shtet tjetër, përveç rasteve të veprave penale me natyrë politike ose ushtarake.

Pavarësisht se ky ligj parashikon kufizime, ato janë në përputhje me vetë përmbajtjen e Konventës, e cila i lejon këto kufizime sipas neneve 30, 31 dhe 41 të saj, si dhe shtojcës së parë të saj.

Me ligjin Nr. 8498, datë 29.06.1999 (i ndryshuar) (Fletore zyrtare nr. 21, 1999:697) është ratifikuar Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” e 20 prillit 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997. Edhe ky ligj parashikon rezerva, për sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të sendeve, e drejtë që i njihet palës kontraktuese nga neni 5 pika 1 shkronjat “a” dhe “c” të vetë Konventës, në lidhje me:

- Dënueshmërinë sipas legjislacionit penal shqiptar të krimeve, për të cilat është kërkuar letërporosi;
- Përputhshmërinë e ekzekutimit të letërporosive me ligjin shqiptar.

Me ligjin Nr. 8499, datë 29.06.1999 (Fletore zyrtare nr. 22, 1999:719) është ratifikuar pa asnjë kufizim Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” e datës 21.03.1983.

Ndër Konventat e tjera të ratifikuara nga Shqipëria që kanë lidhje me fushën e studimit, mund të përmenden:

- *Konventa Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht*, ratifikuar me ligjin nr.8724, datë 26.12.2000;
- *Konventa Europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale*, ratifikuar me ligjin nr. 9604 datë 11.09.2006 (Fletore zyrtare nr.107, 2006:4199);
- *Konventa mbi bashkëpunimin policor të Europës Jugperëndimore e datës 31.03.2006*, ratifikuar me ligjin nr. 9604, datë 11.09.2006 (Fletore zyrtare nr. 107, 2006:4199), ku palë janë Republika e Shqipërisë, Bosnia dhe Herzegovina, Maqedonia, Republika e Moldavisë, Rumania, bashkimi shtetëror i Sërbisë dhe Malit të Zi. Kjo konventë është krijuar, ndër të tjera për të bashkëpunuar me efikasitet në luftën kundër krimeve, që lidhen me kërcënimet ndërkufitare ndaj rendit dhe sigurisë publike si dhe krimin ndërkombëtar kundër rendit dhe sigurisë publike.
- *Konventa “Për akses ndërkombëtar në drejtësi”*, ratifikuar me ligjin nr. 9753 datë 14.06.2007 (Fletore zyrtare nr. 80, 2007:2371).

Pavarësisht se aktet ndërkombëtare të sipërpermendura janë ratifikuar pas vitit 1995, kohë në të cilën janë miratuar KP dhe KPP në Shqipëri, këta të fundit përmbushnin në

përgjithësi kërkesat dhe respektonin parimet kryesore të tyre, gjë që ka sjellë edhe mosndryshimin e dispozitave që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal (përveç disa ndryshimeve të vogla). Më pas, përmbajtja e këtyre akteve ndërkombëtare është materializuar edhe në ligjin Nr. 10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), i miratuar në datë 03.12.2009.

Përveç sa u përmendën deri më tani, Shqipëria ka ratifikuar edhe një sërë aktesh të tjera ndërkombëtare mbi luftën kundër krimeve në fusha të caktuara, si psh: mbi krimin e organizuar ndërkombëtar, mbi shtypjen e terrorizmit, pastrimin e parave, lëndët narkotike e psikotrope, trafiqet e paligjshme, krimeve kibernetike, etj.

Të gjithë këto traktate ndjekin të njëjtin parim: ato përmbajnë një përkufizim të përbashkët të sjelljes së ndaluar, detyrojnë shtetet kontraktuese të kriminalizojnë këtë sjellje në të drejtën e tyre të brendshme, përcaktojnë parimet kryesore të juridiksionit dhe sigurojnë ekstradimin e dyanshëm të autorëve të veprave penale. (Cassese et al, 2012:19)

Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar akte të tjerë ndërkombëtare në fushën e të drejtës penale, si: statutin e Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare Penale, Konventën Europiane “Mbi dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë”, etj, të cilat nuk janë objekt i këtij studimi.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dy apo shumë palëshe me objekt bashkëpunimin në fushën e së drejtës penale për luftën efikase kundër krimeve të ndryshme, sidomos krimeve të rënda. Marrëveshjet shumëpalëshe në fushën e marrëdhëneve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal kryesisht janë:

- Marrëveshja Europiane “Për transferimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore”, ratifikuar me ligjin nr.8705 datë 01.12.2000 dhe protokollit shtesë të saj, ratifikuar me ligjin nr.8882 datë 18.04.2002 (Fletore zyrtare nr. 16, 2002:492);
- Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, ratifikuar me ligjin nr.8541 datë 21.10.1999, si dhe karta për organizimin e funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar, ratifikuar me ligjin nr.8639, datë 13.7.2000;
- Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara, ratifikuar me ligjin nr.8512 datë 15.07.1999 (Fletore zyrtare nr. 23, 1999:809) dhe protokollit shtesë për luftën kundër terrorizmit, ratifikuar me ligjin nr.9500 datë 03.04.2006. Fusha e bashkëpunimit sipas kësaj marrëveshjeje parashikohet në nenin 1 të saj, ku vlen të theksohet bashkëpunimi për parandalimin, shtypjen, zbulimin, mbylljen dhe investigimin e krimeve dhe në veçanti të: akteve të terrorizmit; krimit të organizuar; vepave penale në lidhje me narkotikët; trafikut të paligjshëm të armëve, njerëzve, veprave të artit, etj; aktiviteteve ilegale ekonomike; kontrabandës; aktiviteteve kriminale të lidhura me migracionin, kalimin ilegal të kufirit, shfrytëzimin seksual të grave dhe të miturve apo fëmijëve; falsifikimit të kartëmonedhave, kartave të kreditit, dokumentave, etj; krimet e dhunshme kundër jetës

dhe pronës së njerëzve; korrupsionit; krimit ekologjik; krimit teknologjik; marrjes peng dhe tregëtimit të njerëzve dhe organeve; krimeve detare; vjedhjeve dhe trafikut ilegal të automjeteve. Marrëveshja parashikon format dhe mjetet e bashkepunimit në këto aspekte.

- Marrëveshja për stabilizim dhe asociim midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre, ratifikuar me ligjin nr.9590 datë 27.07.2006 (Fletore zyrtare nr. 87, 2006:2955).

Nga ana tjetër Shqipëria ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe në luftë kundër krimit me mjaft shtete, më konkretisht:

Greqia – Konventa për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale, e nënshkruar në Athinë më 13 Maj 1993, e ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993 (Fletore zyrtare nr. 12, 1993:787);

Turqia – Konventa për ndihmën e ndërsjelljes gjyqësore në fushat civile, tregtare dhe penale, ratifikuar me ligjin nr. 8036, datë 22.11.1995 (Fletore zyrtare nr. 25, 1995:1105);

Rusia – Marrëveshja për ndihmë juridike dhe marrëdhëniet juridike për çështje civile, familjare dhe penale, ratifikuar me ligjin nr. 8061, datë 08.02.1996 (Fletore zyrtare nr. 2, 1996:35);

Maqedonia – Marrëveshja për ekstradimet, ratifikuar me ligjin nr. 8299 datë 04.03.1998, (Fletore zyrtare nr. 7, 1998:254); marrëveshja për ndihmën juridike në fushën civile dhe

penale, ratifikuar me ligjin nr. 8304, datë 12.03.1998 (Fletore zyrtare nr. 7, 1998:260); marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, ratifikuar me ligjin nr. 9307, datë 04.11.2004 (Fletore zyrtare nr. 90, 2004:6418);

Sllovenia – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar, ratifikuar me ligjin nr. 8413, datë 01.10.1998 (Fletore zyrtare nr. 25, 1998:990);

Hungaria – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar, ratifikuar me ligjin nr.8623, datë 15.6.2000;

Rumania – Marrëveshja për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme, ratifikuar me ligjin nr.8945, datë 03.10.2002, (Fletore zyrtare nr. 67, 2002:1888);

Egjipti – Marrëveshja e ekstradimit, nënshkruar në Kajro më 2.4.2002, ratifikuar me ligjin nr. 9214, datë 01.04.2004 (Fletore zyrtare nr. 27, 2002:1331);

Kosova – Marrëveshja për transferimin e personave të dënuar, ratifikuar me ligjin nr. 9496, datë 20.03.2006 (Fletore zyrtare nr. 26, 2006:940);

Spanja – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër krimit e datës 20 maj 2009, në Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 10155, datë 15.10.2009 (Fletore zyrtare nr. 150, 2009:6783).

Me këtë marrëveshje është pranuar rëndësia e thellimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit për të luftuar krimin në format e ndryshme të tij. Sipas kësaj marrëveshje Shqipëria dhe Spanja bashkëpunojnë në luftën kundër krimit, veçanërisht për format e organizuara të tij: terrorizmit, krimeve kundër jetës dhe integritetit të personave; trafikeve të paligjshme; veprave penale në lidhje me narkotikët; imigrimit të paligjshëm; ndalimit të paligjshëm të personave dhe rrëmbimit të fëmijëve; falsifikimeve; kontrabandës; pastrimit të parave; vjedhjes së mjeteve motorike; formave të organizuara të krimit kundër lirisë seksuale, akteve kriminale me futjen në sistemet kompjuterike; veprave penale kundër burimeve natyrore dhe ambientit;

Çekia – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, ratifikuar me ligjin nr. 10162, datë 15.10.2009;

Bosnje - Hercegovina – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar, ratifikuar me ligjin nr. 10191, datë 03.12.2009 (Fletore zyrtare nr. 181, 2009:8065);

Letonia – Marrëveshja për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe perkursorëve, marrëveshje kjo e hartuar në Tiranë më 16 nënkor 2009, ratifikuar me ligjin nr. 10265, datë 15.04.2010 (Fletore zyrtare nr. 51, 2010:1861);

Serbia – Marrëveshja për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 10344, datë 04.11.2010 (Fletore zyrtare nr. 159, 2010:8346);

Belgjika – Marrëveshja për transferimin e personave të dënuar, e cila është hartuar më 29 korrik 2012 në Belgjikë dhe ratifikuar me ligjin nr. 10378, datë 24.02.2011 (Fletore zyrtare nr. 22, 2011:783).

Italia – Vlen për t’u theksuar, se një nga vendet me bashkëpunim më të gjerë me Shqipërinë është Italia, gjë që ka ardhur si pasojë e fqinjësisë gjeografike të dy vendeve dhe emigracionit në masë të shqiptarëve drejt shtetit italian. Midis këtyre dy shteteve janë lidhur një sërë marrëveshjesh, më konkretisht:

- Marrëveshja për transferimin e personave të dënuar, ratifikuar me ligjin nr. 9169, datë 22.01.2004 (Fletore zyrtare nr. 5, 2004:135), me qëllim intensifikimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në këtë fushë. Kjo marrëveshje e plotëson Konventën Europiane “*Për transferimin e personave të dënuar*” në drejtim të shtrirjes së zbatimit edhe me forma të tjera të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale;
- Marrëveshja e bashkëpunimit në luftën kundër kriminalitetit, ratifikuar me ligjin nr. 9799, datë 10.09.2007 (Fletore zyrtare nr. 124, 2007:3538);
- Marrëveshja shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë

11.02.2008 (Fletore zyrtare nr. 26, 2008:1229), me dëshirë për të plotësuar këto konventa, si dhe për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në to. Kjo është bërë me qëllim që ndihma juridike ndërmjet tyre të kryhet në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Duke pasur parasysh që, përsa i përket ekstradimit të shtetasve, RSh në depozitim të instrumentit të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin deklaronte që: *"Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është Palë Kontraktuese"*, duke iu referuar parashikimit të bërë në nenin 6 paragrafi 1 të së njëjtës Konventë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët kanë si qëllim që të heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje palët dëshironin të plotësonin dhe të përfshinin marrëdhëniet përkatëse në fushën e asistencës juridike për ekstradimin, nën dritën dhe në përputhje me *acquis communautaire* të BE-së në këtë çështje, duke iu referuar në mënyrë të veçantë parashikimeve që përmbahen në Konventën e Ndihmës Juridike në Fushën Penale ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, miratuar nga Këshilli i BE-së, më 29 maj 2000, si dhe protokollin e saj shtesë, të miratuar nga Këshilli i BE-së, më 16 tetor 2001.

Shqipëria ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shtete të ndryshme në kuadër të veprimtarisë së Ministrisë së Brendshme apo bashkëpunimin policor në luftë kundër krimit, si: Italia (2003), Belgjika (2005), Zvicra (2006), EULEX (2012), të cilat paraqesin

rëndësi në grumbullimin e provave dhe fakteve inkriminuese të autorëve të veprave penale. Gjithashtu, RSh aderon në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL, me ligjin 8427, datë 14.12.1998. Këto lloj marrëveshesh nuk prekin çështjet lidhur me ekstradimin apo marrëdhëniet ndërinstitucionale me autoritetet e huaja gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjeve penale, prandaj dhe nuk janë objekt i këtij studimi.

Kapitulli IV: Analizë krahasuese e trajtimit juridik të letërporosive ndërkombëtare në fushën penale në legjislacionin shqiptar në raport me aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionet e shteteve të tjera

4.1. Trajtimi juridik i letërporosive ndërkombëtare nga Konventa e KE-së “Për ndihmën e ndërsjellë juridike” dhe dy protokollet e saj shtesë

Letërporositë ndërkombëtare në procesin penal janë një nga llojet e ushtrimit të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale. Ato gjejnë rregullim ligjor në Konventën e KE-së “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” e datës 20 prill 1957.⁹ Kjo Konventë është pasuar edhe me dy protokolle shtesë të saj, i pari i datës 17 mars 1978 dhe i dyti i datës 08.11.2001, të cilët janë miratuar nga KE për të plotësuar Konventën. Konventa dhe protokollit i parë shtesë janë ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 (Fletore zyrtare nr. 21, 1999:697). Protokollit i dytë shtesë, i cili është ratifikuar me ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002 (Fletore zyrtare nr. 17, 2002:509), është konsideruar si i rëndësishëm për forcimin e kapacitetit individual e kolektiv për t’iu përgjigjur krimit, duke pasur si qëllim të përmirësojë dhe shtojë aspekte të caktuara të Konventës dhe Protokollit të parë shtesë të saj. Nëse protokollit shihet nga pikëpamja formale dhe juridike, vërehet se në të reflektohet zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë që nga viti 1957 kur u miratua Konventa, gjë që duket qartë që në numrin e shumtë dhe strukturën e neneve të saj, gjuhën

⁹ Shënim: më tej do të përdoret vetëm termi “Konventë”

më të sofistikuar të përdorur, si dhe zgjerimin apo përfshirjen e nocioneve të reja juridike dhe mjeteve të reja të marrjes së provave nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare.

Që në nenin 1 të Konventës përcaktohet kuptimi i ndihmës së ndërsjellë juridike, që është ndryshuar me protokollin e dytë shtesë të saj (neni 1), në të cilin ndër të tjera parashikohet, se:

Palët i japin njëra-tjetrës, sipas dispozitave të kësaj Konvente, ndihmë të ndërsjellë gjyqësore maksimale në mënyrë të menjëhershme në lidhje me veprat penale, dënimi i të cilave, në kohën e paraqitjes së kërkesës për ndihmë, është brenda juridiksionit të autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuuese.

Ndihma e ndërsjellë gjyqësore mund të jepet edhe në procedimet e nisura nga autoritetet administrative në lidhje me aktet e dënueshme si shkelje ligjore, sipas të drejtës kombëtare të Palës kërkuuese ose të kërkuar, vendimi për të cilat mund të çojë në një procedim penal përpara një gjykate me juridiksion të posaçëm për çështjet penale.

Vërehet se, protokollin e dytë shtesë i Konventës, jo vetëm ka riformuluar paragrafin e parë të këtij neni në lidhje me kuptimin e ndihmës së ndërsjellë juridike, por në paragrafin e dytë e ka shtrirë fushën e veprimit të tyre edhe tek procedimet e nisura nga autoritetet administrative.

Në nenin 2 të Konventës parashikohen rastet, se kur mund të refuzohet ndihma juridike. Paragrafi i parë i nenit 2 të Konventës është ndryshuar me nenin 1 të protokollit të parë shtesë të saj duke i kufizuar rastet e refuzimit të ndihmës juridike vetëm për kërkesat që lidhen me një krim, i cili për palën e kërkuar konsiderohet një krim fiskal. Ndërkohë, në paragrafin e dytë të nenit 2 të Konventës parashikohet, se ndihma juridike mund të refuzohet në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës

mund të sjellë paragjykim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit të saj.

Nga përmbatja e Konventës rezulton, se letërporositë ndërkombëtare janë një nga format e ndihmës së ndërsjellë juridike në procesin penal, për të cilat parashikohen përcaktime në nenin 3 e në vijim të saj. Në kuptim të këtyre neneve, në një letërporosi përfshihen dy palë, ajo kërkuese dhe ajo së cilës i është drejtuar kërkesa, që mund të quhet ndryshe ekzekutuese e letërporosisë. Pala ekzekutuese e letërporosisë ekzekuton letërporositë që lidhen me një procedim penal të palës kërkuese, i cili kryhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të ekzekutuesit të letërporosisë (neni 3). Në lidhje me dispozitat e Konventës të përmendura deri më tani, GjK e RSh-së, në vendimin e saj nr.23 datë 23.07.2009 ka argumentuar:

7. Neni 1 i Konventës sqaron qëllimin dhe objektin e saj. Kështu, Palët angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet, dënimi i të cilave është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese. Lidhur me letërporositë, Neni 3 (1) i Konventës shprehet se Pala së cilës i drejtohet kërkesa do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal, që i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt plotësimin e akteve hetimore ose kalimin e provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve.

Sipas Konventës, letërporositë kërkohen në lidhje me këto forma të bashkëpunimit:

- a) Njoftimin e akteve hetimore të procedimit penal në shtetin kërkues (neni 3/1);

b) Njoftimi i akteve të thirrjes së një shtetasi apo dëshmitari (neni 3/1). Neni 8 i

Konventës parashikon paprekshmërinë e personit të thirrur për t'u pyetur, sipas të cilit:

Dëshmitari apo eksperti që nuk do të respektojë paraqitjen në gjyq sipas një letërthirrjeje, e cila i është dërguar, nuk mund të vihet nën ndonjë masë shtrënguese apo sanksion edhe në qoftë se fletëthirrja përmban urdhrat, vetëm në qoftë se ai do të hyjë vullnetarisht në territorin e palës kërkuese dhe ai do të njoftohet sërish në mënyrë të rregullt.

c) Kalimin e provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve

ose të dokumentave (neni 3/1), të cilët duhet të jenë origjinalë brenda kufijve të mundshëm (neni 3/3). Objektet, origjinalet e fashikujve dhe të dokumentave, që janë dhënë gjatë komunikimit në ekzekutimin e një leterporosie, i kthehen nga pala kërkuese, përveçse kur kjo e fundit heq dorë (neni 6/2). Pala ekzekutuese mund të shtyjë dorëzimin e objekteve, fashikujve ose të akteve për të cilat është kërkuar komunikimi, kurdoherë që këta të jenë të nevojshëm për një procedim penal në proces (neni 6/1);

d) Pranimin e masave paraprake të ndërmarra gjatë procesit të hetimit nga pala kërkuese (neni 7/1)

e) Pyetjen e dëshmitarëve apo ekspertëve, nëse një gjë të tillë e lejon ligji i palës ekzekutuese (neni 3/2);

f) Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar/arrestuar, me qëllim pyetjen e tyre (neni 11);

g) Pyetja e personave që i nënshtrohen një procesi penal (neni 7/1).

Sipas nenit 3 të protokollit të parë shtesë është përcaktuar, se Konventa zbatohet edhe për dorezimin e dokumentave në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, marrjen e një gjobe ose pagesën e shpenzimeve të procesit gjyqësor.

Sipas protokollit të dytë shtesë të Konventës, është zgjeruar fusha e bashkëpunimit midis shteteve edhe në këto forma:

- a) Shërbimi me postë (neni 16), sipas të cilit, autoritetet gjyqësore të ndonjë pale mund t'u dërgojnë direkt me postë, dokumenta procedurale dhe vendime gjyqësore, personave të cilët janë në territorin e ndonjë pale tjetër, me kusht që ato të shoqërohen nga një raport, i cili të përcaktojë se personi të cilit i janë dërguar aktet mund të marrë informacion nga autoriteti i identifikuar në raport për të drejtat e tij/të saj dhe detyrimet lidhur me shërbimin e dokumentave.
- b) Dëgjimet e dëshmimeve të dëshmitarëve apo ekspertëve me video – konferencë (neni 9). Këto veprime kryhen në rastet kur është e pamundur që të shkojë personi i thirrur për të dëshmuar në një çështje gjyqësore në territorin e palës kërkuese, kur ky territor është jashtë territorit të vendbanimit të tij. Dispozitat e nenit 9 parashikojnë në mënyrë të detajuar mënyrat e paraqitjes së kërkesës, kushtet dhe procedurat për ekzekutimin e letërporosisë në këto raste. Kjo mënyrë e marrjes së provave zhvillohet me marrëveshje midis palëve dhe me kusht që ato nuk bien ndesh me parimet e ligjit të saj. Është kusht që ato të kryhen me infrastrukturën e duhur teknike të siguruar nga ekzekutuesi ose kërkuesi. Këto veprime kryhen me

praninë e autoritetit gjyqësor të palës që ka paraqitur kërkesën, i cili do të jetë përgjegjës për identifikimin e personit dhe respektimin e parimeve të përgjithshme të legjislacionit të palës kërkuese. Ofrohet edhe ndihma e një përkthyesi dhe mbrojtja e personit kur është e nevojshme. Personi që duhet të dëshmojë mund të ushtrojë të drejtën e tij për të mos dëshmuar, e cila i lind atij ose asaj sipas ligjit të palës që i është paraqitur kërkesa ose të palës kërkuese. Në rastet kur dëshmitarët ose ekspertët që merren në pyetje brenda territorit të tyre, nën detyrimin për të dëshmuar në përputhje sipas dispozitave të këtij protokollit, refuzojnë të dëshmojnë ose nuk dëshmojnë të vërtetën, do të zbatohet legjislacioni i tyre kombëtar në të njëjtën mënyrë, sikundër do të ndodhte nëse marrja në pyetje të bëhej sipas procedurave kombëtare.

- c) Zhvillimin e seancave gjyqësore me video – konferencë (neni 9), me marrëveshje midis palëve, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar. Në këto seanca, mund të bëhet dëgjimi i personit të akuzuar apo të dyshuar, gjë që zhvillohet me miratimin e tij ose të saj.
- d) Seancat e dëgjimit të dëshmitarëve apo ekspertëve me anë të konferencave telefonike (neni 10), me kusht që ato nuk bien ndesh me parimet e ligjit të saj. Këto veprime mund të kryhen me marrëveshje midis palëve dhe vetëm në rast se dëshmitari apo eksperti bie dakord për zhvillimin e seancës dëgjimore me këtë metodë. Dispozitat e nenit 9 parashikojnë në mënyrë të detajuar mënyrat e

paraqitjes së kërkesës, kushtet dhe procedurat për ekzekutimin e letërporosisë në këto raste.

- e) Informacioni spontan (neni 11), që konsiston në faktin që njëra palë pa nevojën e një kërkesë paraprake, të nisë për autoritetet kompetente të palës tjetër informacione të tjera të përfituara brenda kuadrit të hetimeve të kryera nga ana e tyre, kur ata vlerësojnë që zbardhja e informacionit mund të ndihmojë palën marrëse. Neni 11 i protokollit vendos kushtet për përdorimin e informacioneve të tilla nga palët.
- f) Kthimin e sendeve të marrë në mënyra të paligjshme për t'ia kthyer pronarëve të ligjshëm (neni 12).
- g) Mbikqyrjet ndërkufitare (neni 17), të cilat, në kuadrin e një hetimi penal, oficerët e policisë të njëres nga palët që mbikqyrin në vendin e tyre një person që presumohet të ketë marrë pjesë në një vepër penale, ndaj të cilës mund të zbatohet ekstradimi, ose një person ndaj të cilit ka arsye të forta për të besuar se do të çojë në identifikimin ose vendndodhjen e personit të sipërpërmendur. Oficerët e policisë të autorizohen të vazhdojnë mbikëqyrjen e tyre në territorin e palës tjetër, kur kjo e fundit ka autorizuar mbikëqyrjen ndërkufitare në përgjigje të një kërkesë për ndihmë juridike, e cila është dorëzuar më parë. Mbikqyrja bëhet pasi është marrë autorizimi nga organet kompetente të palës ku do të vazhdojë mbikqyrja ose në raste urgjence pa këtë autorizim. Neni 17 i protokollit parashikon specifikisht

rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen në këto raste dhe është kusht që të respektohen kërkesat e legjislacionit përkatës të palës në territorin e të cilës do të bëhet mbikqyrja. Gjatë mbikqyrjeve janë të ndaluara hyrja në shtëpi private dhe vende të pacaktuara për publikun, si dhe ndalimi, marrja në pyetje dhe arrestimi i personit nën mbikëqyrje. Mbikqyrjet ndërkufitare mund të bëhen vetëm për një grup veprash penale të përcaktuara në protokoll: vrasje e një personaliteti publik, vrasje, përdhunim, djegie prone, falsifikim, vjedhje me armë, pranim i mallrave të vjedhura, kërcënim për të marrë paratë, rrëmbim dhe marrje peng, trafikim njerëzish, trafikim i paligjshëm i narkotikëve dhe substancave psikotrope, përdorim eksplozivësh, mbartja e paligjshme e mbetjeve toksike dhe të rrezikshme, trafikim i të huajve, si dhe abuzim seksual i fëmijëve.

- h) Hetimet sekrete (neni 19), për të cilat palët mund të bien dakort të asistojnë njëra-tjetrën në kryerjen e hetimeve të krimeve me anë të policëve që veprojnë me identitet të fshehur, pas dhënies së autorizimit nga organi përkatës në territorin ku do të kryhet hetimi. Në marrëveshje parashikohen kohëzgjatja, kushtet e detajuara dhe statusi ligjor i policëve të përfshirë, duke mbajtur parasysh edhe të drejtën procedurale kombëtare.

Sipas nenit 4 të Konventës, me kërkesën e kërkuesit të letërporosisë, pala ekzekutuese duhet të njoftojë për datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë, proces gjatë të cilit ajo mund të lejojë ndihmën nga autoritetet dhe personat në çështjen e palës kërkuese. Në

këto raste, çdo palë tjetër mund të aplikojë parimin e reciprocitetit, pra të respektojë përmbushjen e këtyre kushteve. Me protokollin e dytë shtesë të Konventës ky nocion është çuar më tej, duke parashikuar, se:

Kërkesa për praninë e përfaqësuesve të palës kërkuese ose personave të interesuar nuk duhet të refuzohet në ato raste kur kjo prani ka të ngjarë ta bëjë zbatimin e kërkesës për ndihmë gjyqësore më të përgjegjshme ndaj nevojave të palës kërkuese dhe si pasojë shmanget nevojën për kërkesa shtesë për ndihmë gjyqësore.

Neni 7 i Konventës parashikon kushtet dhe kriteret e njoftimit të akteve procedurale, sipas të cilave pala ekzekutuese e letërporosisë procedon me pranimin e akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, të cilat i janë dërguar për këtë qëllim nga pala kërkuese. Ky pranim realizohet nëpërmjet një transferimi të thjeshtë të aktit dhe të masës paraprake marrësit. Kurdoherë që pala ekzekutuese kërkon shprehimisht, pranimi realizohet në njërën nga format që legjislacioni i palës së cilës i drejtohet kërkesa parashikon për njoftime të së njëjtës natyrë ose në një formë të veçantë që të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës (neni 7/1). Prova e pranimit bëhet nëpërmjet një dëftese në të cilën është vendosur data dhe është firmosur nga personi që njoftohet ose nëpërmjet një deklarate të palës së cilës i drejtohet kërkesa që përcakton faktin, mënyrat dhe datën e pranimit. Këto dokumenta i kthehen menjëherë me transferim kërkuesit, duke saktësuar faktin nëse pranimi i aktit është bërë sipas ligjit të ekzekutuesit. Nëse pranimi nuk është bërë i mundur, pala ekzekutuese duhet t'i bëjë menjëherë të ditur kërkuesit motivin e mospranimit (neni 7/2). Kërkesa për motivim shtrihet edhe për rastet e refuzimit për të dhënë ndihmë juridike, gjë që parashikohet në nenin 19 të Konventës.

Në nenet 9 – 12 të Konventës parashikohen kushte dhe kritere specifike për thirrjen e dëshmitarëve apo ekspertëve para organeve procedues të shteteve kërkuese edhe kur ata janë të arrestuar. Për këta të fundit janë parashikuar edhe kushte më specifike për transferimin e tyre në shtetin kërkues. Vlen për t'u theksuar këtu parimi i paprekshmërisë së personit të thirrur si dëshmitar apo ekspert përpara autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese i parashikuar në nenin 12 të Konventës, i cili nuk mund të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje arresti ose t'i nënshtrohet ndonjë mase tjetër shtrënguese për lirinë e tij individuale brenda territorit të palës së cilës i është drejtuar kërkesa, për:

- a) Fakte apo dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i palës kërkuese;
- b) Fakte dhe dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe që nuk përfshihen në letërthirrje.

Ky imunitet pushon së funksionuari, atëhere kur:

Dëshmitari, eksperti apo individ i cili i është nënshtuar një procedimi penal, duke patur mundësinë e lënies së territorit të palës kërkuese për 15 ditët pasuese, pasi paraqitja e tij nuk është më e kërkuar nga autoritetet gjyqësore, edhe në qoftë se ka ngelur në këtë territor ose ka bërë kthimin pasi është lëshuar.

Neni 15 i Konventës, i cili është ndryshuar me protokollin e dytë shtesë të saj (neni 4), përcakton si autoritet që drejton dhe të cilit i drejtohet letërkërkesa Ministrinë e Drejtësisë (neni 15/1). Në paragrafët 3 – 7 të nenit 15 të Konventës parashikohen rastet kur kërkesat për ndihmë të ndërsjellë mund të përcillen drejtpërdrejt në organet përkatës të autoriteteve të huaja, në mënyrë të përmbledhur më konkretisht:

- a) Procedimet e nisura nga organet administrative, që përbëjnë vepër penale;

- b) Dorëzimet e kontrolluara dhe hetimet sekrete;
- c) Nëse ka një marrëveshje midis autoriteteve kompetente të palëve në fjalë, në rastet e transferimit të përkohshëm të personave të ndaluar për të kryer një betim;
- d) Kërkesat për kopjet e dënimeve dhe të masave të tjera;
- e) Në raste urgjente, kur transmetimi direkt lejohet përmes kësaj Konvente, mund të kryhet nëpërmjet organizatës ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

Kjo dispozitë parashikon kriteret dhe procedurat e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë ligjore, përfshirë këtu edhe letërporositë ndërkombëtare. Risi e protokollit të dytë shtesë të Konventës është fakti, se kërkesat për ndihmë të ndërsjellë dhe çdo komunikim tjetër, bazuar në këtë Konventë ose Protokollin e saj, mund të nisen përmes rrugës elektronike ose formave të tjera të telekomunikimit (neni 4/9).

Sipas nenit 15/10 të Konventës, dispozitat e këtij neni nuk paragjykojnë marrëveshjet ose rregullimet bilaterale në fuqi midis Palëve, të cilat parashikojnë transmetimin direkt të kërkesave për ndihmë juridike midis autoriteteve të tyre respektive. Në lidhje me nenin 15 të Konventës, GjK e RSh-së me vendimin e saj nr. 23, datë 23.07.2009 është shprehur, se:

Neni 15 (1) parashikon se, Letërporositë, për të cilat nenet 3, 4 dhe 5, si edhe kërkesat e parashikuara në nenin 11, do të drejtohen nga MD e palës kërkuese tek MD e Palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe do të kthehen nëpërmjet të njëjtës rrugë. Në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese tek autoritetet gjyqësore të palës së cilës i drejtohet kërkesa. Lidhur me nenin 15 të Konventës, Shqipëria ka deklaruar (neni 2 i ligjit nr.8498, datë 10.06.1999, i ndryshuar) se: "... pala shqiptare deklaron se në zbatim të nenit 15, pika 6 duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuar drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t'i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë".

Në nenin 16 të Konventës janë parashikuar rregullat për përkthimin e kërkesave dhe akteve bashkëlidhur tyre, dispozitë kjo që është plotësuar edhe me nenin 15 të Protokollit të dytë shtesë të Konventës.

Sipas nenit 18 të Konventës, në qoftë se autoritetet e investuara, me një kërkesë për ndihmë juridike janë inkompetente për ta ndjekur atë, ata mund t’ia transferojnë zyrtarisht atë autoritetit kompetent të vendit përkatës, duke njoftuar për këtë edhe palën kërkuese.

Në nenin 24 të Konventës, i ndryshuar me nenin 6 të protokollit të dytë shtesë të saj janë përcaktuar autoritetet gjyqësore, sipas të cilit parashikohet, se çdo palë do të përkufizojë se cilët autoritete do të konsiderojë si autoritete gjyqësore për qëllimet e kësaj Konvente, gjë që mund të ndryshohet në çdo kohë.

Sipas nenit 25/5 të Konventës, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, fusha e zbatimit të kësaj konvente mund edhe të shtrihet, sipas kushteve që do të nënshkruhen në këtë marrëveshje, në territorin e njërës palë që nuk është nënshkruese e kësaj konvente apo nuk përfshihet në parashikimet e nenit 25 të Konventës.

Konventa në nenin 26/2 të saj përcakton, se nuk do të paragjykojë detyrimet që përmbahen në ndonjë konventë tjetër ndërkombëtare dy apo shumëpalëshe, të cilat përfshijnë rregullime në lidhje me fusha të caktuara të ndihmës juridike. Megjithatë, sipas nenit 26/3 të Konventës, palët kontraktuese nuk mund të përfundojnë ndërmjet tyre marrëveshje dy apo shumëpalëshe lidhur me ndihmën juridike, përveçse për të kompletuar dispozitat e kësaj konvente, ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në të.

Në protokollin e dytë shtesë të Konventës është parashikuar përgjegjësia penale dhe civile e zyrtarëve të palëve të përfshira në ndihmën e ndërsjellë juridike (nenet 21 – 22).

4.2. Krahësim i trajtimit juridik të letërporosive ndërkombëtare nga e drejta shqiptare me trajtimin e tyre në aktet ndërkombëtare

Sipas nenit 28 të Konventës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të aderojë në këtë Konventë me një vendim të marrë në mënyrë unanime nga anëtarët e Këshillit që kanë ratifikuar Konventën. Ky përcaktim i ka dhënë mundësinë Shqipërisë që pa qënë anëtare e KE-së të ratifikojë këtë konventë dhe protokollin e saj shtesë me ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999 (i ndryshuar), e më pas protokollin e dytë shtesë me ligjin nr.8883, datë 18.04.2002.

Siç u trajtua edhe në kapitullin e dytë mbi kontekstin historik të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, ratifikimi i kësaj Konvente është bërë i mundur nga Shqipëria vetëm pas ndryshimeve demokratike të saj në fillim të viteve '90. Konventa është ratifikuar nga Shqipëria me disa rezerva, në zbatim të nenit 23/1 të Konventës dhe lejimeve që përcaktohen në dispozitat përkatëse, për të cilat është paraqitur rezervë. Këto rezerva mund të revokohen sipas nenit 23/2 të Konventës dhe në bazë në nenit 23/3 të saj, Shqipëria nuk mund të pretendojë që pala tjetër më të cilën realizohet ndihmë e ndërsjellë juridike të aplikojë në të njëjtën masë dispozitat, për të cilat ka formuluar një rezervë. Në lidhje me këto fakte, GjK e RSh-së në vendimin e saj nr. 23, datë 23.07.2009 është shprehur, se:

6. Kërkuesi pretendon, se Konventa për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale nuk është e zbatueshme ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. GjK vëren, se rezerva që Shqipëria i ka bërë kësaj Konvente parashikon: "...Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale... b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë apo në një territor tjetër". Bazuar në të drejtën ndërkombëtare të traktateve, nëse një shtet i bën rezervë një traktati ndërkombëtar atëherë, në bazë të parimit të reciprocitetit, të gjitha shtetet palë mund të zgjedhin të mos e respektojnë këtë detyrim specifik të përmbajtur në rezervë, që do të thotë, se teksti i traktatit modifikohet sipas rezervës së parashikimeve të nenit 21 të Konventës së Vienës për të Drejtën e Traktateve. Gjykata vëren se, siç shihet edhe nga teksti i rezervës, parashikimi lidhet me refuzimin e ndihmës nga Shqipëria. Në rastin konkret, është Shqipëria shteti që ka kërkuar ndihmë juridike dhe jo e anasjellta. Nga ky formulim kuptohet qartë se autoritetet shqiptare nuk do ta zbatonin Konventën, nëse çështja për të cilën kërkohet ndihma e ndërsjellë juridike është në proces hetimi në Shqipëri dhe, për arsye të hetimeve, Shqipëria vendos të mos i transferojë/kalojë provat e mbledhura prej saj në këtë fazë. Italia, referuar korrespondencës zyrtare, nuk i referohet në asnjë vend faktit që çështja është në hetim në Itali, përkundrazi, jep pëlqimin e saj për dhënien e ndihmës juridike për çështjen në ngarkim të kërkuesit. Për rrjedhojë, Konventa, në çështjen objekt shqyrtimi, është ligj i zbatueshëm ndërmjet palëve për ndihmën e ndërsjellë juridike.

Letërporositë ndërkombëtare parashikohen në KPP të RSh-së, parashikime që janë në përputhje me parimet kryesore të Konventës, siç do të trajtohet më poshtë në studim. Pas ratifikimit të protokollit të dytë shtesë të Konventës në vitin 2001, pikërisht edhe për shkak të risive të shumta që sillte ky protokoll, lindi i nevojshëm plotësimi i legjislacionit penal shqiptar me qëllim edhe përafrimin e tij me aktet ndërkombëtare. Kështu, në datë 03.12.2009 është miratuar ligji nr.10193 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" (i ndryshuar) (Fletore zyrtare nr. 181, 2009:8080), i cili kishte për objekt përcaktimin e rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale. Ky ligj ka bërë plotësimet e nevojshme dhe ka evituar mjaft paqartësi të KPP-së.

Në këtë këndvështrim është e vlefshme të analizohet, se sa ka gjetur pasqyrim në legjislacionin e brendshëm të RSh-së trajtimi juridik i letërporosive ndërkombëtare nga

Konventa e KE-së *“Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”* në vitin 1999 dhe dy protokolleve shtesë të saj.

Neni 1 i Konventës gjen shprehi në nenin 3 të ligjit nr.10193, në të cilin parashikohet fusha e zbatimit të tij, ku përcaktohet, se dispozitat e këtij ligji zbatohen ndër të tjera, në procedimet që lidhen me veprat penale, të cilat në çastin e paraqitjes së kërkesës, janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues ose të RSh-së. Krahas rasteve të procedimeve penale të parashikuara nga neni 3 i këtij ligji, ekzekutohen letërporositë e autoriteteve gjyqësore të huaja në procedimet administrative, nëse vendimi i dhënë në përfundim të tyre mund të ankimohet në një gjykatë me juridiksion penal, deri në masën që parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për RSh.

Në përputhje me nenin 2/b të Konventës, në KPP të RSh-së parashikohet, se MD vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit (neni 505/1 i KPP-së). Në të njëjtën kohë, MD nuk vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së drejtuar një autoriteti të huaj, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sigurimin ose interesa të tjera të rëndësishme të shtetit. Në këtë rast Ministria urdhëron, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e letërporosisë, që kësaj të mos i jepet rrugë (neni 509/2 i KPP-së). Po kështu, në nenin 505/2, 3, 4 të KPP-së përcaktohen rastet, se kur MD nuk i jep rrugë letërporosisë, më konkretisht:

- a) Kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar;
- b) Kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit;
- c) Kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë;
- d) kur shteti kërkuar nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur, në rastet kur letërporosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj;
- e) Kur shteti kërkuar nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit.

Ligji 10193 në nenin 6/1 të tij parashikon edhe rastin e kthimit të letërkërkesave për plotësimin e të metave, kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara për përmbajtjen e letërporosisë sipas nenit 5 të po këtij ligji.

Në përputhje me përcaktimet e nenit 3 e në vijim të Konventës në lidhje me letërporositë, në KPP, letërporositë ndërkombëtare parashikohen në nenet 505 – 511 të tij. Në KPP nuk jepet ndonjë përkufizim në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike apo letërporositë ndërkombëtare si formë e saj. Por nga neni 505/1 i KPP-së, ku përcaktohen kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me letërporositë ndërkombëtare, përcaktohet që letërporositë e autoritetit të huaj lidhen me komunikimet, njoftimet dhe marrjen e provave, ku bëjnë pjesë edhe pyetja e dëshmitarëve apo ekspertëve që parashikohet në nenin 3/2 të

Konventës. Ndërkohë, në nenin 2 të ligjit 10193, në përputhje me Konventën, midis të tjerash jepen këto përkufizime:

- a) "Autoritete gjyqësore të huaja" janë autoritetet e huaja, që, sipas ligjit të huaj përkatës, u është dhënë cilësia për të kërkuar, dhënë ose përcjellë kërkesa që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.
- b) "Autoritete gjyqësore vendase" janë autoritetet e përcaktuara nga ligji nr. 8498, datë 10.6.1999 "Për ratifikimin e konventës evropiane "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" (i ndryshuar).
- c) "Letërkërkesë" është forma me të cilën paraqiten kërkesat që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.
- d) "MD" është Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.
- e) "Shtet i kërkuar" është shteti, të cilit i drejtohet një letërkërkesë.
- f) "Shtet kërkuar" është shteti, autoriteti kompetent gjyqësor i të cilit paraqet kërkesa që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

Më tej në nenin 4/a të ligjit 10193 parashikohen si një nga llojet e letërkërkesave "letërporositë", ku përfshihen njoftimet e akteve, si dhe marrja e akteve të tjera dhe provave të procedimit penal. Vlen të theksohet këtu, që si në KPP, ashtu edhe në ligjin 10193, koncepti i marrjes së provave është lënë i papërcaktuar, duke i lënë hapësirë kështu mundësisë së marrjes së provave të tjera, por gjithnjë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni penal shqiptar. Vlen të theksohet këtu fakti, që provat e marra nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare duhet të merren në përputhje me ligjin, në mënyrë që ato të jenë të vlefshme dhe të përdorshme në proceset penale të autoriteteve të huaja.

Sipas nenit 5 të Konventës, palët kontraktuese mund të rezervojnë mundësinë që në letërporositë që ekzekutohen prej tyre të përmbushin një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

- a) Krimi për të cilin është kërkuar letërporosi, të jetë i dënueshëm sipas ligjit të palës kërkuuese dhe të palës ekzekutuese;
- b) Krimi për të cilin është kërkuar letërporosi duhet të jetë i tillë që të lejojë ekstradimin në vendin ku drejtohet kërkesa;
- c) Ekzekutimi i letërporosive duhet të jetë në përputhje me ligjin e palës së cilës i drejtohet kërkesa.

Për sa i përket Shqipërisë, me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 (i ndryshuar) që ratifikoi këtë Konventë, pala shqiptare ka rezervuar të drejtën që në letërporositë që ekzekutohen prej saj të përmbushen vetëm dy nga këto kushte, duke u shprehur konkretisht: *Sekuestrimi, konfiskimi i sendeve dhe ekzekutimi i kërkesave të tilla do të bëhen vetëm në kushtet e parashikuara në nenin 5 pika 1 shkronja “a” dhe “c” të kësaj Konvente.* Këto kushte gjejnë pasqyrim edhe në nenin 506/4 të KPP-së, ku parashikohet se ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet kur janë rastet që MD nuk i jep rrugë letërporosisë, si dhe kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale. Në lidhje me verifikimin e këtyre kërkesave lidhet edhe neni 5 i ligjit 10193, në dispozitën e të cilit përcaktohet, se në letërkërkesë domosdoshmërisht duhet të pasyrohen, midis të tjerash, baza ligjore për letërkërkesën, një përshkrim të procedimit penal që është duke u zhvilluar, një përshkrim të faktit penal, duke treguar kohën dhe vendin e tij, emërtimin ligjor të veprës penale, si dhe kopje të tekstit të dispozitave ligjore të brendshme të zbatuara.

Në përmbushje të kërkesave të nenit 7 të Konventës, KPP parashikon procedurat e ekzekutimit të një letërporosie në nenet 506 – 507 të tij. Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet (neni 506/1). Për këtë, prokurori përkatës pasi merr aktet nga MD, paraqet kërkesën në gjykatë (neni 506/2), e cila disponon me vendim për ekzekutimin ose jo të letërporosisë (neni 506/3). Në rastet e pranimi për ekzekutim të letërporosisë, gjykata në vendimin e saj cakton trupin gjykues që do të ekzekutojë letërporosinë (neni 507/1). Për kryerjen e veprimeve të kërkuara në letërporosinë që ekzekutohet, zbatohen normat e KPP-së të RSh-së, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar (neni 507/2).

Nga kjo përjasje e nenit 7 të Konventës me nenet përkatës të KPP-së, këto të fundit parashikojnë kryesisht kushtet e përcaktuara në nenin 7 të Konventës. Këto dispozita plotësohen edhe nga parashikimet e ligjit 10193, më konkretisht:

- neni 5, në të cilin përcaktohen rregullat e përgjithshme mbi letërkërkesën, në lidhje me formën e shkruar të saj, të dhënat dhe informacionet që duhet të përmbajë ajo, të cilat vlejnë edhe për letërporositë;
- nenet 6 dhe 7, që përcaktojnë procedurat e dërgimit të një letërkërkese, të cilave u nënshtrohet edhe letërporosia;
- neni 14, i cili përcakton veprimet që duhet të ndiqen pas dhënies rrugë të një

letërporosie nga MD, konkretisht:

1. MD, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporosia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve.
2. Në raste urgjente, MD mund t'ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i rrethit paraqet kërkesën në gjykatë për të disponuar ekzekutimin e letërporosisë me vendim, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

Megjithatë, edhe në këtë procedurë të përcaktuar nga neni 14 i ligjit 10193, ligjvënësi ka shprehur përjashtimin, që ky rregull të mos zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Edhe një herë ky përjashtim konfirmon respektimin e parimit të së drejtës ndërkombëtare të ekzistencës së vullnetit të mirë nga ana e shtetit shqiptar në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë efektive nëpërmjet letërporosive, me qëllim marrjen e provave për një procedim penal, që në fund të fundit i shërben luftës efektive ndaj krimit. Megjithatë, ky përjashtim i nënshtrohet kushtit të mos-qenit në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të RSh-së, sipas nenit 17 të ligjit 10193, gjë që në të vetvete përbën shprehje e sovranitetit të shtetit shqiptar.

Neni 9 i ligjit 10193 parashikon parimin e reciprocitetit midis palëve, në përputhje me parashikimin e tij në nenin 4 të Konventës. Megjithatë, sipas neni 9/2 ligjit 10193, MD mund t'i japë rrugë letërporosive edhe në mungesë të garancive të shprehura për reciprocitet. Ky parashikim është shprehje e tolerancës dhe vullnetit të mirë të shtetit shqiptar për të pasur një bashkëpunim sa më të frytshëm me autoritetet e huaja në fushën e penale.

Në nenin 509 të KPP-së, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15 të Konventës, parashikohen procedurat e dërgimit të letërporosive, sipas të cilit përcaktohet, se letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato (neni 509/1). Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar Ministrin e Drejtësisë (neni 509/4). Ky rast parashikohet edhe në ligjin 10193, në nenet 6 dhe 15, me përjashtim të rasteve të transferimit të personave të ndaluar/arrestuar me qëllim pyetjen e tyre. Lidhur me këtë të drejtë, me ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999 (i ndryshuar) të ratifikimit të Konventës, pala shqiptare ka deklaruar se në zbatim të nenit 15 pika 6 të Konventës, duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuara drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t'i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë.

Në zbatim të mundësisë së paraqitjes së rezervave në lidhje me përkthimin e këtyre akteve sipas nenit 16/2 të Konventës, sipas ligjit nr.9539 datë 22.05.2006 që ka ndryshuar ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 të ratifikimit të Konventës, Shqipëria ka deklaruar, se kërkesa për ndihmë të ndërsjellë dhe dokumentet që u bashkëngjiten, shoqërohen me përkthimin autentik zyrtar në gjuhën shqipe dhe, kur nuk është e mundur, në gjuhën angleze. Gjithashtu, Republika e Shqipërisë, për dokumente më të gjata, si dhe në rastin kur marrësi është shtetas shqiptar ose kur vendbanimi i tij/saj është në Shqipëri, ka rezervuar të drejtën për të kërkuar një përkthim autentik zyrtar në gjuhën shqipe, e përcaktuar kjo

rast pas rasti. Rregulla më të detajuara për përkthimin e letërporosive dhe akteve të tyre përcaktohen në nenin 5 të ligjit 10193.

Sipas nenit 24 të Konventës, secila nga palët kontraktuese, duhet të tregojë se cilin autoritet ajo konsideron si autoritet gjyqësor për efekte të kësaj konvente. Lidhur me këtë detyrim, sipas ligjit nr.9539 datë 22.05.2006 (Fletore zyrtare nr. 57, 2006:1627), që ka ndryshuar ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999 të ratifikimit të Konventës, Shqipëria ka deklaruar, se autoritetet gjyqësore, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, janë Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë. Lidhur me këtë, në nenin 7 të ligjit 10193 përcakton autoritetet kompetente për ekzekutimin e letërporosisë, të cilët veprojnë në këtë mënyrë:

1. MD i jep rrugë letërkërkesës së huaj pasi vlerëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm. Në vijim, letërkërkesa i përcillet prokurorit të rrethit ku duhet ekzekutuar letërkërkesa, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Nëse autoriteti gjyqësor vendas ka kompetencë për ekzekutimin e një prej disa veprimeve të kërkuara, atëherë ai mund të procedojë me ekzekutimin e të gjitha veprimeve, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme.
3. Kur autoriteti gjyqësor vendas, që merr një letërkërkesë, nuk ka kompetencë për ekzekutimin e saj, ai ia përcjell kërkesën pa vonesë autoritetit gjyqësor vendas kompetent dhe njofton njëkohësisht MD.

Neni 8 i ligjit 10193 përcakton refuzimin e letërkërkesës dhe në paragrafin 4 të tij parashikohet, se vendimi i refuzimit të një letërkërkese përmban arsyet e refuzimit dhe bazën ligjore, gjë që është plotësisht në përputhje me nenin 19 të Konventës.

Në këndvështrim të nenit 3 të Konventës mbi format e bashkëpunimit që mund të kërkohen nëpërmjet letërporosive, KPP nuk ka një përcaktim të veçantë në lidhje me to, por në nenin 505 të tij, ku përcaktohen kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë nënkuptohen edhe format e këtij bashkëpunimi, konkretisht: njoftimet, komunikimet dhe marrja e provave.

Ligji 10193 jep përcaktime më të sakta për këto forma bashkëpunimi në përputhje me parashikimet e Konventës dhe dy protokolleve të saj shtesë, të cilat trajtohen në vijim.

Një nga format më të zakonshme të bashkëpunimit nëpërmjet letërporosive lidhet me njoftimin e akteve të procedimit penal të shtetit kërkues, që parashikohet në nenin 3/1 të Konventës. Ky lloj bashkëpunimi është parashikuar në nenin 508 të KPP-së dhe nenin 13 të ligjit 10193.

Neni 508 i KPP-së përcakton, se nëpërmjet letërporosive mund të kërkohet thirrja e dëshmitarëve që kanë vendqëndrimin ose vendbanimin në territorin e shtetit shqiptar për t'u paraqitur në autoritetin gjyqësor të huaj (neni 508). Kërkesa i dërgohet prokurorit të rrethit përkatës, i cili merr masa për njoftimin duke vepruar si në rastin e njoftimit të të pandehurit në gjendje të lirë, bazuar në nenet 140 – 141 të KPP-së. Kjo gjë konfirmohet edhe në nenin 18 të ligjit 10193. Në këto dispozita gjen shprehje neni 8 i Konventës në lidhje me paprekshmërinë e personit të thirrur për t'u pyetur. Kjo për arsye se rregullat për njoftimin sipas neneve 140 – 141 të KPP-së nuk parashikojnë vendosje masash shtrënguese apo sanksione për personat që nuk respektojnë paraqitjen. Por, parimi i paprekshmërisë së personit të thirrur si dëshmitar apo ekspert përpara autoriteteve

gjyqësore të palës kërkuese i parashikuar më tej në nenin 12 të Konventës gjen shprehje të plotë në nenin 510 të KPP-së mbi paprekshmërinë e personit të thirrur, i cili parashikon shprehimisht:

- 1. Personi i thirrur në bazë të letërporosisë, kur paraqitet, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë personale për fakte që kanë ndodhur para njoftimit për t'u paraqitur.*
- 2. Paprekshmëria e parashikuar në paragrafin 1 pushon kur dëshmitari, eksperti a i pandehuri, duke patur mundësi nuk është larguar nga territori i shtetit shqiptar, me kalimin e pesëmbëdhjetë ditëve nga momenti kur prania e tij nuk kërkohet më nga autoriteti gjyqësor ose kur, pasi është larguar, është kthyer vullnetarisht.*

Ky përcaktim konfirmohet edhe në nenin 19 të ligjit 10193.

Neni 13 i ligjit 10193 e zgjeron llojin e akteve që njoftohen, duke përfshirë njoftimet e aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal; e urdhërave, vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues.

Nëse KPP nuk jep përcaktime për llojet e tjera të bashkëpunimit me letërporosi, duke u shprehur vetëm për marrje të provave, ligji 10193 jep përcaktime edhe për forma të tjera të bashkëpunimit nëpërmjet letërporosive, gjithnjë në përputhje me përcaktimet e Konventës, ku përfshihen:

- a) Masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal (neni 13), që përfshin masat paraprake për ruajtjen e provave, të sendeve të konfiskueshme, të situatës ekzistuese ose mbrojtjes së interesave ligjore të rrezikuara (neni 26). Ky lloj bashkëpunimi është pjesë e pranimi të masave paraprake të ndërmarra gjatë procesit të hetimit nga pala kërkuese, që parashikohet në nenin 7/1 të Konventës.

- b) Pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive (neni 13). Këto të fundit përputhen me sa ka parashikuar protokollin i dytë shtesë i Konventës në nenet 9 dhe 10 të tij dëgjimet e dëshmive të dëshmitarëve apo ekspertëve me video – konferenca apo konferenca telefonike. Kushtet dhe procedura e kryerjes së këtyre veprimeve parashikohen në nenin 20 të ligjit 10193.
- c) Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre (neni 13), kushtet dhe procedurat për të cilin përcaktohen në nenin 21 të ligjit 10193.
- d) Kontrolli i vendeve ose sekuestrimi i sendeve të konfiskueshme që ndodhen në territorin e RSh-së në lidhje me faktet e përcaktuara në letërporosi. Por gjithnjë këto do të kryhen duke u bazuar në dispozitat përkatëse të parashikuar në KPP për formën të marrjes së provës (neni 20).
- e) Përcjellja e të dhënave pa kërkesë (neni 27), që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 11 të protokollit të dytë shtesë të Konventës. Përcjellja e këtij informacioni bëhet nëse nuk pengohet ecuria e procedimit penal në Shqipëri dhe duke respektuar kushtet e reciprocitetit.

Në pikën e fundit të nenit 13 të ligjit 10193 parashikohet, se format e bashkëpunimit me letërporosi mund të shtrihen edhe me veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji. Ky parashikim, së bashku me parashikimet e KPP-së, që u përmendën

më lart për lënien hapur dhe të papërcaktuar marrjen e provave me letërporosi, lënë të nënkuptohet efekti lejues i legjislacionit të brendshëm penal shqiptar për ta zgjeruar fushën e bashkëpunimit edhe në marrjen e llojeve të provave të tjera, por gjithnjë në përputhje me lejimet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin procedural penal të RSh-së.

Në nenin 24 të ligjit 10193, parashikohet shtyrja e ekzekutimit të kërkesave nga autoriteti gjyqësor vendas, nëse ai mund të ndikojë në mbarëvajtjen e procedimeve penale të filluara nga autoritetet gjyqësore vendase. Kjo gjë është në përputhje me parashikimet e nenit 6/2 të Konventës.

Neni 12 i ligjit 10193 përcakton rregullat mbi konfidencialitetin, nëpërmjet ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionin e treguar në letërkërkesë.

Në nenin 17 të ligjit 10193 parashikohet, se nëse autoriteti gjyqësor i huaj kërkon në letërporosi plotësimin e kushteve të veçanta, lidhur me formën dhe procedurën, autoriteti gjyqësor vendas vepron për ekzekutimin e saj në përputhje me këto kërkesa, me kusht që kërkesat të mos jenë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të RSh-së.

Në nenin 30 të ligjit 10193, me kërkesën e autoriteteve gjyqësore vendase apo të huaja, MD merr tekstin e legjislacionit në fuqi në shtete të tjera, si edhe çdo informacion për çështje të posaçme juridike, nëse kjo është e nevojshme duke ia përcjellë autoriteteve vendase dhe anasjelltas.

Si dispozita e nenit 17 ashtu dhe ajo e nenit 30 të ligjit 10193, shprehin parimin e vullnetit të mirë të ligjvënësit shqiptar për bashkëpunimin me autoritetet e huaja në procesin penal.

Sa u përmendën më lart, paraqiten më poshtë në mënyrë tabelare.

Tabela 1 Pasqyrë e dispozitave respektive që parashikojnë përcaktime në lidhje me letërporositë ndërkombëtare penale nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm

Përcaktimet në lidhje me letërporositë ndërkombëtare penale	Konventa	Prot.1	Prot.2	KPP	Ligji 10193
Fusha e shtrirjes së veprimit të ndihmës së ndërsjellë juridike	n.1 ndrysh plotës me 1/2		n.1	505/1	n.3
Rastet e refuzimit	n.2 ndrysh 2/1	n.1 - 2		n.505/1,2,3,4	n.8
Motivimi i mospranimit	n.7/2, n.19				n.8/4
Reciprociteti	n.4				n.9
Përcaktimi i letërporosisë	n.3				n.2, 4/a
Kushtet e letërporosisë	n.5			506/4	n.5
Prania e palës kërkuese në procedurat hetimore	n.4 shtuar		n.7		
Format e bashkëpunimit	n.3			505	
Njoftimi i akteve hetimore	n.3/1			508	n.13
Thirrja e dëshmitarëve, ekspertëve për t'u pyetur	n.3/1			508	
Paprekshmëria					
Dorëzimi i dokumentave në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, marrjen e një gjobë ose pagesën e shpenzimeve të procesit gjyqësor.		n.3			
Njoftimi i akteve hetimore me postë			n.16		
Kushtet dhe kriteret e njoftimit të akteve procedurale	n.7			506-507	n.5-7, n.14
Kalimi i provave materiale, fashikujve, dokumentave	n.3/1				
Shtyrja e dorëzimit të provave materiale	n.6/2				n.24
Pranimi i masave paraprake të ndërmarra gjatë procesit të hetimit nga pala kërkuese	n.7/1				n.13, 26
Pyetja e dëshmitarëve apo ekspertëve	n.3/2				n.13

Pyetja e personave që i nënshtrohen një procesi penal	n.7/1				n.13
Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar/arrestuar, me qëllim pyetjen e tyre	n.11				n.13, 21
Kushtet dhe kriteret për thirrjen e dëshmitarëve apo ekspertëve të ndaluar/arrestuar	n.9 – 12				21
Dëgjimet e dëshmitarëve të dëshmitarëve apo ekspertëve me video – konferencë			n.9		n.13, 20
Zhvillimi i seancave gjyqësore me video – konferencë			n.9		
Seancat e dëgjimit të dëshmitarëve apo ekspertëve me anë të konferencave telefonike			n.10		n.13, 20
Informacioni spontan			n.11		n.27
Kthimin e sendeve të marrë në mënyra të paligjshme për t'ia kthyer pronarëve të ligjshëm			n.12		
Mbikqyrjet ndërkufitare			n.17		
Hetimet sekrete			n.19		
MD autoriteti nëpërmjet dhe kundrejt dërgohen letërporositë	n.15 zëvendës		n.4	509/1	
Përcjellja drejtpërdrejt në organet përkatës të autoriteteve të huaja	n.15/3 - 15/7 zëvendës		n.4/4 - 4/8	509/4	n.6, n.15
Përcjellja e letërporosive drejtpërdrejt në organet përkatës të autoriteteve të huaja përmes rrugës elektronike			n.4/9		
Mosparagjykimi i marrëveshjeve bilaterale për transmetimin direkt të kërkesave për ndihmë juridike midis autoriteteve të tyre respektive	15/10				
Transferimi në organet kompetente	n.18				
Refuzimi i motivuar	n.19				
Gjuha dhe përkthimi i akteve	n.16				n.5
Autoritetet kompetente	n.24 ndrysh		n.6		n.7
Mosparagjykimi i marrëveshjeve dypalëshe	n.26				
Përgjegjësia penale dhe civile e zyrtarëve			n.21 - 22		

Në këtë pasqyrë janë paraqitur nga njëra anë dispozitat e Konventës në lidhje me letërporositë, mënyrën se si kanë ndryshuar apo janë plotësuar ato nga dy protokollet

shtesë të saj si akte ndërkombëtare që përmbajnë parashikime në lidhje me letërporositë dhe nga ana tjetër dispozitat respektive në KPP dhe ligjin 10193, si akte që përbëjnë të drejtën e brendshme që përfshin parashikimet ligjore në lidhje me letërporosinë.

Në fund të kësaj analize përshkruese dhe krahasuese midis legjislacionit shqiptar dhe akteve ndërkombëtare, mund të thuhet që standartet e akteve ndërkombëtare plotësohen më së miri nga legjislacioni shqiptar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal.

Deri më tani u analizua se si përcaktimet e Konventës janë pasqyruar edhe në legjislacionin e brendshëm penal shqiptar. Megjithatë, në këtë legjislacion nuk parashikohen disa aspekte të bashkëpunimit të ndërsjellë shtetëror dhe ekzekutimit të letërporosive ndërkombëtare penale, që parashikohen në Konventë dhe protokollet e saj shtesë, siç janë:

1. Përcaktimi i afateve në lidhje me njoftimin e akteve për paraqitjen e një personi që procedohet nga autoriteti gjyqësor i huaj (neni 7/3 i Konventës), në të cilin parashikohet, se:

*Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, të kërkojë, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që letërthirrja për t'u paraqitur në gjyq, personit që i është nënshtruar një procedimi penal dhe që gjendet në territorin e tij duhet t'i transferohet autoriteteve kompetente brenda një afati të caktuar përpara datës së caktuar për t'u paraqitur në gjyq. Ky afat do të jetë i përcaktuar në një deklaratë të caktuar dhe nuk mund t' i kapërcejë 50 ditët.
Për caktimin e një afati të tillë do të kihet parasysh data e paraqitjes në gjyq dhe momenti i transferimit të letërthirrjes.*

2. Njoftimi drejtpërdrejtë me postë i dokumentave procedurale dhe vendimeve

gjyqësore, personave të cilët janë në territorin e ndonjë pale tjetër (neni 16 i Protokollit të dytë shtesë), sipas të cilit, autoritetet gjyqësore të ndonjë pale mund t'i dërgojnë direkt me postë, me kusht që ato të shoqërohen nga një raport, i cili të përcaktojë se personi të cilit i janë dërguar aktet mund të marrë informacion nga autoriteti i identifikuar në raport për të drejtat e tij/të saj dhe detyrimet lidhur me shërbimin e dokumentave;

3. Zhvillimi i seancave gjyqësore me video – konferencë (neni 9);
4. Kthimi i sendeve të marrë në mënyra të paligjshme për t'ia kthyer pronarëve të ligjshëm (neni 12);
5. Mbikqyrjet ndërkufitare (neni 17);
6. Hetimet sekrete (neni 19).

Megjithatë, mospërfshirja e këtyre formave në legjislacionin e brendshëm, nuk përjashton mundësinë e kryerjes së tyre, duke u mbështetur gjithnjë në parimet kushtetuese të së drejtës në Shqipëri. Për këtë është shprehur edhe Gjykata e Lartë në vendimin unifikues të saj nr.1 datë 30.01.2003, ku ndër të tjera ka arsyetuar:

Në nenin 5 të Kushtetutës është parashikuar se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.”

Nenet 116/b, c dhe 122 të Kushtetutës parashikojnë në mënyrë të shprehur se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të botuara në Fletoren Zyrtare përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, se ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk janë të vetzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji, dhe se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to.

Nga sa më lart rezulton se në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale përparësi ka Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pajtueshmëria (kompatibiliteti) e të cilave me Kushtetutën mund të vlerësohet nga GjK para ratifikimit të tyre (neni 131/b i Kushtetutës).

Duke qënë se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi mbi ligjet e vendit, atëhere në rast papajtueshmërie, kuptohet që gjykatat duhet të zbatojnë normat e marrëveshjes ndërkombëtare dhe jo të ligjit që nuk pajtohet me të ...

... Duhet të theksojmë gjithashtu se në mungesë të instrumentave juridikë të nënshkruara e të ratifikuara, normat përgjithësisht të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen edhe sipas parimit të vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit. (Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2010:392-393, 396)

Në vijim të këtij arsytimi, si dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe me sa ka parashikuar specifikisht vetë Konventa e KE-së për ndihmën e ndërsjellë juridike, përcaktimet e akteve ndërkombëtare mund të aplikohen nga autoritetet gjyqësore edhe nëse ato nuk janë përfshirë në legjislacionin e brendshëm, me kusht të domosdoshëm që ato të mos bien ndesh apo të mos ndalohen nga legjislacioni i brendshëm i RSh-së, në rastin konkret atë penal apo procedural penal, në të njëjtën kohë të mos çënojnë sovranitetin e shtetit shqiptar. E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur ekziston një marrëveshje midis palëve që përfshihen në një letërporosi ndërkombëtare penale apo çdo lloji tjetër të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Në përmbledhje të kësaj analize, mund të arrihet në konkluzionin se **kuadri ligjor i parashikimeve për letërporositë ndërkombëtare penale në Shqipëri është i plotë.**

Pas këtij arsytimi, natyrshëm mund të lindë pyetja: Përse atëhere duhej bërë gjithë kjo analizë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me aktet ndërkombëtare në fushën e objektit të studimit?

Në bazë të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe për një efikasitetit të tyre, shtetet detyrohen të përafrojnë legjislacionet e tyre kombëtare me aktet

ndërkombëtare të pranuar prej tyre apo të pranuar ndërkombëtarisht. Përafrimi i legjislacionit të brendshëm me aktet ndërkombëtare do të shoqërohej edhe me përafrimin e legjislacioneve midis shteteve të ndryshme, duke lehtësuar bashkëpunimin mes tyre dhe efikasitetin e tij në luftë kundër krimit të çdo lloji qoftë ai.

Nisur nga problemet që ndeshen në praktikë, që do të analizohen më tej në studim në kapitullin V, shpërndarja e normave në ligje të ndryshme është në disfavor të mundësisë së njohjes së tyre e më tej zbatimit të tyre në praktikë. Thënë kjo duke pasur parasysh faktin, që me ekzekutimin e letërporosive merret çdo prokuror apo gjyqtar i shkallës së parë, ku është edhe volumi më i madh i punës, pa pasur një përqendrim të tyre në seksione të veçanta me staf të specializuar dhe të përgatitur. Në këtë këndvështrim, do të ishte e udhës që të gjithë këto dispozita të përmbledheshin në një botim të vetëm, me të cilin autoritetet ekzekutive të letërporosive të njiheshin me lehtësi. Në të njëjtën kohë, do të ishte me vlerë edhe shoqërimi i botimit me udhëzime, në lidhje me problem të ndëshura në praktikë, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe efektivitetit të ekzekutimit të letërporosive. Kjo gjë është bërë aktualisht në Shqipëri në fusha të tjera të së drejtës penale, siç është bërë së fundmi botimi i manualeve për prokurorë e gjyqtarë, në lidhje me trajtimin e të miturve në procesin penal.

4.3. Krahasimi i trajtimit juridik të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Itali

4.3.1. Një historik i shkurtër e zhvillimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Italisë

Përgjatë historisë Italia dhe Shqipëria, duke qënë dy shtete fqinje kanë pasur marrëdhënie të mira midis tyre. Këto marrëdhënie jënë të lashta sa dhe vetë këto shtete dhe kanë dëshmuar për një interes të dyanshëm të qëndrueshëm.

Roma dhe Venediku kishin marrëdhënie ekonomike, politike dhe kulturore me shtetin Ilir. Skënderbeu gjithashtu kishte marrëdhënie të mira me Alfonsin V të Napolit. Qindra dhe mijëra arbëreshë të përndjekur nga osmanët pas vdekjes së Skënderbeut emigruan në Itali. Është i mirënjohur kontributi i Italisë në Konferencën e Londrës për pavarësinë e Shqipërisë. Pas pavarësisë dhe formimit të shtetit shqiptar në 1912, Italia ishte një ndër shtetet e parë që vendosi marrëdhënie diplomatike me qeverinë e Princ Vedit. Pas një ndërprerjeje të marrëdhënieve gjatë Luftës I Botërore, ato u rivendosën në 1920 dhe u zgjeruan më tej gjatë qeverisjes së Mbretit Zog deri në 7 prill 1939. Gjatë kësaj periudhe, kultura italiane kishte një impakt të madh për popullin shqiptar. Të gjithë ligjet e reja të Shqipërisë, midis të cilave edhe ata në fushën e së drejtës penale u krijuan nën modelin e ligjeve italiane. Gjatë Luftës II Botërore (1939 – 1945), Shqipëria ishte e pushtuar nga fashistët italianë. Në Shkurt 1947 në Paris u nënshkrua Traktati i Paqes midis Italisë dhe Shqipërisë. Marrëdhëniet diplomatike rifilluan në Maj 1949. Që në vitet e para pas luftës, qeveritë italiane denoncuan pushtimin fashist të 7 prillit 1939, duke e konsideruar atë

vetëm një fakt historik dhe kanë njohur sovranitetin dhe kufijtë ekzistues të Shqipërisë. Gjatë regjimit komunist Shqipëria ishte e izoluar, megjithatë gjatë viteve '80 filloi një zhvillim i marrëdhënieve midis dy shteteve, sidomos ato tregëtare dhe kulturore. Pas ndryshimeve demokratike të Shqipërisë, shumë shqiptarë emigruan në Itali gjatë viteve 1991 – 1992 e në vazhdim, gjë që është shoqëruar me marrëdhënie aktive midis Shqipërisë dhe Italisë. Me fillimet e demokracisë, Italia është evidentuar si një nga partnerët më strategjikë të Shqipërisë, duke asistuar dhe kontribuar në reformimin e institucioneve, ekonomisë dhe konsolidimit të shtetit demokratik të saj.

4.3.2. Analizë krahasuese e bazës ligjore të Shqipërisë me atë të Italisë në lidhje me letërporositë ndërkombëtare penale

Në Kushtetutën e Republikës së Italisë (RI), e cila ka hyrë në fuqi në datë 1 janar 1948 dhe ligjet e mëvonshme kushtetuese është parashikuar, se: "...dispozitat penale nuk mund të bien ndesh me parimet e Kartës Kushtetuese ose ligjet e tjera kushtetuese që pasojnë" (Riz, 2006:10).

Kjo gjë është parashikuar edhe në Kushtetutën e RSh-së, duke u parashikuar në nenin 4/1 të saj që Kushtetuta është ligji më i lartë, për rrjedhojë të gjithë ligjet e tjera duhet të jenë në përputhshmëri me të.

Në Kushtetutën e RI-së, neni 10 ndër të tjera parashikon, se ligjet e së drejtës italiane përafrohen me aktet ndërkombëtare të njohura përgjithësisht. Në këndvështrim të kësaj dispozite, një akt ndërkombëtar ka prioritet ndaj ligjeve të së drejtës së brendshme.

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në Itali gjejnë rregullim në kreun 11 të Kodit të Procedurës Penale të RI-së, që përfshin nenet 696–745 të tij të ndarë në katër tituj. Në titullin I të këtij kreu parashikohen dispozita të përgjithshme në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, neni 696 i të cilit parashikon prevalencën e konventave dhe të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, konkretisht:

- 1. Ekstradimi, letërporositë ndërkombëtare, fuqia e vendimeve penale të huaj, ekzekutimi jashtë shtetit i vendimeve penale italiane dhe marrëdhëniet e tjera me autoritetet e huaja që kanë lidhje me administratën gjyqësore të çështjeve penale rregullohen nga normat e marrëveshjeve të ratifikuara nga shteti dhe nga normat e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme.*
- 2. Nëse norma të tilla mungojnë ose parashikojnë ndryshe, aplikohen normat e mëposhtme. (Codice di Procedura Penale e leggi complementari, 1995:321)*

Parimi i prevalencës së akteve ndërkombëtare sipas nenit 696 të KPP-së të RI duket sikur i le të pazbatueshme dispozitat e tij në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, për aq kohë sa këto lloj marrëdhëniesh rregullohen me akte ndërkombëtare. Në fakt, kjo dukje është vetëm në pamje të parë, për aq kohë sa në dispozitat që vijojnë përfshihen parashikime specifike për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, të cilat nuk parashikohen në Konventë. Për më tepër, edhe vetë Konventa i referohet marrëveshjeve të tjera të palëve dhe legjislacioneve të tyre të brendshme.

Ndërkohë, në Shqipëri ky parim nuk është totalisht i njëjti dhe nuk përfshihet në KPP të RSh-së, por në nenin 122 të Kushtetutës së RSh-së, ku parashikohet se çdo akt ndërkombëtar i ratifikuar është pjesë e të drejtës së brendshme dhe zbatohet drejtpërsëdrejti.

Në titullin II (nenet 697 – 723) parashikohen rregullimet për institutin e ekstradimit nga dhe në drejtim të një shteti tjetër. Në këtë titull përcaktohen: kuptimi i ekstradimit, procedurat që duhet të ndiqen nga autoritetet gjyqësore në çështjet e ekstradimit, kushtet kur lejohet ekstradimi, masat shtrënguese dhe arrestimet në çështjet e ekstradimit, si dhe shpenzimet për ekstradimin.

Në titullin III parashikohen letërporositë ndërkombëtare nga një shtet tjetër (nenet 723 – 726) dhe për në një shtet tjetër (nenet 727 – 729).

Në titullin IV parashikohen efektet e vendimeve penale të huaja dhe ekzekutimi i vendimeve penale italiane jashtë shtetit, ku ndër të tjera përfshihen: kushtet që duhet të plotësohen dhe ndalimet për njohjen e vendimeve penale të huaja; procedura e njohjes së vendimeve penale të huaja, autoritetet përgjegjëse për njohjen, caktimin e dënimeve të vendimeve të njohura, marrjen e masave shtrënguese, vendimet për sekuestron, ekzekutimin, etj.

Nëse bëjmë një analizë të strukturës së të dy kodeve procedurale penale, si atij të Italisë dhe atij të Shqipërisë për sa i përket parashikimeve, në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, vërehet se të dy kodet kanë afërsisht parashikim të të njejtave koncepte juridike, si dhe llojit të ndihmës së ndërsjellë, që konsiston në: ekstradimin, letërporositë ndërkombëtare, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja.

Duke u përqëndruar në letërporositë ndërkombëtare, KPP i RI-së përmban parashikime në nenet 727 – 729 të tij në lidhje me to, për sa më poshtë vijon:

1. Letërporositë ndërkombëtare lejohen për komunikimet, njoftimet dhe marrjen e provave, duke u siguruar që kërkesat të mos çenojnë sovranitetin, sigurinë dhe interesa të rëndësishme të shtetit (n.723/1);
2. Autoriteti përgjegjës për përcjelljen e letërporosive nga jashtë dhe për jashtë është Ministri i Drejtësisë (n.723/1)
3. Ministri i Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë në këto raste:
 - 3.1. kur rezulton që aktet e kërkuara me letërporosi janë të ndaluara shprehimisht në ligj ose janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës italiane (n.723/2);
 - 3.2. ka arsye të mbështetura për dallime të bazuara në racën, fenë, gjininë, kombësinë, gjuhën, opinionet politike, ose kushtet personale apo shoqërore, që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin apo përfundimin e procesit (n.723/2);
 - 3.3. kur nuk rezulton që i dënuari të ketë shprehur lirisht pranimin e tij për të dhënë deklarime (n.723/2);
 - 3.4. kur shteti kërkues nuk ofron garanci për ruajtjen e paprekshmërisë së personit për të cilin është kërkuar me letërporosi marrja e dëshmisë (n.723/3);
 - 3.5. në rastet kur shtetit kërkues nuk jep garanci për reciprocitet (n.723/4).

4. Lejohet marrja në pyetje e një dëshmitari në territorin e Italisë nga autoriteti i huaj, me kusht që më parë të njoftohet për vëndin e marrjes së dëshmisë Prokurori i Përgjithshëm (n.726).
5. Një letërporosi nuk mund të ekzekutohet pa marrjen paraprakisht të vendimit në favor të tij nga Gjykata e Apelit e vendit ku duhet të procedohet me kërkesën (n.724/1).
6. Procedura për ekzekutimin e një letërporosie kalon në këto hapa: Ministri i Drejtësisë ia kalon kërkesën Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ia përcjell kërkesën Gjykatës së Apelit. Kryetari i Gjykatës cakton datën e e seancës për të cilën njofton Prokurorin e Përgjithshëm. Në seancë gjyqësore jepet vendimi për lejimin e ekzekutimit të letërporosisë, ku delegohet një gjyqtar i Gjykatës së Apelit që jep vendimin, ose një gjyqtar në vëndin ku do të zhvillohen veprimet (n.724/2 – 4).
7. Kërkesa për ekzekutimin e letërporosisë nuk pranohet në rastet e përshkruara më lart në pikën 3 (n.724/5).
8. Ekzekutimi i një letërporosie pezullohet nëse ka mundësi që të paragjykohet një hetim apo procedim penal në ndjekje brenda territorit të shtetit (724/5).
9. Për përmbushjen e veprimeve të kërkuara me letërporosi, zbatohen normat e KPP-së të shtetit, përveç rasteve të kërkesave të veçanta të kërkuarit, të cilat nuk bien ndesh me parimet e së drejtës së shtetit (neni 725).
10. Letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për komunikimet, njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, i cili

i përcjell ato në rrugë diplomatike. Ministri procedon me nxjerrjen e një dekreti (vendimi) brenda 30 ditëve. Kur çmon se mund të rrezikohet siguria ose interesat e tjera të rëndësishëm të shtetit, Ministri vendos që të mos i japë rrugë letërporosisë, gjë të cilën ia njofton autoritetit kërkuar. Në rast se vendimi nuk del brenda 30 ditëve nga nisja e letërporosisë, autoriteti gjyqësor mund t'ia dërgojë letërporosinë drejtpërdrejt agjentit diplomatik apo konsullor italian, duke njoftuar në të njëjtën kohë Ministrin e Drejtësisë. Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar Ministrin e Drejtësisë (n.727).

11. Imuniteti (paprekshmëria) e personit të thirrur për të dhënë dëshmi (neni 728).

Nëse i referohemi analizës së parashikimeve të KPP-së të RSh-së në lidhje me letërporositë ndërkombëtare të bërë më parë në çështjen 3.4.1.3, vërehet që parashikimet e tij dhe të KPP-së të RI kanë përputhje jo vetëm në anën strukturore të tyre, por edhe në përmbajtje. Të dy këto akte janë në përputhje të plotë me Konventën e KE-së për ndihmën e ndërsjellë juridike. Në të njëjtën kohë, përputhja është e plotë në lidhje me: parimet e përgjithshme të letërporosive, fushën e veprimit, rastet e refuzimit të ekzekutimit të tyre dhe limitimet.

Vërehet një ndryshim vetëm përsa i përket procedurës së ekzekutimit të letërporosive, në lidhje me vendimin për lejimin e ekzekutimit të letërporosisë. Në Itali ky vendim merret nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, i cili ia delegon veprimet një gjyqtari të kësaj gjykate ose të gjykatës së vendit ku do të kryhen veprimet. Ndërkohë, në Shqipëri ky vendim merret nga gjyqtari i Gjykatës përkatëse të Shkallës së Parë, i cili kryen edhe ekzekutimin e saj.

Me sa duket shteti italian i ka dhënë rëndësi më të madhe këtij vendimi, duke ia lënë kompetencën për marrjen e tij një gjykate të një shkalle më të lartë, siç është ajo e apelit. Kjo është logjike për deri sa ky vendim lidhet ndër të tjera me verifikimin e kushteve shumë të rëndësishme, si respektimi i parimeve të së drejtës italiane, respektimi i të drejtës themelore të njeriut për mosdiskriminim dhe respektimi i reciprocitetit. Në këtë këndvështrim, do të ishte e udhës të ndryshonte edhe legjislacioni procedural penal shqiptar, duke e përqëndruar ekzekutimin e letërporosive nga gjykata të specializuara në shkallë të parë ose nga ato të Apelit.

4.3.3. Aktet ndërkombëtare të përfunduara nga RSh dhe RI në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal

Italia si anëtare e BE-së është palë në shumë Konventa të miratuara nga KE, që në të njëjtën kohë janë ratifikuar nga Shqipëria. Disa mes tyre i përkasin fushës së marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, që i lejojnë ato të kenë marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjellë në procesin penal, ku mund të përmendim:

- Konventën mbi ekstradimin (1957) dhe katër protokollet e saj shtesë;
- Konventën mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale (1959) dhe dy protokollet e saj;
- Konventën mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale (1970);
- Konventën mbi transferimin e çështjeve penale (1972);

- Konventën mbi transferimin e personave të dënuar (1983) dhe protokollin e saj shtesë.

Për një efektivitet më të madh të marrëdhënieve midis dy shteteve Italia dhe Shqipëria kanë nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi, midis të tjerash edhe në fushën penale, nga të cilat mund të përmenden:

1. Marrëveshja shtesë ndërmjet RSh dhe RI, në lidhje me Konventën europiane për transferimin e personave të dënuar e nënshkruar në Romë, më 24.04.2002, ratifikuar me ligjin nr.9169 datë 22.01.2004 (Fletore zyrtare nr. 5, 2004:135). Kjo marrëveshje është lidhur me qëllim intensifikimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në zbatimin të Konventës Europiane mbi transferimin e personave të dënuar të 21 marsit 1983, si dhe duke parë të përshtatshëm plotësimin e Konventës në disa pika, me qëllim shtrirjen e zbatimit edhe me forma të tjera të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale. Këto të fundit kanë të bëjnë më tepër me vendosjen e masave të sigurimit për efekte të ekzekutimit të një vendimi penal dhe mosdomosdoshmërinë e shfaqjes së miratimit të personave të dënuar në rastet e përcaktuara në marrëveshje.
2. Marrëveshja shtesë ndërmjet RSh dhe RI për Konventën Europiane për ekstradimin dhe në Konventën Europiane për ndihmë juridike në çështjet penale, miratuar me ligjin nr.9871, datë 11.02.2008 (Fletore zyrtare nr. 26, 2008:1229). Kjo marrëveshje është nënshkruar, duke pasur parasysh interesin e përbashkët që ndihma juridike ndërmjet dy

shteteve të kryhet në mënyrë të shpejtë dhe efikase, në përputhje me parimet themelore të së drejtës së tyre të brendshme, si dhe duke respektuar të drejtat individuale dhe parimet e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të nënshkruara në Romë, më 04.11.1950. Marrëveshja ka për qëllim plotësimin e Konventës Europiane të Ndihmës Juridike për Çështjet Penale të datës 20 prill 1959, dhe lehtësimin e zbatimit të parimeve që përmbahen në të, pa paragjykuar nenet që mbrojnë lirinë individuale. Në të njëjtën kohë, marrëveshja ka si qëllim të plotësojë Konventën Europiane të Ekstradimit të 13 dhjetorit 1957, duke pasur parasysh që, përsa i përket ekstradimit të shtetasve, RSh në depozitimin e instrumentit të ratifikimit të Konventës Europiane për Ekstradimin deklaronte, duke iu referuar parashikimit të bërë në nenin 6 paragrafi 1 të së njëjtës Konventë, që: "Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është Palë Kontraktuese". Kështu nëpërmjet kësaj marrëveshjeje të dy shtetet kanë deklaruar, se heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë, siç parashikohet nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës Europiane për Ekstradimin.

Përveç këtyre marrëveshjeve vlejnë për t'u përmendur marrëveshjet e herëpashershme të bashkëpunimit dhe protokollet e mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSh-së dhe Qeverisë së RI në luftën kundër kriminalitetit, duke qënë të vetëdijshëm, që fenomenet kriminale që ndiqen penalisht dhe lidhen me kriminalitetin në çdo sektor prekin të dy

shtetet, duke vënë në rrezik rendin dhe sigurinë publike, si dhe mirëqenien e pacënueshmërinë fizike të shtetasve të tyre. Këto marrëveshje shprehin respektim reciprok të parimeve të sovranitetit dhe barazisë, qëllimin e zhvillimit dhe konsolidimit të marrëdhënieve miqësore ekzistuese midis dy shteteve, si dhe qëllimin për të kontribuar aktivisht në luftën kundër kriminalitetit në të gjitha shfaqjet e tij, në veçanti atij të organizuar dhe të trafikeve të paligjshme në interes të dy vendeve. Këto marrëveshje nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me aspektet që lidhen me ndihmën gjyqësore në fushën penale dhe të ekstradimit, por indirekt bashkëpunimi në kuadër të këtyre marrëveshjeve ndikon në to, duke bërë të mundur bashkëpunim më të shpeshtë dhe më të frytshëm midis dy shteteve në këtë fushë.

4.4. Krahasimi i trajtimit juridik të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe Maqedoni

4.4.1. Analizë krahasuese e bazës ligjore të Shqipërisë me atë të Maqedonisë në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporositë ndërkombëtare penale si pjesë e tyre

Kushtetuta e Maqedonisë (FYROM) është miratuar në nëntor 1991, pas konsitutumit juridik të shtetit maqedonas si republikë sovrane dhe shprehjes së vullnetit të qytetarëve në referundimin e datës 8 shtator 1991.

Në Kushtetutën e Maqedonisë, në nenin 8 të saj është parashikuar, si një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të FYROM, midis të tjerash, respektimi i normave përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë Kushtetutë nuk ka asnjë dispozitë tjetër që të lidhet me mënyrën se si do të respektohen këto akte. Ndërkohë, në Shqipëri në nenin 122 të Kushtetutës së RSh-së parashikohet, se çdo akt ndërkombëtar i ratifikuar është pjesë e të drejtës së brendshme dhe zbatohet drejtpërsëdrejti.

Ndërkohë, Kodi Penal i FYROM-it, që përbën aktin e parë penal në Maqedoni, është miratuar nga Kuvendi i FYROM-it në 23 korrik 1996 dhe zbatohet që nga datë 1 nëntor 1996. Ky kod është përmirësuar më pas me amendamentet e Mars 2004, Qershor 2006, Janar 2008 dhe Shtator 2009. Ndryshe nga KP i RSh-së, në pjesën e përgjithshme të KP-së të FYROM-it janë përfshirë parimet e përgjithshme të së drejtës penale, por në to nuk përfshihet asnjë parashikim në lidhje me aktet ndërkombëtare.

Si në Kushtetutën e FYROM-it, ashtu edhe në KP të FYROM-it nuk ka asnjë parashikim në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, të cilat nga ana tjetër gjejnë rregullim në Kodin e Procedurës Penale të FYROM-it.

Në kapitullin XXX të KPP-së të FYROM-it, i cili është një kod i ri i miratuar në vitin 2010, janë parashikuar dispozitat mbi procedurat për aprovimin e ndihmës ndërkombëtare gjyqësore dhe ekzekutimit të akteve traktateve ndërkombëtare në çështjet gjyqësore penale, të cilat përfshijnë nenet 502 – 508 të tij.

Në nenin 502 të KPP-së të FYROM-it përcaktohet, se ndihma ndërkombëtare juridike penale ushtrohet nëpërmjet dispozitave të këtij kodi, në rast se nuk parashikohet ndryshe në një traktat ndërkombëtar. Ky parim shpreh qartë parimin kushtetues të FYROM-it për respektimin e normave përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, kjo dispozitë është shprehje e qartë e përparësisë së akteve ndërkombëtare kundrejt të drejtës së brendshme të FYROM-it.

Sipas nenit 503/3 të KPP-së të FYROM-it, caktohet vetëm një gjykatë për çdo regjion, e cila është kompetente për të shqyrtuar kërkesat në lidhje me ndihmën ndërkombëtare juridike në çështjet penale dhe me ligj të veçantë përcaktohen se cilat janë ato. Pra, ndryshe nga Shqipëria, në Maqedoni shihet një përqendrim i shqyrtimit të kërkesave që lidhen me ndihmën ndërkombëtare juridike ashtu si edhe në rastin e Italisë nga gjykata të posaçme.

Më tej, KPP i FYROM-it përcakton procedurën e dërgimit të kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale nga autoritetet e huaja në FYROM dhe anasjelltas. Këto kërkesa përcillen në rrugë diplomatike, por në raste të ngutshme dhe në rast se ka një marrëveshje të përbashkët me shtetin përkatës, ato mund të përcillen nga Ministri i Punëve të Brendshme (neni 503). Kjo procedurë shpjegohet më pas në nenet 504 – 505 të KPP-së të FYROM-it, në të cilin parashikohen këto hapa për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale:

1. Ministri i Punëve të Jashtme ia drejton kërkesat për ndihmë juridike nga autoritetet e huaja Ministrit të Drejtësisë, i cili ia përcjell ato gjykatës së rajonit të vendbanimit të personit të që përshihet në këtë kërkesë.
2. Në rastet e ngutshme të sipërpërmendura, është Ministri i Punëve të Brendshme që e drejton kërkesën për në gjykatë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.
3. Gjykata kompetente vendos mbi lejimin e zbatimit të kërkesës, duke përcaktuar edhe mënyrën në përputhje me procedurat përkatëse të legjislacionit të brendshëm.
4. Kur kërkesa i përket ekstradimit për një krim, i cili nuk parashikohet si i tillë nga legjislacioni i brendshëm, gjykata i kërkon mendim Ministrisë së Drejtësisë.
5. Gjykata vendase mund të pranojë kërkesën e autoriteteve të huaja me të cilën kërkohet ekzekutimi i një vendimi penal të huaj nëse diçka e tillë është vendosur me traktat ndërkombëtar, si dhe duke plotësuar kushtet e reciprocitetit dhe të parashikimit të veprës penale për të cilën është dhënë vendimi nga legjislacioni i brendshëm, duke caktuar edhe datën e seancës përkatëse të shqyrtimit. Kjo datë i njoftohet Prokurorit të Republikës dhe konsullit të vendit përkatës.

Në nenet vijues të KPP-së të FYROM-it janë parashikuar përcaktime, në lidhje me:

- Transferimin e një procedimi penal për hetimin dhe gjykimin në shtetin e vendbanimit të përhershëm në rastet e krimeve që parashikojnë deri në 10 vjet burgim, të kryer nga shtetas të huaj;

- Rastet e kërimit shtetit maqedonas nga një shtet i huaj, që të procedojë një shtetas maqedonas apo me banim të përhershëm në Maqedoni për një krim të kryer jashtë shtetit.

Në analizë të këtyre dispozitave, vërehet se megjithëse KPP i FYROM-it është një ligj i ri, i miratuar pak vite më parë, në të ka shumë pak parashikime në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporositë ndërkombëtare si pjesë e tyre. Ndoshta ligjvënësi maqedonas e ka parë të arsyeshme të përfshijë vetëm disa parashikime bazë, duke mbajtur parasysh parimin kushtetues të FYROM-it për respektimin e akteve ndërkombëtarë dhe duke e quajtur këtë një mundësi për t'i aplikuar drejtpërdrejt këto akte, pa i përfshirë ato në të drejtën e brendshme. Në KPP të FYROM-it nuk ka përcaktime të parimeve mbi bazën e të cilave mbështeten marrëdhëniet ndërkombëtare me autoritetet e huaja në procesin penal as ndalimet në lidhje me to. Vetëm përsa i përket njohjes së vendimit penal të huaj, ky kod ka parashikuar parimin e reciprocitetit dhe parashikimit si krim nga legjislacioni maqedonas të faktit për të cilin është dhënë vendim nga gjykata.

Vlen të theksohet, se pavarësisht se KPP i RSh-së është miratuar 15 vite para KPP të FYROM-it, duke u bazuar edhe në analizën që iu bë atij në krahasim me KPP të RI-së në pikën 5.1.1. të studimit, si për nga struktura e tij dhe nga përmbajtja e tij, ai përafrohet më shumë me standartet europiane të ligjbërjes.

4.4.2. Aktet ndërkombëtare të nënshkruara midis RSh dhe Qeverisë së Maqedonisë në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal

Shqipëria dhe Maqedonia si dy vende fqinjë kanë bashkëpunim ndërshtetëror në shumë fusha të jetës, midis të cilave edhe në fushën e bashkëpunimit në procesin penal. Në këtë fushë RSh ka lidhur me FYROM këto marrëveshje:

1. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për ekstradimet, ratifikuar me ligjin nr.8299 datë 04.03.1998 (Fletore zyrtare nr. 7, 1998:254). Kjo marrëveshje është nënshkruar duke pasur parasysh interesin e përbashkët të qeverive të të dy shteteve për efikasitet të bashkëpunimit në lidhje me ekstradimet e të dënuarve, me qëllim ndëshkimin e autorëve të veprave penale dhe zbatimit të ligjit penal në çdo rast.
2. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ndihmën juridike në fushën civile dhe penale, ratifikuar me ligjin nr.8304 datë 12.03.1998 (Fletore zyrtare nr. 7, 1998:260). Kjo marrëveshje është nënshkruar nën frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet të dy vendeve, me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis dy shteteve për ndihmë të ndërsjellë juridike si në fushën civile ashtu edhe atë penale.
3. Marrëveshja ndërmjet Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisjes së FYROM-it për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e

prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, ratifikuar me ligjin nr.9307 datë 04.11.2004 (Fletore zyrtare nr. 7, 2004:260). Kjo marrëveshje është nënshkruar, duke pranuar avantazhet e bashkëpunimit ndërkombëtar si një faktor i një rëndësie shumë të madhe për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e perkursorëve, emigracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme. Ajo është hartuar duke mbajtur parasysh edhe dispozitat e konventave dhe traktateve ndërkombëtare në këtë fushë, në të cilat të dy shtetet janë palë. Në këtë akt të dy shtetet kanë deklaruar, se do të bashkëpunojnë dhe asistojnë njeri – tjetrin me parandalimin, identifikimin e krimeve të fushave të përmendura më lart, në mënyrë reciproke dhe në përputhje me legjislacionin e tyre, duke mos cënuar sovranitetin apo sigurinë e tyre, si dhe duke mbrojtur konfidencialitetin dhe sekretin e të dhënave. Vërehet, se në lidhje me këtë marrëveshje, të gjitha sa u përmendën më lart shprehin parimet e konventës së KE-së për bashkëpunim të ndërsjellë juridik në procesin penal.

Kapitulli V: PROBLEMET E PRAKTIKËS NË FUSHËN E LETËRPOROSIVE NDËRKOMBËTARE

5.1. Rezultatet e të dhënave të grumbulluara nga pyetsori, vlerësimi dhe interpretimi i tyre


Siç u shpjegua në pikën 1.3.3. të studimit, është kryer një pyetsor me qëllim vërtetimin e hipotezës së këtij studimi dhe identifikimin e problemeve të praktikës.

Tabela 3 Numri i personave të pyetur specifikuar sipas profesioneve

Profesioni		Nr. i personave të pyetur	Përgjigjur plotësisht	Përgjigjur pjesërisht	Pa përgjigje
Studiues		24	14	6	4
Gjyqtarë		55	26	15	14
Prokurorë		71	37	21	13
Oficerë të Policisë Gjyqësore		28	14	12	2
Avokatë		50	28	14	8
MD		2	2	-	-
KLD		3	1	1	1
Avokati i Popullit		2	1	1	0
Të tjera		5	1	3	1
Doktorantë		6	3	2	1
Të huaj	Pun. në sist. e drejtës.	46	32	9	5
	Studiues	3	3	0	0
Gjithsej		295	162	84	49

Në lidhje me çështjet e studimit janë pyetur 295 persona shqiptarë dhe të huaj, ku janë përfshirë: gjyqtarë e prokurorë në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, oficerë të policisë gjyqësore, të cilët midis të tjerave kanë si objekt të punës së tyre edhe aspekte të marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja në procesin penal, studiues kryesisht të drejtimit e drejtë penale, si dhe juristë të tjerë me njohuri në këtë fushë.

Grafiku 1



Në referim të tabelës 1¹⁰, ku janë paraqitur të dhënat e pyetsorit mbi bazën e ndarjes së profesioneve, pjesën më të madhe të personave të pyetur e zënë punonjësit e gjyqësorit, konkretisht: 200 gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore të niveleve të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj që zënë 67.8% të të gjithë të pyeturve. Edhe në pjesën tjetër të të pyeturve bëjnë pjesë persona që punojnë në funksione të tjera, të përfshirë në sistemin e drejtësisë, si: avokatë (50), MD/KLD (5), avokati i popullit (2), etj. Vlen të theksohet që janë pyetur 3 prokurorë dhe 4 oficerë të Policisë Gjyqësore që kanë punuar në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe

¹⁰ **Shënim:** Shih kapitulli 1, çështja 1.3.3.


një drejtores e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë, të cilët i kanë ndjekur në tërësi dhe në dinamikë ndër vite marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal.

Përsa i përket personave të huaj, pyetsori i është drejtuar personave me profesione gjyqtar, prokurorë dhe oficerë policie, të cilët në punën e tyre të përditshme kryenin edhe veprime në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike. Këtu janë përfshirë prokurorë dhe oficerë të policisë të drejtorive/seksioneve të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë të Prokurorive të Përgjithshme të Sllovenisë, Sllovakisë, Rumanisë, Qipros, etj. Po kështu pyetsori i është drejtuar disa funksionarëve në drejtoritë e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal të ministrive të ndryshme në shtetet e tyre (si psh: Ministria e Drejtësisë Turqi, Ministria e Rendit Spanjë, Ministria e Brendshme Austri, etj).¹¹ Kjo është bërë me qëllim që të vihen në pah më mirë problemet praktike të fushës së studimit, sesa ato në anën teorike të tij.

Nga personat e pyetur nuk janë përgjigjur 49 persona, që përbëjnë 16,6% të tyre. Duke i paraqitur të dhënat në mënyrë grafike, rezulton që nuk janë përgjigjur 29% e personave të pyetur në rradhët e zbatuesve të ligjit në Shqipëri, që përbën edhe përqindjen më të lartë midis grupeve të tjerë.

¹¹ **Shënim:** Për kontaktimin me këta persona është shfrytëzuar pjesëmarrja si prokurorë e RSH në një projekt ndërkombëtar mbi European Anti – Corruption Training, i cili është zhvilluar në disa faza në Austri dhe Slloveni, në periudhën Shtator 2011 – Shtator 2013

Grafiku 2 Përqindja e personave që i janë përgjigjur pyetsorit sipas grup profesioneve



Numri i pyetsorëve të mbledhur nga punonjësit e sistemit të drejtësisë është arritur me këmbëngulje. Duke mos pasur përgjigje nëpërmjet rrugës elektronike, ata janë kontaktuar personalisht, shpesh herë edhe më shumë se dy herë. Shpesh janë shfrytëzuar edhe mbledhje, seminare apo trainime të ndryshme, duke i marrë përgjigjet e pyetsorit duke i shkruar përgjigjet e pyetjeve të tyre aty për aty. Edhe kjo mënyrë kishte vështirësi, për arsye se personat e kontaktuar kërkonin kohë për të shfletuar ligjet apo literaturën për të dhënë përgjigjet e tyre sa më të plota. Vihej re një ngurrim i tyre për të dhënë mendime në


lidhje me aspektin teorik të problemit, ndërkohë, ishte më e lehtë që ata t'i përgjigjeshin pjesërisht pyetsorit, për ato pyetje që lidheshin drejtpërdrejt me punën e tyre të përditshme dhe rastet e praktikës.

Të gjitha këto lidhen me disa arsye, më konkretisht:

- Ngarkesa në punë;
- Shkëputja nga leximi i literaturës me baza teorike, duke u marrë vetëm me zgjidhjen e problemeve sipas modeleve të gatshëm të rasteve të ngjashëm nga praktika apo praktikave të krijuara në insitucionin e tyre;
- Referimi në legjislacion të kufizuar sipas natyrës së punës, duke kryer veprimeve steriotipe me formularë të gatshëm;
- Mosvlerësimi i punës studimore, duke e konsideruar atë humbje kohe;
- Mungesë e korrektësisë.

Ndërkohë, në referencë të numrit 46 të personave të huaj, nga të cilët 41 kanë qënë punonjës të sistemit të drejtësisë, vetëm 5 prej tyre nuk i janë përgjigjur pyetsorit. Vërehej se të pyeturit e huaj kishin njohje të mirë të ligjit edhe kur i përkisnin rradhëve të oficerëve të policisë. Në të njëjtën kohë, ata paraqiteshin më korrektë në shpejtësinë e plotësimit të pyetsorit dhe ishin të gatshëm të jepnin informacione referuese. Në këtë këndvështrim, arsyet e sipërpërmendura për të pyeturit shqiptarë, mendohet të jenë më tepër konceptuale dhe në mentalitet të punonjësve të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, sidomos tek ata që janë diplomuar para apo në fillim të viteve '90.

Grafiku 3 Përqindja e personave që i janë përgjigjur plotësisht pyetsorit sipas grup profesioneve



Gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave nëpërmjet pyetsorit, u vërejt se studiuesit apo mësimdhënësit në rastet e përgjigjes së tyre ishin të gatshëm dhe korrektë. Megjithatë, kjo varej më tepër nga bazat e njohjeve personale, duke pasur parasysh që disa akademikë me grada të larta shkencore në fusha të cilave u përket tema e studimit nuk iu përgjigjën fare pyetsorit. Impresionues ishte fakti i gatishmërisë së përgjigjeve nga rradhët e avokatëve dhe avokati i popullit, të cilët kanë kthyer përgjigje të shpejta dhe kanë treguar gatishmëri edhe për informacione më tepër se thjesht pyetjet e pyetsorit.

Në fakt, ky nuk përbën një përfundim për t'u përgjithësuar, për arsye se pyetsori iu drejtua personave, për të cilët kishte siguri që do të përgjigjeshin mbi bazat e njohjeve personale apo tek të cilët njiheshin korrektësia, gatishmëria, prijet dhe aftësitë studiuuese, si dhe numri i të pyeturve nga rradhët e tyre ishte shumë herë më i vogël në krahasim me numrin e të pyeturve nga rradhët e punonjësve të sistemit të drejtësisë.

Vërehej që pas impaktit të parë me pyetsorin, të pyeturit prireshin të jepnin përgjigje vetëm përsa i përket ekstradimit, ndërsa për letërporositë ndërkombëtare dhe njohjet e vendimeve penale të huaj përgjigjet jepeshin pasi kërkohej apo specifikohet pyetja.

Më poshtë analiza do të vijojë sipas pyetjeve të përfshira në pyetsor, duke e ndarë në dy pjesë, për arsye se të pyeturve shqiptarë i janë drejtuar pyetje të ndryshme nga ato të drejtuara të personave të huaj.

Kampioni i marrë në pyetsor për këtë studim është i përshtatshëm për referim, duke pasur parasysh dhe duke analizuar të dhënat e paraqitura më lart. Konkretisht:

- 162 të të pyeturve i janë përgjigjur plotësisht pyetsorit. Kjo shifër përbën rreth 55 % të numrit të përgjithshëm të personave të kontaktuar (295), duke përfshirë këtu edhe numrin e personave që nuk janë përgjigjur fare. Ndërkohë, 83.4% e të pyeturve (202) i janë përgjigjur plotësisht pyetsorit për të gjitha pyetjet e tij. Megjithatë, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjigjeve të dhëna në pyetsorët, një pjesë e përgjigjeve, rreth 10% i është referuar gjykatave ndërkombëtare penale, të cilat nuk janë objekt i këtij studimi.

180

Pyetja 2 A keni informacion mbi legjislacionin në fushën e letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal?

Plotësisht

Pjesërisht Jo

Pyetja 3 Sipas mendimit tuaj, a është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procesin penal?

Po

Jo

Nuk kam informacion

Tabela 4 Rezultatet e përgjigjeve për pyetjet 1, 2, 3 të pyetsorit, specifikuar sipas grup profesioneve

Personat e pyetur sipas profesionit	Pyetja 1			Pyetja 2				Pyetja 3			
	Po	Jo	Gjith	Plot	Pjes	Jo	Gjith	Po	Jo	Pa inf	Gjith
Akad/Doktorantë	2	23	25	17	8	0	25	13	11	1	25
Gjyq/Prok/Of	125	0	125	77	48	0	125	79	34	12	125
Avokatë/Av.Pop	39	5	44	29	15	0	44	15	23	6	44
Të tjera	5	3	8	4	4	0	8	5	2	1	8
Gjithsej	171	31	202	127	75	0	202	112	70	20	202

Pyetja 4 Sipas mendimit tuaj, a janë efektive procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare në procedimin e çështjeve penale?

Po

Jo

Nuk kam informacion

Pyetja 5 A është e nevojshme të bëhen ndryshime të legjislacionit penal shqiptar në këtë fushë? *Po Jo Nuk kam mendim*

Pyetja 6 A mund të sugjeroni ndonjë mjet më efektiv në këtë fushë, sipas mendimit tuaj apo praktikave më të përparuara nga bota që mund të njihen nga ju? *Po Jo Nuk kam informacion*

Tabela 5 Rezultatet e përgjigjeve për pyetjet 4, 5, 6 të pyetsorit, specifikuar sipas grup profesioneve


Personat e pyetur sipas profesionit	Pyetja 4				Pyetja 5				Pyetja 6			
	Po	Jo	Pa inf	Gjith	Po	Jo	Pa men	Gjith	Po	Jo	Pa inf	Gjith
Akad/Doktorantë	8	12	5	25	7	13	5	25	5	9	11	25
Gjyq/Prok/Of	31	94	0	125	24	59	42	125	28	35	62	125
Avokatë	16	19	9	44	13	16	15	44	9	17	18	44
Të tjera	5	3	0	8	2	5	1	8	3	4	1	8
Gjithsej	60	128	14	202	46	93	63	202	45	65	92	202

Nga analizimi i rezultateve të përfutuara nga mbledhja e të dhënave nëpërmjet pyetsorit, shoqëruar me paraqitjen në mënyrë grafike, rezulton se:

- Rreth 55.4% e të pyeturve mendojnë, se legjislacioni penal shqiptar është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare, në fushën e letërporosive ndërkombëtare, si pjesë e marrëdhënive juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal;

- 28.2% e të pyeturve kanë shprehur mendimin që duhet të bëhen ndryshime të legjislacionit shqiptar në fushën e letërporosive ndërkombëtare, ndërkohë që 55.4% e tyre ka shprehur mendimin se ai nuk duhet të ndryshohet;

Grafiku 4 Rezultatet e pyetsorit nga të pyeturit shqiptarë për plotshmërinë e legjislacionit penal shqiptar efektivitetin e procedurave aktuale ligjore



- 63.4% e të pyeturve mendojnë, se procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procedimin e çështjeve penale nuk janë efektive. Ndërkohë vetëm 29.7% e tyre mendojnë se këto procedura janë të efektshme;

- Vetëm 45 persona nga 202 të pyetur (22.3%) kanë dhënë sugjerime për mjete më efektive në këtë fushë.

Pjesa e dytë e pyetjeve në pyetsor përfshinte pyetje, ku personave të pyetur iu është dhënë mundësia të japin përgjigje të lira në lidhje me mendimet e tyre për pyetjet 3 – 6, në rast se i ishin përgjigjur me po/jo atyre në pjesën e parë të pyetsorit.

Pyetjes “Sipas mendimit tuaj, pse është/nuk është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procesin penal?” i janë përgjigjur me “po” 112 të pyetur dhe me “jo” 70¹². Nga këta të fundit 56 kanë specifikuar përgjigjet e tyre në pyetjen “Sipas mendimit tuaj, pse është/nuk është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procesin penal?” Nga analiza e pyetsorëve rezulton, se: Nga 87 persona të pyetur të përgjigjur me “po” është specifikuar, se është i plotë legjislacioni i brendshëm i RSh-së, por duhen shtuar marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim me shtete të botës. Gjithashtu, edhe 47 të pyetur që janë përgjigjur me “jo” e kanë quajtur legjislacionin shqiptar të paplotë pikërisht për mungesën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Shqipërisë me shumë shtete të botës, kryesisht vendet e zhvilluara, si: Gjermania, Franca, Hollanda, Suedia, etj. Pra, rreth 66.3% e personave të pyetur mendojnë, se Shqipëria duhet të zgjerojë

¹² **Shënim:** Referoju të dhënave për pyetjen 3 në tabelën 3

marrëveshjet e bashkëpunimit me shtetet e tjera në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë. 6 të pyetur (3%) kanë propozuar pranim të akteve ndërkombëtare nga ana e Shqipërisë. Pavarësisht konceptimit të pyetjes nga një pjesë e të pyeturve, në analizë të përgjigjeve të tyre, pjesa prej 78.7% e të pyeturve mendon se legjislacioni shqiptar i brendshëm shqiptar në këtë fushë është i plotë, duke pasur parasysh këtu faktin, që lidhja e marrëveshjeve me shtete të tjerë varet nga faktorë të ndryshëm politikë e shoqërorë dhe nuk varet vetëm nga vullneti i shtetit shqiptar. Nga ana tjetër, marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e tjera në procesin penal mund të vendosen vetëm nëse ka vend për një bashkëpunim të tillë.

Pyetjes “Sipas mendimit tuaj, a janë efektive procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare në procedimin e çështjeve penale?”, 128 persona të pyetur i janë përgjigjur me “jo” dhe 60 të pyetur me “po”¹³. Pra, 63.4% e të pyeturve mendojnë se procedurat ligjore në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë jo të efekshme, ndërsa 29.7% e tyre i mendon ato si të efekshme.

Në vijim në pyetjen e zgjeruar “Pse janë/nuk janë efektive procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare në procedimin e çështjeve penale?”, 121 nga të pyeturit e përgjigjur me “jo” kanë paraqitur shkaqe të ndryshme që ndikojnë në mosefektshmërinë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja. Më poshtë renditen shkaqet sipas numrit më të madh të të pyeturve që i kanë përmendur ato:

¹³ **Shënim:** Referoju të dhënave për pyetjen 4 në tabelën 4

- Kohën e gjatë të marrjes së provave nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare (111);
- Ngarkesën në punë (101);
- Procedurat e tejzgjatura (76);
- Mungesën e përpikmërisë në përmbushjen e çka kërkohet nëpërmjet një letërporosie (63);
- Mungesa e infrastrukturës (58);
- Mungesa e adresave të sakta të vendbanimeve (56).
- Kërkimi i informacioneve plotësues (51);
- Ndryshimin e legjislacionit penal apo procedural penal nga njëri shtet në tjetrin (43);
- Mungesën e afateve në ekzekutimin e një letërporosie ndërkombëtare (42);
- Mungesën e profesionalizmit në përpilimin e një letërporosie (38);
- Mungesën e sanksioneve të akteve ndërkombëtare (34);
- Mungesën e detyrueshmërisë së akteve ndërkombëtare (30);
- Mungesa e mjeteve financiare (30);
- Mungesën e informacionit teorik dhe atë mbi bazën ligjore nga një pjesë e punonjësve të sistemit të drejtësisë (29);
- Vullneti jo i mirë i të huajve (27).

Këto shkaqe janë në përgjithësi të ndërthurura me njëra – tjetrën dhe nuk mund të analizohen veçmas. Në analizë të këtyre shkaqeve vërehet, se shkaku më i rëndësishëm që

ndikon në efektshmërinë e letërporosive ndërkombëtare është koha e gjatë e marrjes së provave nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare. Ky është një shkak që qëndron realisht. Pothuaj të gjithë të pyeturit nga organet e gjyqësorit kanë dhënë raste të praktikës së tyre, ku në çështje konkrete penale marrja e provës nëpërmjet një letërporosie ka zgjatur nga 1 – 3 vjet. Më së shumti janë përmendur këtu raste të letërporosive me shtetin grek, të cilat jo vetëm zgjasin në afate, por vijnë të pjesshme ose të paekzekutuara. Kjo gjë ndikon në zgjatjen e hetimeve apo gjykimeve tej afateve të arsyeshme. Në disa raste me të pandehur të arrestuar, për shkak të vonesave të letërporosive është shkaktuar përfundimi i afateve të paraburgimit. Vlen të theksohet këtu, që shpesh herë letërporositë e shtetit shqiptar për rastet e shtetasve të huaj si të pandehur nuk ekzekutohen nga shtetetet e tyre, ndërkohë që shteti shqiptar tregon më tepër korrektësi në raste të tilla.

Ky shkak lidhet ngushtë edhe me shkaqe të tjera të përmendura më pak nga të pyeturit, por që në vetvete ndikojnë në zgjatjen e kohës së ekzekutimit të një letërporosie. Kështu një nga shkaqet e kohës së gjatë është procedura e tejzgjatur e ekzekutimit të një letërporosie, e cila kalon nëpërmjet organeve qendrore (MD dhe Prokuroria e Përgjithshme). Rëndom ndodh në praktikë, që njoftimet e thirrjeve për personat që kërkohen të pyeten nga shteti i huaj vijnë në organin ekzekutues vetëm pak ditë para datës së caktuar për t’u paraqitur nga autoriteti përgjegjës i huaj, kohë kjo e pamjaftueshme për të kryer procedurat e njoftimit, ose më keq akoma, pasi ka kaluar data në fjalë. Mungesa e adresave të sakta ndikon në procedurat e tejzgjatura gjithashtu. Në Shqipëri nuk ka një regjistrim të adresave të sakta të

vendbanimit të popullsisë. Në të njëjtën kohë, edhe pyetja e shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë shtetit mund të zgjasë ose nuk kryhet fare për shkak të mungesës së adresave të sakta të vendbanimeve të tyre në shtetin përkatës.

Një shkak tjetër i rëndësishëm, që ndikon edhe në zgjatjen e kohës së përfundimit të një çështjeje penale kur në të duhen marrë prova nëpërmjet një letërporosie ndërkombëtare jashtë shtetit është rasti i rikërkimit të informacioneve plotësues, që del i nevojshëm pas letërporosisë së parë. Ky shkak lidhet me dinamikën e hetimit, e cila mund të sjellë rrethana të reja apo të dhëna të mëtejshme për të njëjtin rast, apo të rrethanave që rezultojnë nga provat e marra me letërporosi. Përveç këtyre rrethanave objektive, këtu ndikojnë edhe ngarkesa në punë apo mungesa e profesionalizmit. Shpesh për shkak të ngarkesës në punë, letërporositë hartohen me nxitim, duke anashkaluar apo harruar një a më shumë rrethana për të cilat duhet kërkuar informacion. Nga ana tjetër, mungesa e profesionalizmit bën që letërporositë të mos hartohen me një gjuhë të përshtatshme për të bërë të qartë atë që kërkohet nga letërporosia apo në mënyrë të plotë, duke e bërë të qartë bazën ligjore përkatëse dhe mënyrën e marrjes së një prove të caktuar. Kjo gjë mund të shoqërohet me pavlefshmëri apo papërdorshmëri të provave. Vlen të përmendet këtu edhe mungesa e profesionalizmit të përkthyesve, të cilët shpesh nuk janë të mirinformuar për përdorimin e termave ligjorë të duhur, gjë që mund të çojë në kuptim të gabuar të letërporosisë.

Le t'i kthehemi shkakut të ngarkesës në punë, që është një nga më të rëndësishmit dhe që është përmendur pothuajse nga të gjithë të pyeturit nga organet e prokurorisë dhe gjykatës. Ky është një shkak që qëndron, për arsye se në Shqipëri letërporositë ekzekutohen apo kërkohen nga prokuroritë dhe gjykatat e niveleve të shkallëve të para, ku realisht ngarkesa e punës është edhe më e madhe. Megjithatë, ky është më tepër një shkak subjektiv, që lidhet me çështjen e vlerësimit të letërporosisë si një mjet për marrjen e provës dhe përparësive që ka çdokush në punën e tij. Kuptohet që në punën e përditshme prokurorët dhe gjyqtarët kanë prioritet çështjet që ata ndjekin dhe ekzekutimi i një letërporosie paraqitet si një “bezdi” apo punë shtesë, ekzekutimin e së cilës ata gjithnjë mund ta shtyjnë për të nesërmen. Kjo gjë lidhet ngushtë edhe me shkaqet e tjera të përmendura, siç janë: mungesa e afateve për përmbushjen e një letërporosie apo mungesa e sanksioneve të akteve ndërkombëtare në rastet e moszekutimit të një letërporosie. Është në psikologjinë e çdo njeriu që e kryen diçka kur është i detyruar ta bëjë atë. Për rrjedhojë, afatet apo sanksionet do të detyronin çdo gjyqtar apo prokuror të vlerësonin një letërporosi ashtu si edhe çështjet penale që kanë në ngarkim. Për më tepër, në Shqipëri, duke i shtuar kësaj faktin, që ekzekutimet e një letërporosie janë thjesht një numër në ngarkesën e punës së një gjyqtari apo prokurori, cilësia e të cilëve nuk analizohet dhe nuk bën pjesë në vlerësimin e tyre profesional.

Mungesa e përpikmërisë në përmbushjen e çka kërkohet nëpërmjet një letërporosie është një shkak tjetër i përmendur nga një pjesë e të pyeturve, që lidhet më së shumti me

ngarkesën në punë, siç u shpjegua më lart, mungesën e profesionalizmit apo të informacionit nga organet ekzekutuese të letërporosisë dhe ndryshimin e legjislacionit midis shtetit kërkues dhe atij ekzekutues të letërporosisë.

Mungesa e profesionalizmit është një fenomen i njohur, sidomos në organet shqiptare të drejtësisë. Ka mendime që ky fenomen lidhet pjesërisht me faktin që në këto organe punojnë persona të diplomuar para ndryshimeve të viteve '90 apo që kanë ndjekur llojet e arsimeve pa shkëputje nga puna, gjithsesi kjo nuk duhet përgjithësuar. Edhe trainimet e vazhdueshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ndërmarrë nga Shkolla e Magjistraturës jo në çdo rast janë efektive. Këto trainime përdoren shpesh nga pjesëmarrësit gjyqtarë e prokurorë thjesht për t'u shkëputur nga rutina e punës së përditshme, apo formalisht për të marrë dëshmitë e duhura për vlerësimin e tyre profesional. Shpesh materialet e referuara në këto trainime lënë për të dëshiruar në nivelin e tyre kërkimor shkencor, sidomos nga lektorët shqiptarë, të cilët përdorin leksione të nivelit të aditorëve të universiteteve, pa bërë të mundur të tërheqin vëmendjen e të trainuarve. Këto trainime duhet të shtrihen jo vetëm në aspekte teorike apo të zbërthimit të ligjeve, gjë që në fund të fundit mund ta bëjë çdo jurist me arsimim bazë, por të jenë më praktikë, me raste konkrete që mbeten më thjesht në mendjet e të trainuarve e më pas të përdoren prej tyre në punën e përditshme. Pavarësisht nga sa u përmend, fakt është që jo të gjithë gjyqtarët apo prokurorët kanë të njëjtin nivel profesional, të njëjtin interes ndaj përgatitjes së tyre teorike, studimit të bazës ligjore apo

praktikave gjyqësore të gjykatave të tjera. Kjo gjë shoqërohet me proceduara të gabuara të ndjekura, që shoqërohen me pavlefshmëri të provave të marra me letërporosi.

Të tilla janë disa praktika të gabuara nga gjykatat, në lidhje me: marrjen e vendimit në favor të ekzekutimit të letërporosive, i cili duhet të merret nga gjykata në fillim të procesit dhe para procedimit me marrjen e provave të kërkuara me letërporosi dhe jo më pas; marrjen e provave, gjë që duhet të bëhet nga gjykata dhe jo nëpërmjet delegimit të tyre prokurorit; mosnjoftimin e Ministrisë së Drejtësisë në rastet e komunikimit të drejtpërdrejtë me autoritetet e huaja; pranimin si prova të akteve të marra jashtë shtetit nga mbrojtësit apo të pandehurit, ndërkohë që autoritetet e marrjes së këtyre provave janë vetëm gjykatat dhe prokuroritë nëpërmjet letërporosive të drejtuara autoriteteve përkatës të huaj, etj. (Islami et al, 2012: 780 – 785)

Të gjitha këto lidhen edhe me faktin që letërporositë ndërkombëtare janë procese që kanë filluar të zbatohen në fund të viteve '90 në Shqipëri dhe ato janë shtuar më tepër vetëm në vitet e fundit, siç do të analizohet në të dhënat e raporteve. Faktor tjetër është edhe fakti, që në Shqipëri për ekzekutimin e një letërporosie mund të ngarkohet çdo prokuror ose gjyqtar në shkallët e para të gjykimeve. Krijimi i prokurorisë dhe gjykatës së krimeve të rënda e ka zgjidhur problemin përse i përket ekzekutimit të letërporosive në lidhje me krime në kompetencë të tyre. Përse i përket krimeve të tjera, problemi mbetet i pazgjidhur, për aq kohë sa ekzekutimi i letërporosive nuk kryhet nga persona të specializuar për to. Përkundrazi, ekzekutimi i një letërporosie të ardhur nga jashtë, apo kërkesa për një letërporosi mundet të jetë edhe një rast sporadik, një herë në disa vjet, gjë që sjell ndërthurjen e të gjithë faktorëve që u përmendën deri më tani.

Mungesa e mjeteve financiare apo e infrastrukturës mbetet një shkak tjetër i rëndësishëm që ndikon në mosefektshmërinë e letërporosive ndërkombëtare. Kjo mungesë është e dukshme edhe në mjetet më elementare, gjë që lidhet edhe me “mungesën e informacionit

nga gjyqtarët apo prokurorët, të cilët për arsye të mungesës së fondeve, nuk marrin as fletoret zyrtare, që përbën një detyrim ligjor sipas ligjit nr. 8265 datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” (Fletore zyrtare nr. 19, 1997:453). Shqipëria ka treguar vullnet të mirë për ratifikimin e akteve ndërkombëtare bashkëkohorë, me qëllimin për t’u integruar në Europë dhe për t’u bërë pjesë e saj, por është një shtet jo i fuqishëm dhe mungojnë mjetet financiare për të marrë pjesë në mënyrë eficiente në kryerje veprimesh hetimore. Kjo gjë përbën pengesa për pjesëmarrjet e autoriteteve shqiptare të hetimit apo gjyqimit të çështjeve penale në veprime të caktuara hetimore komplekse që duhen kryer jashtë shtetit, apo në skuadra të përbashkëta hetimore me shtetet të tjera. Në të njëjtën kohë, pavarësisht përparimeve të dukshme që ka bërë Shqipëria, duke pasur parasysh edhe asistencën teknike e financiare të ndërkombëtarëve, ka mungesë të theksuar të mjeteve të infrastrukturës, sidomos për veprime të tilla, si pyetja me videokonferenca, hetimet sekrete, etj.

Vlen të theksohet, se me rastin e ratifikimit të protokollit të dytë shtesë të Konventës “për ndihmën e ndërsjellë në fushën penale”, nuk është treguar kujdes në evidentimin e problematikës së gjerë që ajo mbulon dhe sa e avancuar dhe detyruese bëhet ajo pas ratifikimit. Kështu, megjithëse ka pasur vend për mjaft deklarime dhe për ndonjë rezervim, një gjë e tillë nuk është bërë edhe për dispozita që vetë e kërkojnë një gjë të tillë dhe që janë të domosdoshme për vetë aplikimin e protokollit dhe të konventës. Dispozita të kësaj natyre janë nenet 6, 9, 11, 13, 18, 19, 26 dhe 27, të cilat kanë të bëjnë me deklaratimet e autoriteteve kompetente për rastet e veçanta të veprimeve që kërkojnë të kryhen mes shteteve, me video – konferencat, me transferimin e përkohshëm të personave të paraburgosur, me hetimet sekrete, etj. Duhet thënë se Shqipëria është vendi i dytë që e ka ratifikuar këtë protokoll, duke treguar nga njëra anë vullnetin e mirë për të bashkëpunuar me vende të tjera, por, nga ana tjetër, shpejtësia për t’u bërë palë në të nuk duhej të ndikonte në cilësinë e ratifikimit. Janë mjaft vende të zhvilluara evropiane që janë edhe iniciatore dhe përpunuese të vetë protokollit, por që, për shkak të elementeve shumë të përparuara të ofrimit të ndihmës që parashikohet, bëjnë kujdes të

ratifikojnë atë në mënyrë që të jetë realisht e aplikueshme dhe të shmangin probleme që mund të lindin në praktikë për shkak të instrumenteve të ratifikimit. (Islami et al, 2012:789-790)

Mungesa e detyrueshmërisë së akteve ndërkombëtare nuk duhet konsideruar si shkak, pavarësisht se është përmendur nga të pyeturit. Kjo për arsye, se për aq kohë sa aktet ndërkombëtare të pranuar nga shteti janë pjesë e së drejtës së brendshme, bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, pranuar edhe nga Kushtetuta e RSh-së, ato marrin fuqi detyruese ashtu sikurse edhe e drejta shqiptare.

Për pyetjen “A është e nevojshme të bëhen ndryshime të legjislacionit penal shqiptar në këtë fushë?”, 63 të pyetur nuk kanë shprehur mendim, 93 prej tyre janë përgjigjur me “jo” dhe vetëm 46 janë përgjigjur me “po”¹⁴. Më tej, në pyetjen specifike “Çfarë ndryshimesh mendoni se duhen bërë në legjislacionin penal shqiptar në këtë fushë?”, 80% e personave që kanë rrethuar opsionin “Nuk kam mendim”, janë shprehur, se nuk e kanë menduar dhe nuk shprehen për një gjë të tillë, për aq kohë sa kjo gjë nuk i kërkohet fare nga ligjvënësit, apo u kërkohet krejt formalisht.

11 të pyetur kanë dhënë mendime mbi përcaktimin e afateve në legjislacionin kombëtar për sa i përket ekzekutimit të letërporosive, për arsye se vonesat e tyre i sjellin dëme të pariparueshëm hetimeve. Kjo do të ishte pozitive në drejtim të ekzekutimit të letërporosive të huaja, por ato të ekzekutuara nga të huajt gjithsesi do t'i mbeteshin ekzistencës së

¹⁴ **Shënim:** Referoju të dhënave për pyetjen 5 në tabelën 4

vullnetit të mirë. Nga ana tjetër, vendosja e afateve për procedurat në lidhje me ekstradimet, e kanë bërë këtë institut mjaft të efektshëm.

9 të pyetur kanë dhënë mendime që duhet ndryshuar Kodi i Procedurës Penale, ku të përfshihen edhe dispozitat që kanë ligjet e tjera për shkak të shumicës së cilësuar që duhet për miratimin e tij në parlament. Ky është një mendim jo i drejtë, duke u nisur nga fakti që aktet ndërkombëtare marrin përparësi dhe bëhen pjesë e së drejtës së brendshme sipas parimeve kushtetuese. Për rrjedhojë, pak rëndësi ka se në ç'ligj të brendshëm përfshihen parashikimet e tyre. Për më tepër edhe në legjislacione të shteteve të tjerë të përparuar është ndjekur e njejta linjë. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh dinamikën e gjere dhe shumëllojshmërinë e akteve ndërkombëtare të ratifikuara, do të ishte e pamundur që ato të përfshiheshin tërësisht në të drejtën e brendshme.

Vlen të theksohet këtu, që 60 persona që kanë dhënë mendimin që nuk është i nevojshëm ndryshimi i legjislacionit të fushës objekt studimi, kanë shprehur mendime në lidhje me botim të përmbledhjes së ligjeve dhe manualeve në lidhje me ekzekutimin e letërporosive, për ta bërë më të lehtë punën e tyre si dhe më të efektshëm aplikimin e legjislacionit nga gjyqtarët dhe prokurorët.

Për pyetjen “A mund të sugjeroni ndonjë mjet më efektiv në këtë fushë, sipas mendimit tuaj apo praktikave më të përparuara nga bota që mund të njihen nga ju?”, 92 të pyetur janë përgjigjur se nuk kanë informacion, 45 prej tyre kanë dhënë sugjerime, ndërsa 65 prej tyre

jo¹⁵. Megjithatë, kjo pyetje është plotësuar më pas me përgjigjet e pyetjes “Nëse mundeni, përmendni raste të suksesshme të kësaj fushe nga praktika juaj, kolegëve tuaj apo institucionit ku ju bëni/keni bërë pjesë”, ku rreth 72% e të pyeturve kanë përmendur minimalisht një rast të sukseshëm nga praktika e tyre ose e kolegëve apo nga njohuritë e tyre. Këto raste kryesisht lidhen me ekstradimin e kriminelëve, apo me suksesin e hetimeve të procedimeve penale nga marrja e provave nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare. Ndër sugjerimet e dhëna për metodat e efektshme janë:

- Krijimi i grupeve të përbashkëta hetimore nga shtete të ndryshëm, me qëllim grumbullimin e provave dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të veprave penale (15);
- Mundësia e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis institucioneve të hetimit të shteteve të ndryshëm (19) me persona kontakti për marrjen e të dhënave minimalisht paraprake, duke shmangur rrugën e gjatë të dërgimit të një letërporosie dhe procedurave të gjata në të cilat kalon ajo.
- Letërporositë të ekzekutohen nga prokuroritë dhe gjykatat e apeleve (12). Ky përbën një mendim të logjikshëm, pasi përqëndrimi i ekzekutimit të letërporosive siç u përmend më lart, do të shoqërohej me rritje të nivelit profesional të

¹⁵ **Shënim:** Referoju të dhënavë për pyetjen 6 në tabelën 4

autoriteteve që e ekzekutojnë një letërporosi, për arsye se ajo do të ishte në shtrirje më të madhe pjesë e punës së tyre.

- Krijim i seksioneve të veçanta brenda prokurorive apo gjykatave të shkallëve të para (9). Ky mendim është deri diku i pranueshëm, duke vazhduar idenë e specializimit të prokurorëve apo gjyqtarëve që merren me letërporositë ndërkombëtare apo marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në përgjithësi. Kjo gjë është më e arritshme në organin e prokurorisë, ku është aplikuar edhe ndarja e seksioneve për hetimin e grup veprave penale të caktuara në prokuroritë më të mëdha të shkallëve të para. Megjithatë, justifikimi i krijimit të një seksioni të tillë, do të ishte një numër i konsiderueshëm letërporosish apo raste të marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal. Sidoqoftë, kjo do të ishte një zgjidhje për letërporositë nga jashtë shtetit, por jo ato për jashtë shtetit, për arsye se në rastet e çështjeve penale, ku lind nevoja e marrjes së provave të caktuara nëpërmjet letërporosive të drejtuara autoriteteve kompetente të huaja, janë vetëm prokurorët që i ndjekin këto çështje ata që i njohin problematikat e tyre dhe e dinë se çfarë kanë qëllim të kërkojnë nga një letërporosi. Gjithsesi, prokurorët e çështjeve janë vetëm ata që i hartojnë letërporositë për jashtë, për arsye se ato janë në kompetencë të drejtuesit të prokurorisë, i cili i nënshkruan dhe në njëfarë mënyre kontrollon anën formale të tyre. Për sa i përket gjykatave të shkallëve të para, krijimi i seksioneve të tilla mund të ishte i mundur vetëm në gjykatat e

mëdha, ku minimalisht ka dy trupa gjykues penalë dhe seksioni të përfshinte së paku dy gjyqtarë, të cilët t'i merrnin çështjet në bazë të shortit, duke pasur parasysh parimin e një gjykimi të paanshëm. Megjithatë, në përgjithësi, do të ishte e udhës që kërkesat në lidhje me letërporositë të shqyrtoheshin nga seksionet penale dhe jo të trajtohen si çështje administrativo – penale e të shqyrtohen nga seksionet civile të gjykatave. E thënë kjo për faktin, se si njoftimi i akteve të caktuara, për më tepër marrja e provave për efekte të një letërporosie të huaj, kryhen duke respektuar dispozitat e legjislacionit të brendshëm penal, përveç kërkesave të tjera të veçanta që mund të përmbajë vetë letërporosia.

Në përmbledhje të kësaj analize, vërehen këto përfundime:

- Shumica e të pyeturve që përbën mbi 55% të tyre mendon, se legjislacioni shqiptar është i plotë në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, ndërkohë që edhe 23% e tyre nuk mendojnë që legjislacioni shqiptar nuk është i plotë, por mendojnë se shteti shqiptar duhet të shtojë marrëveshjet me shtetet e tjera për bashkëpunim;
- Shumica e të pyeturve që përbën mbi 63% të tyre mendojnë, se procedurat aktuale ligjore të ndihmës së ndërsjellë juridike si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procedimin e çështjeve penale nuk janë efektive.

b) Pyetsori i personave të huaj

Gjatë punës së këtij studimi janë marrë opinione nga 44 të huaj, duke shfrytëzuar pjesëmarrjen në disa trainime, konferenca dhe projekte brenda dhe jashtë Shqipërisë. 25 persona janë pyetur drejtpërsëdrejti, ndërsa 19 janë kontaktuar nëpërmjet e-mailit, duke i dërguar pyetjet në formën e pyetsorit që është përfshirë në shtojcat e këtij studimi. Pyetsori është hartuar në gjuhën angleze. Të pyeturit janë nga rradhët e gjyqtarëve, prokurorëve, oficerëve të policive gjyqësore, organeve qendrore të policive dhe studiuesve nga shtete të ndryshëm, të cilët paraqiten në mënyrë tabelare më poshtë.

Tabela 6 Të pyeturit e huaj, specifikuar sipas grup profesioneve dhe shteteve

Shteti	Gjyqtarë	Prokurorë	Of. Pol. Gjyqs.	Org.qëndrore të policisë	Studiues
Angli				1	
Austri	2	2	2	3	2
Bullgari				1	
Estonia		1			
Francë		1	1	1	
Gjermani			1	2	1
Hollandë	1				
Latvia		1			
Poloni			1	1	
Qipro				1	
Rumania			1	1	
Serbia			1	1	
Slovakia		1			
Slovenia		2	1	1	
Spanja	2	2	1	2	
Suedi		1			
Zvicër		1		1	

Pyetsori i drejtuar personave të huaj në fillim të tij përmbante informacion mbi temën e studimit dhe kontaktet me personin që bënte pyetsorin. Në hyrjen e tij tregohet se pyetsori bëhet me qëllim mbledhjen e opinioneve të specialistëve të fushës mbi efektivitetin

procedurave ligjore aktuale mbi bashkëpunimin ndërshtetëror në çështjet penale. Personave të pyetur u është bërë e ditur, se kërkoheshin mendime të tyre që do të përdreshin vetëm për efekte analize në studim dhe do ishin plotësisht konfidenciale, pa treguar identitetin e tyre.

Të pyeturve iu drejtuan tre pyetje, konkretisht:

Pyetja e parë: Sipas mendimit tuaj, a janë procedurat aktuale ligjore efektive në marrëdhëniet ndërkombëtare (ndërshtetërore) në çështjet penale duke u fokusuar në letërporositë ndërkombëtare? Në përgjigje të kësaj pyetjeje 7 të pyetur mendonin që procedurat e përdorura për ekzekutimin e letërporosive janë efektive, 9 të pyetur mendonin se ato janë deri diku efektive, ndërsa 28 persona mendonin se nuk janë efektive. 17 prej këtyre të fundit paraqisnin disa shkaqe për mungesën e efektivitetit, më konkretisht:


- 1) Procedurat e tejzgjatura që kalonin nëpërmjet organeve qendrore (Ministri e Drejtësisë, Prokurori e Përgjithshme ose Ministri e Brendshme);
- 2) Mungesa e dëshirës së mirë për përmbushjen e tyre;
- 3) Mungesa e përgjegjësisë në përmbushjen e tyre;
- 4) Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, e cila disponohet nga autorët e krimeve, i jep atyre avantazh për të kryer krime që shtrihen në disa shtete njëkohësisht, si dhe të jenë disa hapa para mjeteve të përdorur nga organet e policisë apo drejtësisë, si dhe kërkesave për ndihmë juridike.

Këto shkaqe janë të qëndrueshme dhe janë pjesë edhe e shkaqeve që u analizuan në pyetsorin e personave shqiptarë. Fakt interesant ishte, se oficerët e policisë gjyqësore përmendnin si shkaqe edhe skepticizmin e gjyqtarëve për të dhënë vendime apo autorizime për kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore, sidomos për përgjimet dhe hetimet sekrete apo mungesën e bashkëpunimit më të mirë me prokurorinë (Slovenia, Serbia, Gjermania, Spanja). Këto shkaqe janë të kuptueshme nga ana e përfaqësuesve të policisë, të cilët me sa duket në të gjithë botën kanë të njëjtat pakënaqësi ndaj sistemit të drejtësisë. Në rast se do të shihej kjo çështje nga këndvështrimi i një juristi, veprimet që lidhen me përgjimet apo vëzhgimet e personave të ndryshëm, lidhen drejtpërdrejt me cënimin e një nga të drejtave themelore të njeriut, ajo e respektimit të jetës private dhe familjare, e parashikuar në nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut të datës 04.11.1950 (e amenduar me disa protokolle ndër vite), ku thuhet, se: “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij...” (Bianku, 2001:241). Është fakt që organet e policisë shumë shpesh kërkojnë vendime apo autorizime për lejimin e përgjimit apo vëzhgimit të personave të ndryshëm edhe pa pasur dyshime të arsyeshme, për më tepër të pambështetura në prova, gjë që ndodh rëndom edhe në Shqipëri. Gjithsesi, për aq kohë sa këto lloj veprimesh cënojnë një të drejtë themelore të njeriut, me të drejtë gjykatat dhe prokuroritë do të jenë skeptike në lejimin e veprimeve të tilla, duke pasur parasysh që përgjimet apo vëzhgimet të mos jenë indicie për veprën penale, por të shërbejnë për marrjen e një prove të caktuar dhe të vijnë si rrjedhojë e dyshimeve të

mbështetura në prova të tjera më parë, gjë që parashikohet në legjislacionet procedurale penale në disa shtete të botës.

Në përmbledhje të analizës, rezulton se rreth 64% e të pyeturve të huaj i konsiderojnë letërporositë ndërkombëtare jo të efektshme, rreth 20% e tyre disi të efektshme dhe 16% e tyre jo të efektshme, duke i pasqyruar të dhënat edhe në grafikun 5. Në këtë këndvështrim, 84% e të pyeturve të huaj nuk i konsiderojnë letërporositë ndërkombëtare si mjete të efektshme për marrjen e provave në çështjet penale.

Grafiku 5



Për pyetjen e dytë “A mund të përshkruani ndonjë praktikë të suksesshme të shtetit tuaj në këtë fushë?”, janë përmendur disa praktika, më konkretisht:

- JIT (Joint Investigation Team), skuadrat e përbashkëta hetimore (Franca, Spanja, Sllovenia);
- Përdorimi i database ndërkombëtare nga ku mund të gjenerohen të dhëna të ndryshme, që mund të ndihmojnë për indicje të ndryshme për hetimin (Spanja, Austria, Sllovakia, Anglia);
- Prokurorë të specializuar për ekzekutimin e letërporosive ndërkombëtare (Gjermania);

Për pyetjen e tretë “A mund të sugjeroni ndonjë mjet më të efektshëm në këtë fushë?”, janë dhënë këto përgjigje:

- JIT (Skuadrat e përbashkëta hetimore), të cilat do të shkurtonin kohën e humbur për të marrë të dhëna nëpërmjet letërporosive;
- Komunikimi i drejtpërdrejtë i prokurorëve apo hetuesve të shteteve të ndryshme, gjë që mund të ishte e thjeshtë për shtetet anëtare të BE-së;
- Specializimi i prokurorëve dhe gjykatëve që trajtojnë çështje të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;
- Krijimi i platformave të rrjeteve komunikuese të institucioneve, siç është përshembull EUROPOL, të cilat janë rrjete të sigurt, gjë që do të lejonte komunikimin ndërmjet tyre të autoriteteve nga shtete të ndryshëm;
- Krijimi i database me të dhëna, në të cilat të mund të kenë akses autoritetet nga shtete të ndryshme;

- Krijimi i një prokurorie ndërkombëtare për shtetet e BE-së;
- Krijimi i një legjislacioni unik penal për vendet e EU-së dhe përafrimi i tij edhe nga shtetet e tjera të EU-së.

5.2. Rezultatet e të dhënave në lidhje me letërporositë ndërkombëtare nga raportet dhe interpretimi i tyre

Për efekte të këtij studimi janë marrë të dhënat në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në raportet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm nga viti 2007 deri në vitin 2013, të publikuara nga Prokuroria e Përgjithshme e RSh-së, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7 Të dhënat në lidhje me letërporositë ndër vite (2007 – 2013)


Të dhënat	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Lp. nga jashtë	172	1086	1050	1094	1108	582	675
Lp. për jashtë	144					314	308

Nga studimi i këtyre të dhënave dhe paraqitja në mënyrë grafike më poshtë vërehet, se numri i letërporosive ndërkombëtare ka pasur një rritje të vrullshme nga viti 2007 në vitin 2008, duke u rritur më shumë se tre herë. Më pas në vitet në vazhdim, nga viti 2008 deri në vitin 2013 numri i tyre ka pasur një ecuri pothuajse konstante, me luhajtje të vogla, të ndikuara nga faktorë të ndryshëm.

Në rast se krahasojmë shifrat në lidhje me letërporositë nga viti 2007 deri në vitin 2013, duke i ndarë në letërporositë nga jashtë dhe ato për jashtë, vërehet se:

- Numri i letërporosive nga jashtë shtetit në vitin 2013 është rritur pothuajse 4 herë në krahasim me vitin 2007;
- Numri i letërporosive për jashtë shtetit në vitin 2013 është rritur më shumë se 2 herë në krahasim me vitin 2007.

Grafiku 6 Ndryshimi i numrit të letërporosive ndër vite (2007 – 2013)




Të njëjtat trende në rritje vihen re edhe për treguesit në lidhje me llojet e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, ekstradimit dhe njohjes së vendimeve penale të huaj.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat për vitet 2011, 2012 dhe 2013 në lidhje me llojet e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin penal, konkretisht: ekstradimin, njohjen e vendimeve penale dhe transferimin e procedimeve penale. Pavarësisht një rënieje

të lehtë të numrit të njohjes së vendimeve penale të huaj që vihen re në grafik, kjo rënie shpjegohet me rritjen e numrit të ekstradimeve për shkak të nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për ekstradimin me disa shtete, gjë që ka sjellë që të mos jetë e nevojshme të njihen vendimet penalë të huaj.

Grafiku 7 Trendi i numrit të letërporosive nga dhe për jashtë shtetit nga viti 2007 në vitin 2013




Kjo tendencë rritjeje, sidomos vitet e fundit lidhet me faktin, se veprimtaria kriminale, veçanërisht format e organizuara të saj, ka kaluar kufijtë kombëtarë, duke u bërë gjithnjë e më shumë problem rajonal dhe global. Këta tregues janë shprehje e rritjes së

bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe rritje e besueshmërisë në sistemin gjyqësor në Shqipëri.

Në raportin vjetor të vitit 2013 mbi gjendjen e kriminalitetit të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton, se gjatë vitit 2013, gjithashtu është konstatuar shtim i rasteve të bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me strukturat homologe të vendeve fqinje, të vendeve anëtare të BE-së dhe me SHBA.

Grafiku 8 Trendi i llojeve të ndihmës së ndërsjellë juridike 2011 – 2013



Për sa i përket letërporosive ndërkombëtare, bashkëpunimi është më i gjerë me vendet kufitare: Greqi, Kosovë, Itali, Maqedoni. Megjithatë, ky bashkëpunim shtrihet edhe me mjaft shtete të tjera të Europës: Gjermani, Zvicër, Turqi, Belgjikë, Francë, Angli, etj, si

edhe më SHBA. Vlen të përmendet fakti, që në vitin 2013 ka pasur 2 kërkesa për ndihmë juridike edhe nga EUROPOL dhe EUROJUST. Si arritje është përmendur krijimi i pikave të kontaktit me strukturat ndërkombëtare si EUROJUST (Njësia e bashkëpunimit gjyqësor të BE-së), SEEPAG (Grupi i këshillimit të prokurorëve të Europës Juglindore), etj. Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtete të ndryshme dhe rezultatet pozitive në bashkëpunimet me ta kanë ndikuar në forcimin e imazhit të institucioneve shqiptare, duke shtuar shkëmbimin e informacionit për shtetas shqiptarë e të huaj, të përfshirë në trafikë të paligjshme.

Po në këtë raport, Prokurori i Përgjithshëm thekson, se Komisioni European në vlerësimet për vitin 2013 ka vlerësuar si pozitive për luftën kundër krimit të organizuar, ndër të tjera forcimin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Megjithatë raporti vlerëson, se krimi i organizuar mbetet një problem serioz dhe duhen përpjekje të mëtejshme, duke adresuar ndër të tjera rritjen thelbësore të hetimeve pro-aktive për pasuritë e vendosura nga aktiviteti kriminal jashtë shtetit dhe të ri-investuara në Shqipëri. Në letrën e Komisionerit European për zgjerimin, dërguar vendeve anëtare të BE-së pak ditë para mbledhjes së Dhjetorit 2013 për diskutimin e çështjes së statusit kandidat të Shqipërisë, në argumentat pro dhënies së statusit kandidat për Shqipërinë është përmendur roli i organit të prokurorisë, për të cilin vlerësohen si arritje, ndër të tjera:

- Bashkëpunimi i autoriteteve shqiptare, përfshirë prokurorinë, në disa aksione të përbashkëta të drejtuara nga EUROPOL për shkatërrimin e disa bandave kriminale;
- Shtimin e numrit të ekstradimeve.

Në lidhje me letërporositë ndërkombëtare, në raportet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm janë përmendur si problematika:

1. Vështirësi e hetimit të çështjeve personave që kanë kryer vepra penale jashtë shtetit, për arsye se dëshmitë, provat dhe gjithçka që lidhet me ngjarjet kriminale ndodhen jashtë territorit të RSh-së kosto e papërbalueshme për këto lloj hetimesh.
2. Vështirësi e ekzekutimit të letërporosive me objekt kthimin e mjeteve motorrike të vjedhura pronarëve të ligjshëm, për shkak se legjislacioni nuk parashikon qartë mënyrën se si duhet të procedohet në raste të tilla. Ndryshimet përkatëse në legjislacion do të passillnin unifikimin e praktikës dhe ekzekutimin e letërporosive.
3. Probleme me përkthimin e akteve që shoqërohen me vonesa të shumta.

Për sa i përket problemit të parë, ky është një problem ekzistent, sidomos për Shqipërinë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare që u analizua edhe në çështjet e mëparshme të këtij kapitulli.

Problemi i dytë lidhet me ndryshimet që duhet të bëhen në legjislacion, në lidhje me kthimin e sendeve të sekuestruara, gjë që nuk është bërë deri më tani, pavarësisht propozimeve të bëra nga organi i Prokurorisë. Këto propozime duhet të ripërsëriten derisa

të tërheqin vëmendjen e politikës për të miratuar ndryshimet përkatëse të legjislacionit, ose nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe.

Problemi i tretë është zgjidhur nga MD gjatë vitit 2014, e cila merr përsipër përkthimin e akteve të dërguara me letërporosi.

5.3. Efektiviteti i letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal

Në ditët e sotme, me zhvillimet e mëdha të teknologjisë dhe rritjen e krimit të organizuar me shtrirje tej nacionales, është e pamundur që qëllimi i rëndësishëm i shteteve për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe rendit publik të arrihet brenda kufijve kombëtare. Hetimi, gjykimi dhe ndëshkimi i autorëve që i kryejnë veprimet e tyre kriminale në disa shtete, mund të arrihet vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm midis autoriteteve përkatëse të shteteve.

Për këtë arsye, ndihma e ndërsjellë midis shteteve në fushën gjyqësore është një fenomen në rritje me shpejtësi. Letërporositë ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja janë një mundësi e mirë bashkëpunimi midis shteteve për arritjen e këtij qëllimi të rëndësishëm.

Rezultati është që rastet e rralla kur ndihma nga një shtet tjetër ishte e nevojshme për të marrë prova ose për të lokalizuar apo kthyer një të akuzuar nuk është më diçka e rrallë. Gjithnjë e më shumë hëtimi i suksesshëm, veçanërisht i krimeve në lidhje me lëndët narkotike, krimet ekonomike dhe të pastrimit të parave, varet nga ndihma dhe bashkëpunimi me shtetet e tjera. Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale për nga niveli praktik është bërë tashmë i vjetër. (Prost, 2012)

Më parë ka ekzistuar ndihma midis shteteve në mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave që kanë shërbyer për veprime operative të policisë dhe hetime paraprake të prokurorisë. Tashmë janë krijuar lidhje të qëndrueshme midis organeve të policisë së shteteve të ndryshëm, që shkëmbejnë informacione, ku përfshihen që nga lidhjet e drejtpërdrejta midis oficerëve të policisë, deri tek oficerët ndërlidhës të policisë dhe organizime të tilla si INTERPOL, EUROJUST apo EUROPOL. Këto informacione janë tepër të vlefshëm, por nuk mund të përdoren si prova të pranueshme dhe të vlefshme juridikisht në gjykimet penale, nëse nuk merren në rrugën e duhur ligjore, gjë që mund të arrihet nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare.

Një nga avantazhet më të mëdha të kësaj forme bashkëpunimi është që ajo mbulon një fushë të gjerë ndihme, për të marrë të dhëna ose deklarime nga personat, për kërkime, kontrolle dhe sekuestime, për marrjen e dokumentave ose provave materiale... (Prost, 2012)

Pavarësisht vlerave dhe rëndësisë së tyre, është për t'u diskutuar fakti i efektshmërisë së letërporosive ndërkombëtare. Duke iu kthyer analizës së bërë në kapitullin VI të këtij studimi, nga 246 të pyeturve gjithsej, shqiptarë e të huaj, 165 prej tyre, që përbëjnë 67% të të pyeturve, kanë shprehur mendimin që letërporositë ndërkombëtare nuk janë të efektshme sa duhet. Nga analiza e shkaqeve të renditura dhe të analizuara në lidhje me mosefektshmërinë e letërporosive ndërkombëtare, mund të thuhet me plot gojën që letërporositë ndërkombëtare, të cilat transmetohen në rrugë diplomatike, nuk janë një mjet mjaftueshëm i efektshëm në kohët e sotme moderne, ku është gjithnjë e në rritje kërkesa për një bashkëpunim të shpejtë dhe të efektshëm në grumbullimin e provave për një çështje

penale. Letërporositë shpesh nuk arrijnë të përmbushin qëllimin e ndihmës së kërkuar. Edhe nëse e arrijnë përmbushjen e qëllimit, këtë gjë nuk e bëjnë në një periudhë kohe të arsyeshme. Shkaku themelor për mungesën e efektivitetit të letërporosive është ndryshimi i legjislacioneve penale nga njëri shtet në tjetrin.

Në përmbledhje të analizës në çështjen 5.1 të këtij studimi dhe duke e çuar më tej atë, që një letërporosi ndërkombëtare të jetë e efektshme, duhet të plotësohen këto kushte:

1) Ekzekutimi efektiv

Letërporositë ndërkombëtare e kanë bazën e tyre ligjore në Konventën e KE mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në procesin penal të vitit 1959. Ajo përbënte një arritje për kohën, duke njohur faktin e domosdoshmërisë së bashkëpunimit në mbledhjen e provave në proceset penale, por si çdo instrument i ri ajo kishte limitimet e saj, ku më i dukshmi ishte ndryshimi i legjislacioneve midis shteteve. Megjithatë, ky boshllëk u plotësua me marrëveshjet ndërkombëtare midis shteteve, që pasuan këtë Konventë.

Zhvillimet e vrullshme në gjysmën e dytë të shekullit XX treguan që parashikimet në lidhje me to në Konventë kishin mangësi të shumta dhe nuk i përgjigjeshin kërkesave të kohës. Kjo gjë u shoqërua me nxjerrjen e protokollit të dytë shtesë të saj në 08.11.2001, ku u përfshinë mjete të tjera të reja të bashkëpunimit. Pavarësisht këtij kuadri normativ të plotë, në praktikë shfaqen ende shumë probleme.

Gjithsesi, sado i plotë të jetë rrjeti i marrëveshjeve ndërkombëtarë, sado të mirëparashikuara të jenë mënyrat dhe instrumentat e bashkëpunimit, asnjë prej këtyre nuk ka vlerë nëse nuk

është e mundur që kërkesa për ndihmë dhe marrje provash të paraqitet në një formë të pranueshme, efektive dhe në një kohë kohë të arsyeshme. (Prost, 2012)

Në këtë këndvështrim, mungesa e programeve dhe procedurave bashkëkohore për ekzekutimin e letërporosive ndërkombëtare dhe marrjen e provave për një proces penal, në mënyrë praktike, rast pas rasti, bën që letërporositë ndërkombëtare të mos jenë mjaftueshëm të efektshme. Në këto kushte, vetë shtetet në marrëveshje midis tyre mund të miratojnë një legjislacion të përshtatshëm, të negociojnë midis tyre për instrumentat e nevojshëm dhe problemet administrative që lindin gjatë ekzekutimit të letërporosive, sidomos duke e përqëndruar ekzekutimin e tyre në një autoritet të vetëm. Por, një zbatim efektiv i tyre nuk mjafton vetëm me legjislacionin dhe administrimin e mirë, sepse suksesi i tyre varet nga fakti se sa të mirë janë njerëzit që veprojnë në ekzekutimin e tyre në mënyrë praktike. Këta njerëz duhet të jenë të aftë që të kalojnë vështirësitë e ndryshimit të legjislacioneve midis shteteve, ta ekzekutojnë një letërporosi në përputhje me kërkesat ligjore të shtetit kërkues dhe në mënyrat e parashikuara prej tij, pa iu referuar procedurave ligjore të shtetit ekzekutues, përveç rasteve të ndaluar me ligj. Duhet kuptuar që letërporosia duhet të jetë e përdorshme për shtetin kërkues, gjë që kërkon fleksibilitet në përmbushjen e saj.

Sipas Kodit të sjelljes për përgjegjësit e zbatimit të ligjeve të miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 27 dhjetor 1979 (rezoluta 34/169) çdo përgjegjës për zbatimin e ligjeve është një element i sistemit të drejtësisë penale, që ka për qëllim të

parandalojë krimin dhe të luftojë kundër kriminalitetit (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 1994:195). Në këtë kuptim, çdo punonjës i sistemit të drejtësisë apo autoritet që përfshihet në ekzekutimin e një letërporosie ka rolin e tij në efektivitetin e saj.

2) Informacioni i mjaftueshëm

Që një letërporosi të ekzekutohet në mënyrë efektive duhet të përmbajë informacionin e mjaftueshëm jo vetëm për sa kërkohet në të, por edhe për sa parashikon legjislacioni i shtetit kërkues për veprimin përkatës që kërkohet në letërporosi.

Ajo çfarë përmbajnë këto dokumenta është e rëndësishme për efektivitetin e tyre. Koha është esenca, procedurat mund të jenë në ndjekje e sipër, autori i arrestuar dhe datat gjyqësore të caktuara. Në të kundërt, asnjë autoritet nuk do të ishte në gjendje të ekzekutonte një letërporosi pa e kthyer mbrapsht atë, duke humbur kështu shumë kohë të vlefshme. (Bolt, 1993:1911)

Megjithatë ky informacion nuk mund të përfshihet plotësisht në mënyrë të shkruar. Është e domosdoshme që përveç kësaj personi që do të ekzekutojë letërporosinë të ketë mënyra të tjera mbështetëse për informim. Disa rekomandime të përmbledhura janë të mundura dhe mjaft të efektshme. Megjithatë, burimi i parë i informacionit është marrëveshja midis dy shteteve që përfshihen në letërporosi. Në mungesë të saj, informacioni mund të merret në autoritetin qendror të shtetit përkatës dhe në shumë raste mënyra më efektive e marrjes së informacionit është komunikimi drejtpërdrejt midis autoriteteve kompetente të të dy shteteve.

Që informacioni i dërguar nëpërmjet një letërporosie të jetë i mjaftueshëm, duhet që: në një letërporosi të përfshihet shpjegimi i një koncepti apo instituti juridik, për arsye të

ndryshimeve të legjislacionit në shtete të ndryshme, siç u përmend më parë; përveç informacionit të përgjithshëm mbi çështjen penale, është e rëndësishme të pasqyrohet arsyeja përse kërkohet marrja e provës dhe rëndësia e saj për hetimin e çështjes penale në fjalë; të përcaktohet mirë prova që kërkohet dhe mënyra e marrjes së saj.

3) Vendosja e limiteve kohore

Që një letërporosi të jetë e efektshme ajo duhet të ekzekutohet në një kohë sa më të arsyeshme dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni i shtetit kërkues. Për këtë arsye shteti kërkues duhet të vendosë shënime të tilla si “Urgjent” apo “Tepër urgjent” apo limite kohore të arsyeshme.

Në përmbledhje të sa më sipër, mund të thuhet, se arrihet në këtë konkluzion:

Objektivi i së ardhmes lidhet me zbatimin efektiv të instrumentave të bashkëpunimit, të cilat janë zhvilluar deri më tani. Suksesi apo dështimi i ndihmës së ndërsjellë nuk mbështetet vetëm tek qeveritë, por autoritetet kompetente, siç janë prokurorët, që e ekzekutojnë dhe e ofrojnë ndihmën në nivelin praktik. (Prost, 2012)

Protokolli i dytë shtesë i datës 08.11.2001 i Konventës së KE-së mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në procesin penal të vitit 1959, ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në parashikimin e formave dhe mjeteve të reja të bashkëpunimit, midis të tjerave, mund të përmenden rastet e ndihmës së ndërsjellë të bëra drejtpërdrejt nga autoritetet kompetente të dy shteteve pa kaluar në rrugën diplomatike dhe skuadrat e përbashkëta hetimore.

Kapitulli VI: Përfundimet

6.1. Përmbledhje e koncepteve kryesore të studimit

Hipoteza për t'u vërtetuar në këtë studim ishte: **“Pavarësisht arritjeve në përpunimin e një kuadri juridik të plotë dhe të përshtatshëm përsa i përket zbatimit të letërporosive ndërkombëtare si një nga format e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, praktika dëshmon ende mangësi, kapërcimi i të cilave do të kërkonte përf forcimin e dijeve dhe përkushtimit për zbatimin e akteve dhe dispozitave ekzistuese apo edhe ndërhyrjen në legjislacion për plotësimin e vakumeve eventuale”**. Siç u parashtrua me hollësi më sipër, për të vërtetuar këtë hipotezë u ndërmor një punë studiuëse dhe hulumtuëse e gjatë dhe sistematike. U shqyrtuan një sërë aktesh ligjore, dokumentash e materialesh të fushës së marrëdhënieve me autoritetet e huaja në procesin penal, si dhe burime të literaturës bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhura me temën përkatëse.

Nga shqyrtimi i literaturës ekzistuese, studimi nxori në pah disa përfundime të qenësishme për vërtetimin e hipotezës, të cilat u krahasuan me gjetjet aktuale nëpërmjet metodave kërkimore shkencore sasiore dhe cilësore, që u pasuruan me interpretimet e përgjigjeve të pyetsorëve që u organizuan me 295 persona shqiptarë dhe të huaj.

Më poshtë janë renditur vetëm disa nga përfundimet më thelbësore që dolën nga ky studim.

- Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal përbëjnë një institut të së drejtës që ka lindur shumë më vonë se shteti dhe e drejta në përgjithësi. Megjithëse gjurmë

embrionale në trajtë tërësisht fillestare të marrëdhënieve juridiksionale gjenden në shekullin III p.e.r me lindjen e institutit të ekstradimit¹⁶, ato e fituan fizionominë e tyre në kuptimin e mirëfilltë në shekullin XX, duke u shtrirë në forma të reja të bashkëpunimit në procesin penal, midis të cilave letërporositë ndërkombëtare. Në këtë këndvështrim letërporositë ndërkombëtare janë një institut i ri i së drejtës.

- Pavarësisht se kanë lindur më herët, kushtëzuar nga zhvillimet politike e shoqërore, në Shqipëri marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal morën zhvillim real vetëm pas ndryshimeve demokratike që ndodhën në fillim të viteve '90. Nëse në botë marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja janë konsoliduar tashmë prej shumë kohësh, në Shqipëri nuk mund të thuhet që ato janë konsoliduar realisht në këtë periudhë pothuaj 25 vjeçare, ku marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal kanë fillimet e tyre praktike.
- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë ato marrëdhënie që krijohen ndërmjet shteteve mbi bazën e akteve ndërkombëtare shumëpalëshe ose dypalëshe. Ato janë një mundësi e mirë e ndërveprimit midis shteteve të ndryshëm në fushën penale, me qëllim final luftën sa më efektive kundër krimit, dhënien e drejtësisë dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale.

¹⁶ **Shënim:** Më tepër është trajtuar në faqen 25 të studimit

- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal ushtrohen në përputhje me kërkesat, procedurat dhe nga institucionet apo autoritetet e përcaktuara me ligj.
- Letërporositë ndërkombëtare mund të përkufizohen si forma të ndihmës së ndërsjellë juridike midis shteteve, nëpërmjet të cilave shtetet kërkuuese autorizojnë shtetet pritëse të letërporosive që të kryejnë veprime procedurale, në lidhje me marrjen e provave për efekte të procedimeve penale të shteteve kërkuuese.
- Një nga karakteristikat kryesore të sistemit të së drejtës ndërkombëtare sot është universaliteti i saj, si rrjedhim, edhe marrëdhëniet me autoritetet e huaja në procesin penal dhe letërporositë ndërkombëtare si pjesë e tyre kanë karakter universal.
- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal mund të ushtrohen vetëm me ekzistencën e vullnetit të mirë të palëve të përfshira në to.
- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal ushtrohen duke u mbështetur në parimet e reciprocitetit, konfidencialitetit, si dhe të respektimit të sovranitetit dhe sigurisë së shtetit.
- Bashkëpunimi në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal dhe në luftë kundër krimit me mjaft shtete ka ndihmuar fuqimisht në këtë fushë.
- Baza ligjore e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë nga njera anë akte ligjore të së drejtës shqiptare, ku përfshihen: Kushtetuta e RSh-

së, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe ligje të tjera; nga ana tjetër aktet ndërkombëtarë në këtë fushë. Sipas parimeve kushtetuese, aktet ndërkombëtare kanë prioritet ndaj të drejtës së brendshme. Në Kushtetutën e RSH është parashikuar që aktet ndërkombëtare bëhen pjesë e së drejtës së brendshme sipas nenit 116 të saj.¹⁷

Vërtetimi i hipotezës së studimit mbështetet në legjislacionin shqiptar, në legjislacionin ndërkombëtar, kryesisht Konventën e KE *“Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”* e datës 20 prill 1957 dhe dy protokollet e saj shtesë, si dhe në materiale studimore bashkëkohore kombëtare e të huaja, të cilat nga pikëpamje sasiore janë relativisht modeste. Në kapitullin IV është bërë një analizë e kujdesshme dhe e thellë krahasuese mbi trajtimin juridik të letërporosive ndërkombëtare në fushën penale në legjislacionin shqiptar në raport me aktet ndërkombëtare. Po në këtë kapitull është analizuar, se si përcaktimet e Konventës së KE-së *“Mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në procesin penal”* dhe dy protokolleve të saj shtesë janë pasqyruar edhe në legjislacionin e brendshëm penal shqiptar. Megjithatë, në këtë legjislacion nuk parashikohen disa aspekte të bashkëpunimit të ndërsjellë shtetëror dhe ekzekutimit të letërporosive ndërkombëtare penale, që parashikohen në Konventë dhe protokollet e saj shtesë.

Në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe me sa ka parashikuar specifikisht vetë Konventa, si dhe mbi bazën e parimeve kushtetuese të RSh-së-së, përcaktimet e akteve ndërkombëtarë mund të aplikohen nga autoritetet gjyqësore

¹⁷ **Shënim:** Për më tepër referoju pikës 3.4 në studim

edhe nëse ato nuk janë përfshirë në legjislacionin e brendshëm, me kusht të domosdoshëm që ato të mos bien ndesh apo të mos ndalohen nga legjislacioni i brendshëm i RSh, në rastin konkret atë penal apo procedural penal, në të njëjtën kohë të mos çënojnë sovranitetin e shtetit shqiptar. Në këtë këndvështrim, në përmbledhje të analizës së Kapitullit IV, mund të arrihet në konkluzionin se kuadri ligjor i parashikimeve për letërporositë ndërkombëtare penale në Shqipëri është relativisht i plotë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë studim është edhe analiza krahasuese e trajtimit juridik të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal në Shqipëri dhe në disa shtete të tjera. Konkretisht janë zgjedhur Italia, si një vend anëtar i BE-së dhe me një të drejtë të lashtë e të zhvilluar dhe Maqedonia, si një vend i rajonit. Nga kjo analizë rezultoi, se legjislacioni shqiptar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal përafron me nivelet e legjislacionit italian dhe është më i plotë se legjislacioni maqedonas, megjithëse ky i fundit është më i ri se legjislacioni shqiptar.

Një veçori specifike e studimit është bërja pjesë e trajtimit teorik analiza dhe konkluzionet e dala nga mendimet e shfaqura nga 295 persona shqiptarë dhe të huaj, nëpërmjet pyetsorit. Në këtë grup të konsiderueshëm janë përfshirë: gjyqtarë e prokurorë në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, oficerë të policisë gjyqësore, të cilët midis të tjerave kanë si objekt të punës së tyre edhe aspekte të marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja në procesin penal,

studiues kryesisht të drejtimit e drejtë penale, si dhe juristë të tjerë me njohuri në këtë fushë. Gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave nëpërmjet pyetsorit është vërejtur, se:

- Të pyeturit e huaj kishin njohje të mirë të ligjit edhe kur i përkisnin rradhëve të oficerëve të policisë gjyqësore. Në të njëjtën kohë, ata paraqiteshin më korrektë në shpejtësinë e plotësimit të pyetsorit dhe ishin të gatshëm të jepnin informacione referuese.
- Gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave nëpërmjet pyetsorit, u vërejt se studiuesit në rastet e përgjigjes së tyre ishin të gatshëm dhe korrektë.
- Impresionues ishte fakti i gatishmërisë së përgjigjeve nga rradhët e avokatëve dhe avokati i popullit, të cilët kanë kthyer përgjigje të shpejta dhe kanë treguar gatishmëri edhe për informacione më tepër se thjesht pyetjet e pyetsorit.
- Gjyqtarët dhe prokurorët ishin më skeptikë për përgjegjen e pyetsorit.

Nga pyetsorët e personave shqiptarë kanë dalë kryesisht këto ide:

- 78.7% e të pyeturve mendon se legjislacioni shqiptar i brendshëm shqiptar në këtë fushë është i plotë;
- 66.3% e të pyeturve mendojnë, se Shqipëria duhet të zgjerojë marrëveshjet e bashkëpunimit me shtetet e tjera në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë;

- 28.2% e të pyeturve kanë shprehur mendimin që duhet të bëhen ndryshime të legjislacionit shqiptar në fushën e letërporosive ndërkombëtare, ndërkohë që 55.4% e tyre ka shprehur mendimin se ai nuk duhet të ndryshohet;
- 63.4% e të pyeturve mendojnë se procedurat ligjore në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal janë jo të efekshme, ndërsa 29.7% e tyre i mendon ato si të efekshme.

Nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve të pyetsorit kanë dalë në pah shkaqe të ndryshëm që ndikojnë në mosefektshmërinë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, nga të cilat si më të rëndësishmet janë renditur: koha e gjatë e marrjes së provave nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare, ngarkesa në punë, procedurat e tejzgjatura, mungesa e infrastrukturës; mungesa e profesionalizmit në përpilimin e një letërporosie; mungesa e mjeteve financiare; etj. Këto shkaqe janë në përgjithësi të ndërthurura me njëra – tjetrën dhe nuk mund të analizohen veçmas. Në kapitullin VI analizohen me hollësi shkaqet e përmendura më lart, dhe madje shkohet edhe më thellë duke dhënë ide dhe mendime për kapërcimin e tyre.

Ndër sugjerimet e dhëna për metodat e efektshme janë:

- Krijimi i grupeve të përbashkëta hetimore nga shtete të ndryshëm, me qëllim grumbullimin e provave dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të veprave penale;
- Zgjerimi i mundësisë së bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis institucioneve të hetimit të shteteve të ndryshme me persona kontakti për marrjen e të dhënave minimalisht

paraprake, duke shmangur rrugën e gjatë të dërgimit të një letërporosie dhe procedurave të gjata në të cilat kalon ajo.

- Letërporositë të ekzekutohen nga prokuroritë dhe gjykatat e apeleve, ose të krijohen seksione të veçanta brenda prokurorive apo gjykatave të shkallëve të para, me qëllim specializimin e prokurorëve apo gjyqtarëve që merren me letërporositë ndërkombëtare apo marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në përgjithësi.

Është me interes të theksohet, se përfundimet e pyetsorit të të huajve përputhen me ato të pyetsorit të personave shqiptarë, për sa i përket problemit të efektshmërisë së letërporosive ndërkombëtare. Konkretisht, 84% e personave të pyetur të huaj nuk i konsiderojnë letërporositë ndërkombëtare si mjete të efektshme për marrjen e provave në çështjet penale.

Për sa i përket sugjerimeve për mjetet më të efektshme, përveç atyre të përmendura nga shqiptarët, nga ana e tyre janë përmendur:

- ✓ JIT¹⁸ (Skuadrat e përbashkëta hetimore), të cilat do të shkurtonin kohën e humbur për të marrë të dhëna nëpërmjet letërporosive;
- ✓ Komunikimi i drejtpërdrejtë i prokurorëve apo hetuesve të shteteve të ndryshëm, gjë që mund të ishte e thjeshtë për shtetet anëtare të BE-së;
- ✓ Specializimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve që trajtojnë çështje të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;

¹⁸ Joint Investigation Team

- ✓ Krijimi i platformave të rrjeteve komunikuese të institucioneve, siç është përshebull EUROPOL, të cilat janë rrjete të sigurt, gjë që do të lejonte komunikimin ndërmjet tyre të autoriteteve nga shtete të ndryshëm;
- ✓ Krijimi i database me të dhëna, në të cilat të mund të kenë akses autoritetet nga shtete të ndryshëm;
- ✓ Krijimi i një prokurorie ndërkombëtare për shtetet e BE-së;
- ✓ Krijimi i një legjislacioni unik penal për vendet e EU-së dhe përafrimi i tij edhe nga shtetet e tjera të EU-së.

Nga analiza e raporteve vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm vihet re një tendencë rritjeje e numrit të rasteve të bashkëpunimit me autoritetet e huaja, sidomos vitet e fundit. Kjo gjë lidhet me faktin, se veprimtaria kriminale, veçanërisht format e organizuara të saj, ka kaluar kufijtë kombëtarë, duke u bërë gjithnjë e më shumë problem rajonal dhe global. Këta tregues janë shprehje e rritjes së bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe rritje e besueshmërisë në sistemin gjyqësor në Shqipëri.

Në kapitullin VII të studimit është bërë analiza e efektshmërisë së letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal. Nga kjo analizë është arritur në përfundimin që një letërporosi të jetë e efektshme dhe rezultatet e saj të kenë fuqinë e provave në proceset gjyqësore, duhet të plotësohen këto kushte:

- ❖ Ekzekutimi efektiv, që lidhet jo vetëm nga plotësimi i bazës juridike dhe sigurimi i

instrumentave të nevojshëm për ekzekutimin e një letërporosie, por edhe nga vullneti i autoriteteve që ekzekutojnë letërporositë në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç janë prokurorët dhe gjyqtarët.

- ❖ Informacioni i mjaftueshëm, që vjen nga aktet e përfshira në letërporositë ndërkombëtare, aktet ndërkombëtare, baza juridike e të drejtës së brendshme të shtetit kërkues. Këto burime të informacionit janë të pamjaftueshme, por më të efektshme kanë rezultuar komunikimet e drejtpërdrejta midis autoriteteve përkatëse që kanë kërkuar letërporosinë me ata që e ekzekutojnë letërporosinë.
- ❖ Vendosja e limiteve kohore, në mënyrë që letërporositë të ekzekutohen në kohë të arsyeshme, pa dëmtuar ecurinë e proceseve penale të shteteve kërkues.

Në përmbledhje të analizës së studimit, rezulton se është provuar hipoteza e këtij studimi:

“Pavarësisht arritjeve në përpunimin e një kuadri juridik të plotë dhe të përshtatshëm përsa i përket zbatimit të letërporosive ndërkombëtare si një nga format e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, praktika dëshmon ende mangësi, kapërcimi i të cilave do të kërkonte përf forcimin e dijeve dhe përkushtimit për zbatimin e akteve dhe dispozitave ekzistuese apo edhe ndërhyrjen në legjislacion për plotësimin e vakumeve eventuale”.

6.2. Kufizime dhe vështirësi për realizimin e këtij studimi

Realizimi i këtij studimi natyrisht nuk ka qënë një punë e lehtë. Ky studim kërkoi shumë mund dhe orë të gjata hulumtimi dhe kërkimi. Në këtë rrugëtim ka patur vështirësi

objektive dhe subjektive. Përkushtimi dhe përgjegjshmëria ndaj punës si prokurore, orët e zgjatura në punë, kërkonin sacrificë të kohës së lirë, privim nga aktivitete të tjera, si edhe përkushtim ndaj punës kërkimore studimore. Është rasti të theksohet, se profesioni si prokurore ka qënë sidoqoftë një avantazh i padiskutueshëm në përmbushjen e këtij studimi. Kjo ka bërë që të kuptohet në tërësi dhe në thellësi thelbi dhe specifikat e objektit të temës së përzgjedhur.

Megjithëse në studim janë trajtuar edhe aspekte të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal, në kryerjen e tij është bërë kujdes që ai të shtrihet në një aspekt më pak të studiuar, siç janë letërporositë ndërkombëtare si një nga llojet e bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin penal.

Vështirësi janë paraqitur edhe në mbledhjen e literaturës, pasi shumë është shkruar mbi të drejtën ndërkombëtare apo ekstradimin si një mënyrë e hershme e bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin penal, por më pak vëmendje i është kushtuar letërporosive ndërkombëtare, të cilat konsiderohen si një institut më i ri i së drejtës. Kjo është e dukshme sidomos pas krijimit të Gjykatave Ndërkombëtare Penale, të cilat kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe janë objekt i të drejtës penale ndërkombëtare. Megjithatë, me shumë kujdes janë mbledhur referenca të përshtatshme me temën e studimit edhe nga literatura e të drejtës ndërkombëtare apo ajo e të drejtës penale ndërkombëtare.

Vështirësi të tjera ka patur edhe në drejtim të marrjes së përgjigjeve të numrit të shumtë të pyetsorëve, për shkaqe të ndryshme që janë renditur në analizën e kapitullit të VI, si psh:

Numri i pyetsorëve të mbledhura nga punonjësit e sistemit të drejtësisë është arritur me këmbëngulje. Duke mos pasur përgjigje nëpërmjet rrugës elektronike, ata janë kontaktuar personalisht, shpesh herë edhe më shumë se dy herë. Shpesh janë shfrytëzuar edhe mbledhje, seminare apo trainime të ndryshme, duke i marrë përgjigjet e pyetsorit në formë të drejtpërdrejtë dhe duke i shkruar përgjigjet e pyetjeve të tyre aty për aty. Edhe kjo mënyrë kishte vështirësi, për arsye se personat e kontaktuar kërkonin kohë për të shfletuar ligjet apo literaturën për të dhënë përgjigjet e tyre sa më të plota. Vihej re një ngurrim i tyre për të dhënë mendime në lidhje me aspektin teorik të problemit, ndërkohë, ishte më e lehtë që ata t'i përgjigjeshin pjesërisht pyetsorit, për ato pyetje që lidheshin drejtpërdrejt me punën e tyre të përditshme dhe rastet e praktikës. Të gjitha këto lidhen me disa arsye, më konkretisht: Ngarkesa në punë; shpëputja nga leximi i literaturës me baza teorike, duke u marrë vetëm me zgjidhjen e problemeve sipas modeleve të gatshëm të rasteve të ngjashme nga praktika apo praktikave të krijuara në insitucionin e tyre; referimi në legjislacion të kufizuar sipas natyrës së punës, duke kryer veprimeve steriotipe me formularë të gatshëm; mendësia ose mosvlerësimi i punës studimore, duke e konsideruar atë humbje kohe; mungesë e korrektësisë, etj.

6.3. Rekomandime dhe sugjerime

Nga analiza dhe përfundimet e këtij studimi mund të nxirren disa sugjerime dhe rekomandime modeste.

Rekomandimet lidhen me ndryshime në legjislacion, megjithëse ato varen nga vullneti politik jo vetëm i Shqipërisë por edhe i shteteve të huaja, me të cilët duhet të nënshkruhen marrëveshje dy/shumëpalëshe, gjë që mund të shoqërohet me skepticizëm për mundësinë e përmbushjes së këtyre rekomandimeve.

Do të ishte e udhës që të shihej mundësia e ndryshimeve ligjore dhe e realizimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve të mëposhtme:

- **Të ndryshohet Kodit i Procedurës Penale, konkretisht neni 506 i tij, me qëllim që letërporositë për marrjen e provave të mos ekzekutohen nga prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore, por nga prokuroritë dhe gjykatat e apeleve,** siç është rasti i Italisë, pasi përqendrimi i ekzekutimit të letërporosive do të shoqërohej me rritje të nivelit profesional të autoriteteve që e ekzekutojnë një letërporosi, për arsye se ajo do të ishte në shtrirje më të madhe pjesë e punës së tyre. Një mundësi alternative, mund të jetë që **të krijohen seksione të veçanta brenda prokurorive apo gjykatave të shkallëve të para,** me qëllim specializimin e prokurorëve apo gjyqatarëve që merren me letërporositë ndërkombëtare apo marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në përgjithësi.
- **Lidhja e marrëveshjeve me shtete të tjerë të Europës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën penale,** duke pasur parasysh emigrimin e shqiptarëve në shumë shtete të tjerë përveç shteteve me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Greqia, Turqia, Maqedonia, Italia, Federata Ruse).

- **Të bëhen ndryshime në kapitullin e provave të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim që të krijohet baza ligjore e veprimeve të tilla, si: skuadrat e përbashkëta hetimore, hetimet sekrete, dëshmitë nëpërmjet video konferencave, etj, të parashikuara në protokollin e dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike.** Shqipëria ka qënë ndër vendet e parë që ka ratifikuar pa asnjë rezervë këtë protokoll me ligjin nr.8883 datë 18.04.2002, duke treguar dëshirën e mirë të Shqipërisë për të pranuar aktet ndërkombëtare dhe për të ecur në të njëjtin hap me vendet e përparuara europiane. Ndërkohë, megjithëse kanë kaluar më shumë se 13 vjet, në Kodin e Procedurës Penale shqiptare nuk gjen bazë ligjore mënyra dhe procedura që duhet të ndiqet për marrjen e këtyre provave. Ato nuk janë përfshirë edhe si mjete për kërkimin e provës në kreun III të Kodit të Procedurës Penale.
- **Të krijohen më shumë mundësi për bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis autoriteteve përkatës të shteteve të ndryshëm të përfshirë në bashkëpunim.** Dixhitalizimi i dokumentacionit dhe veprimtarisë së sistemit të prokurorive dhe gjykatave, mund të shfrytëzohet në këtë lloj bashkëpunimi nëpërmjet komunikimit në rrugë më të shkurtra elektronike, me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së provave nga shteti tjetër për një hetim sa më efektiv dhe në afate të arsyeshme.
- **Shtimi dhe inkurajimi i rasteve të komisioneve hetimore apo skuadrave të përbashkëta hetimore,** të cilat kanë rezultuar si mjete të efektshme në luftën kundër krimit, posaçërisht format e organizuara të tij.

- **Sigurimi i mjeteve monetare dhe instrumentave të nevojshëm** për të mbështetur llojet dhe format e reja të bashkëpunimit nëpërmjet letërporosive ndërkombëtare, siç janë ato të skuadrave të përbashkëta hetimore, hetimeve sekrete, dëshmitë nëpërmjet video konferencave, etj.
- Nisur nga problemet që ndeshen në praktikë, shpërndarja e normave në ligje të ndryshme është në disfavor të mundësisë së njohjes së tyre e më tej zbatimit të tyre në praktikë. Thënë kjo duke pasur parasysh faktin, që me ekzekutimin e letërporosive merret çdo prokuror apo gjyqtar i shkallës së parë, ku është edhe volumi më i madh i punës, pa pasur një përqëndrim të tyre në seksione të veçanta me staf të specializuar dhe të përgatitur. Në këtë këndvështrim do të ishte e udhës që **të gjithë këto dispozita të përmbledheshin në një akt të shkruar (manual)**, me të cilin autoritetet ekzekutuese të letërporosive të njiheshin me lehtësi, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe efektivitetit të ekzekutimit të letërporosive.
- Nisur nga problemet e ndeshura në praktikë, **drejtoritë e studimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të përgjithësojnë këto praktika, duke bërë edhe interpretime të tyre.** Kjo gjë, jo se nuk është bërë deri më sot, por do të ishte mirë që të zgjerohej për t'i ardhur sa më shumë në ndihmë punonjësve të organeve të drejtësisë.
- **Të vihet në dispozicion të prokurorëve apo gjyqtarëve më shumë literaturë,** duke filluar nga fletoret zyrtare e deri libra të doktrinës, gjë që nuk bëhet realisht, pavarësisht

se në legjislacion është parashikuar një gjë e tillë. Në pamundësi të kësaj, duke pasur parasysh edhe rrugët e ndryshme të përcjelljes së informacionit në kohën e sotme të një shoqërie të dixhitalizuar, t'i jepen rekomandime gjyqtarëve dhe prokurorëve për literaturë, tituj botimesh, website zyrtare për marrjen e informacioneve, etj.

Në përfundim të këtij studimi, vlen të theksohet që kjo fushë është shumë e gjërë dhe nuk mund të pretendohet që me të është bërë gjithçka, por është dhënë vetëm një kontribut modest duke iu bashkuar studimeve të mëparshme të fushës. Çështjet që janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore përbëjnë një objekt të punës kërkimore – shkencore më të thelluar në të ardhmen.

SHTOJCA I

P Y E T S O R

Ermira Tafani

Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Pedagoge me kohë të pjesëshme në Universitetin e Elbasanit

Shkolla doktrale, Universiteti European i Tiranës

E-mail: tafani_ermira@yahoo.com

Cel. 00355694113664

Të nderuar miq e kolegë, ky është një pyetsor mbi studimin tim doktoral të ndërmarrë që nga muaji janar 2012, me temë:

MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE TË SHQIPËRISË ME AUTORITET E

HUAJA NË PROCESIN PENAL

(Fokusuar në letërporositë ndërkombëtare).

Hyrje:

Ky pyetsor bëhet me qëllim mbledhjen e opinioneve të specialistëve të fushës objekt studimi, në funksion të hipotezës dhe pyetjeve të tij, përsa i përket faktit se sa i plotë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare është legjislacioni penal shqiptar, si dhe sa i efektshëm është ai. Në pyetsor është përfshirë jo vetëm kërkimi i informacionit por edhe i ideve tuaja.

Pjesëmarrja dhe konfidencialiteti:

Përgjigja ose jo e këtij pyetsori është plotësisht në dëshirën tuaj. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm për efekte analize në studim dhe do të jenë plotësisht konfidenciale. Identiteti juaj nuk do të përdoret në studim.

Ju lutem, kushtojini pak minuta përgjigjeve për pyetjet e mëposhtme!

Jepni informacion aq sa të mundeni, pa ju bezdisur. Nëse keni ndonjë paqartësi, më kontaktoni.

Ju faleminderit paraprakisht!

Emri dhe mbiemri (opsional):

Detyra aktuale dhe pozicione të mëparshme:

Pjesa e parë

Ju lutem rrethoni opsionin përkatës për pyetjet e mëposhtme:

1. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal a janë/kanë qënë pjesë e punës tuaj?

Po

Jo

2. A keni informacion mbi legjislacionin në fushën e letërporosive ndërkombëtare si pjesë e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në procesin penal?

Po

Jo

Pjesërisht

3. Sipas mendimit tuaj, a është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procesin penal?

Po

Jo

Nuk kam informacion

4. Sipas mendimit tuaj, a janë efektive procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare në procedimin e çështjeve penale?

Po

Jo

Nuk kam informacion

5. A është e nevojshme të bëhen ndryshime të legjislacionit penal shqiptar në këtë fushë?

Po

Jo

Nuk kam mendim

6. A mund të sugjeroni ndonjë mjet më efektiv në këtë fushë, sipas mendimit tuaj apo praktikave më të përparuara nga bota që mund të njihen nga ju?

Po

Jo

Nuk kam informacion

Pjesa e dytë

Nëse pyetjeve 3 – 6 të pjesës së parë i jeni përgjigjur me po se jo, lutemi specifikoni përgjigjen me mendimet/opinionet tuaja apo me sa jeni të informuar:

Pyetjet:

1. Sipas mendimit tuaj, pse është/nuk është i plotë dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me letërporositë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me autoritetet e huaja në procesin penal?

2. Pse janë/nuk janë efektive procedurat aktuale ligjore të letërporosive ndërkombëtare në procedimin e çështjeve penale?

3. Çfarë ndryshimesh mendoni se duhen bërë në legjislacionin penal shqiptar në këtë fushë?

4. A mund të sugjeroni ndonjë mjet më efektiv në këtë fushë, sipas mendimit tuaj apo praktikave më të përparuara nga bota që mund të njihen nga ju?

5. Nëse mundeni, përmendni raste të suksesshme të kësaj fushe nga praktika juaj, kolegëve tuaj apo institucionit ku ju bëni/keni bërë pjesë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

SHTOJCA II

S U R V E Y

Ermira Tafani

Prosecutor in District Prosecution of Elbasan, Albania

Part – time lecturer at the University of Elbasan, Albania

Doctoral School, European University of Tirana, Albania

E-mail: tafani_ermira@yahoo.com

Cel. 00355694113664

Dear colleagues!

This is a survey of my doctoral study since 2012, on:

JURIDICAL RELATIONS OF ALBANIA WITH OTHER COUNTRIES IN THE PENAL/CRIMINAL PROCESS (Focused on international rogatory requests)

Introduction:

The purpose of this interview is to gather opinions from the professionals on the effectiveness of the actual legal procedures of the interstates cooperation in the criminal cases.

Participation and confidentiality:

It's up to you to respond to the questions . Your answers will provide valuable insights and will be used only for analysis purpose. The survey is completely anonymus with no identifying information, unless you choose to provide it.

Please take a few minutes to answer to these questions.

Feel free to give information as much as you can, without disturbing you.

Thank you!

Name and surname (optional):

Country:

Actual and previous duties:

Questions

1. In your opinion, are the actual legal procedures effective in international (interstates) relations on proceeding the criminal cases, focused on international rogatory requests?

2. Would you describe any good practice of your country in this area?

3. Would you suggest any tool to be more effective?

Thank you for your cooperation!

BIBLIOGRAFIA

Literatura/Burime Dytësore

Bantekas, I., Nash, S. (2003), *International Criminal Law*, 2nd ed., CAVENDISH, London, UK

Barbe, E. (1997) *Schéma des procédures d'enquête comparées*, in Petites affiches n° 72, numéro spécial, "Vers un espace judiciaire européen pour les enquêtes criminelles", 16 Juin 1997, Pg. 3-4

Bassiouni, M.C. (1997), *International Criminal Law Conventions and their Penal Provisions*, Irvington-on-Houston NY, USA

Bassiouni, M.C. (2003), *Introduction to International Criminal Law*, Ardsley, Transnational Publishers NY, USA

Bassiouni, M.C. (2008), *International Criminal Law*, 3rd ed., Martin Nijhoff Publishers, Leiden, Austria

Bertossa, B. "L'indispensable coopération judiciaire en Europe", gjendet në www.cees-europe.fr

Bianku, L. (2001), *Të drejtat e Njeriut në Europë (Jurisprudencë dhe komente)*, Qendra Europiane, Tiranë, Albania

Brownlie, I. (1995), *Principles of Public International Law*, 4th ed., Clarendon Press – Oxford, UK

Bolt, A. (1993), *Practical problems in mutual assistance in criminal matters*, në: Commonwealth Law Bulletin, Volume 19, Issue 4, 1993, pages 1911-1916, publikuar online më 12 Gusht 2010, marrë më 23.11.2014

Buna, Gj. (2012), *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me interpretime të Gjykatës Kushtetuese, përditësuar edhe me ndryshimet 2012*, ALBJURIS, Tiranë, Shqipëri

Byroja juridike pranë Këshillit të Ministrave (1982), *Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, Shqipëri

Cassese, A. (2008), *International Criminal Law*, 2nd ed., Oxford University Press, Oxford, UK

Cassese, A. (2009), *The Oxford Companion to International Criminal Justice*, University Press, Oxford, UK

Cassese, A., Gaeta, P., Baig, L., Fan, M., Gosnell, C., Whiting, A. (2012), *Cassese's International Criminal Law*, 3rd ed., Oxford University Press, Oxford, UK

Chiavario, M. (2007), *Diritto Processuale Criminale (Profilo istituzionale)*, 3a ed., UTET, Torino, Italy

Codice di Procedura Penale e leggi complementari (1995), ESSELIBRI SIMONE, Napoli, Italia

Colangelo, A.J. (2014), *What is extraterritorial jurisdiction*, në: Cornell Law Review, vol. 99:1303, gjendet në http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2363695, marrë më 23.11.2014

Conso, G. & Grevi, V. (2003), *Compendio di Procedura Penale*, seconda edizione, Cedam, Padova, Italia

Cryer, R., Friman, H., Robinson, D., Wilmschurst, E. (2010), *An Introduction to International Criminal Law and Procedure*, 2nd ed., Cambridge University Press, Cambridge, UK

Dallara, C. (2014), *Democracy and Judicial Reforms in South – East Europe between the EU and the legacy of the past*, gjendet në <http://www.springer.com/978-3-319-04419-4>, marrë më 20.12.2014

Dixon, M. (2010), *E Drejta Ndërkombëtare*, AIIS, Tiranë, Shqipëri

Duka, V. (2007), *Historia e Shqipërisë 2012 – 2007*, SHBLU, Tiranë, Shqipëri

Elezi, I. (2001), *Komentar i shtesave dhe ndryshimeve në kodin penal me ligjin nr.8733 datë 24.01.2001*, albin, Tiranë, Shqipëri

Elezi, I. (2001), *Vështrim i shkurtër Historik i Drejtësisë Penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, gjendet në <http://drejtësiashqiptare.com/>, marrë më 20.04.2011

Elezi, I. (2002), *E Drejta Penale (pjesa e posaçme)*, ShBLU, Tiranë, Shqipëri

Elezi, I. (2005), *Disa probleme në lidhje me Kodin Penal*, në: Jeta juridike nr.1, Tetor 2005, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, Shqipëri, fq. 61 – 72

Elezi, I., Kaçupi & S., Haxhia, M. (1999), *Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, SHBLU, Tiranë, Shqipëri

Elezi, I., Kaçupi, S. & Haxhia, M. (2006), *Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Shtëpia Botuese Geer, Tiranë, Shqipëri

Encyclopedia of Public International Law V.II (1995), EPIL, North – Holland

Fiandaka, G. & Musco, E. (2001), *Dirito Penale (Parte Generale)*, Zanichelli editore, Bologna, Italia

Fletcher, M., Loof, R. & Gilmore, B. (2008), *EU Criminal Law and Justice*, Edward Elgar Publishing Ltd, London, UK

Gatti, G. (1995), *Codice di Procedura Penale e Leggi Complementari*, Esselibri – Simone, Napoli, Italia

Gomien, D. (1998), *Udhëzues i shkurtër për Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut*, Këshilli i Europës, Tiranë, Shqipëri

Goxha, J. (2013), *Drejtësia shqiptare dhe procesi i integritetit evropian*, në: Revistë shkencore Pavarësia, nr.1/2013, faqe 45 – 54, gjendet në <http://www.unipavaresia.edu.al>, marrë më 17.12.2014

Halili, R. (1985), *Sanksionet penale sipas të drejtës zakonore në Kosovë*, Prishtinë, Kosovë

Harfield, C. (2003), *A review essay on Models of Mutual Legal Assistance: Political Perspectives on International Law Enforcement Cooperation Treaties*, në: International Journal of Comparative and Applied

Criminal Justice, Volume 27, Issue 2, 2003, faqe 221 – 241, publikuar on-line më 1 Qershor 2011, marrë më 23.11.2014

Hoxha, A. (2011), *Ekstradimi dhe urdhëri European i Ndalimit*, Botimet Morava, Tiranë, Shqipëri

Ikonomi, L. (2006), *Filozofia e së drejtës*, Ekspres, Tiranë, Shqipëri

Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, (1962), *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë shek. VIII - XV, Vëllimi II*, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, Shqipëri

Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I. (2012), *Procedura Penale*, Botimet Morava, Tiranë, Shqipëri

Kaçupi, S. (2002), *Probleme teorike dhe praktike që dalin para gjykatës dhe prokurorisë si rezultat i ndryshimeve të bëra në pjesën e përgjithshme të Kodit n Penal me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001*, në: Trajtime juridike (Dhjetor 2000 – Korrik 2002), 2002, DANIDA, Tiranë, Shqipëri

Krisafi, K. (2009), *Diplomaci pas lufte*, Dita 2000, Tiranë, Shqipëri

Krisafi, K. (2014), *E drejta ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme në Kushtetutën e Republikës së Kosovës*, në: Academe, Vol.3 No.1, Pranverë 2014, Onufri, Tiranë, Shqipëri

Krisafi, K. (2014), *Organizimi politik në trojet shqiptare*, UET Press, Tiranë

Kodi i procedurës penale dhe legjislacioni lidhur me të: i përditësuar dhe me praktikë gjyqësore, (2013), AlbJuris, Tiranë, Shqipëri

Kodi penal: i përditësuar dhe me praktikë gjyqësore, (2013), AlbJuris, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (1994), *Të drejtat e njeriut në të drejtën ndërkombëtare – Akte themelore të Këshillit të Evropës dhe të KSBE-së*, Albinform, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (1994), *Të drejtat e njeriut – Përmbledhje aktesh ndërkombëtare*, Albinform, Tiranë, Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me interpretime të Gjykatës Kushtetuese, (2013), AlbJuris, Tiranë, Shqipëri

Lelçaj, L. (2008), *Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma gjyqësore në kuadër të Statutit të Romës*, në: Jeta Juridike, Nr.3, Mars 2008, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, Shqipëri

Muçi, Sh. (2007), *E drejta penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Botimet Dudaj, Tiranë, Shqipëri

Puto, A., (2010) *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Botimet Dudaj, Tiranë, Shqipëri

Prandel, J., Corstens, G. & Vermeulen, G. (2010), *E drejta penale evropiane*, Botimet Papirus, Tiranë, Shqipëri

Prost, P., *Breaking down the barriers: International cooperation in combating transnational crime*, gjendet në: www.oas.org/juridico/mla/en/can/en_can_prost.en.html, marrë më 02.09.2012

Riz, R. (2006), *Lineamenti di diritto criminale* (Parte Generale), 5a ed., CEDAM, Padova, Italia

Shaw, M. N. (2008), *International Law*, 6th ed., Cambridge University Press, UK

Stigen, J. (2008), *The relationship between the International Criminal Court and National Jurisdictions – The principle of complementarity*, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden, The Netherlands

Tonino, P. (2011), *Manuale di Procedura Penale*, dodicesima edizione, Giuffrè Editore, Milano, Italia

Xhafo, J. (2009), *E drejta penale ndërkombëtare*, Shtëpia Botuese Geer, Tiranë, Shqipëri

Uka, Nj. (2011), *Fjalor i drejtësisë*, “ILARI” P.F., Tiranë, Shqipëri

Zaganjori, Xh. (2005), *E drejta ndërkombëtare në gjykimet dhe vendimet e gjykatave kombëtare*, në: Jeta Juridike, Nr.2, Dhjetor 2005, Erik Botime, Tiranë, Shqipëri

Zaganjori, Xh. (2012), *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*, Adelprint, Tiranë, Shqipëri

Zahar, A. dhe Sluiter, G. (2008), *International Criminal Law: A Critical Introduction*, Oxford University Press, Oxford, UK

Burime Parësore

Fletorja Zyrtare nr.221, e Shtunde 18 Dhjetor 1926, Botohet prej Ministris së P. të Mbrendëshme, Tiranë

Fletorja Zyrtare nr.16, e Merkure 16 Mars 1938, Botohet prej Zyrës së Shtypit, Tiranë

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (2006), *Raporti i të Drejtave të Njeriut në Shqipëri* (1997 – 2003), Tiranë

Konventa Evropiane “Për ekstradimin” dhe dy protokollet e saj shtesë, Flet.Zyrtare Nr.10, Faqe:6

Ligj Nr.7491, “Për dispozitat kryesore Kushtetuese” (i ndryshuar), Dt. Aktit: 29.04.1991, Dt. Miratimit: 29.04.1991, Fletore zyrtare nr. 4, fq. 145, Tiranë

Ligj Nr.7561 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 /Për dispozitat kryesore kushtetuese/” dt. Dt. Aktit: 29.04.1992, Dt. Miratimit: 29.04.1992, Fletore zyrtare nr. 2, fq. 81, Tiranë

Ligj Nr.7760, “Për ratifikimin e /Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale/”, Dt. Aktit: 14.10.1993, Dt. Miratimit: 29.10.1993, Fletore zyrtare nr. 12, fq. 787, Tiranë

Ligj Nr.7895, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar) , Dt. Aktit: 27.01.1995, Dt. Miratimit: 27.01.1995, Fletore zyrtare nr. 2, fq. 23, Tiranë

Ligj Nr.7905, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Dt. Aktit: 21.03.1995, Dt. Miratimit: 05.04.1995, Fletore zyrtare nr. 5, fq. 159, Tiranë

Ligj Nr.8036, “Për ratifikimin e /Konventës për ndihmën e ndërsjelljes gjyqësore në fushat civile, tregtare dhe penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë/”, Dt. Aktit: 22.11.1995, Dt. Miratimit: 30.11.1995, Fletore zyrtare nr. 25, fq. 1105, Tiranë

Ligj Nr.8061, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Federatës Ruse për ndihmë juridike dhe marrëdhëniet juridike për çështje civile, familjare dhe penale/”, Dt. Aktit: 08.02.1996, Dt. Miratimit: 16.02.1996, Fletore zyrtare nr. 2, fq. 35, Tiranë

Ligj Nr. 8265, “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”, Dt. Aktit: 18.12.1997, Dt. Miratimit: 23.12.1997, Fletore zyrtare nr. 19, fq. 453, Tiranë

Ligj Nr.8299, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për ekstradimet/”, Dt. Aktit: 04.03.1998, Dt. Miratimit: 12.03.1998, Fletore zyrtare nr. 7, fq. 254, Tiranë

Ligj Nr.8304, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ndihmën juridike në fushën civile dhe penale/”, Dt. Aktit: 12.03.1998, Dt. Miratimit: 21.03.1998, Fletore zyrtare nr. 7, fq. 260, Tiranë

Ligj Nr.8322, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë”, Dt. Aktit: 02.04.1998, Dt. Miratimit: 09.04.1998, Fletore zyrtare nr. 10, fq. 353, Tiranë

Ligj Nr.8413, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar/”, Dt. Aktit: 01.10.1998, Dt. Miratimit: 01.10.1998, Fletore zyrtare nr. 25, fq. 990, Tiranë

Ligj Nr.8417, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, Dt. Aktit: 21.10.1998, Dt. Miratimit: 21.10.1998, Fletore zyrtare nr. 28, fq. 1073, Tiranë

Ligj Nr.8427, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL”, datë 14.12.1998

Ligj Nr.8497, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës /Për transferimin e procedimeve në çështjet penale/”, Dt. Aktit: 10.06.1999, Dt. Miratimit: 29.06.1999, Fletore zyrtare nr. 21, fq. 681, Tiranë



Ligj Nr.8498, *“Për ratifikimin e /Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale/ dhe të protokollit shtesë” (i ndryshuar)*, Dt. Aktit: 10.06.1999, Dt. Miratimit: 29.06.1999, Fletore zyrtare nr. 21, fq. 697, Tiranë

Ligj Nr.8499, *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës /Për transferimin e personave të dënuar/”*, Dt. Aktit: 10.06.1999, Dt. Miratimit: 29.06.1999, Fletore zyrtare nr. 22, fq. 7ë, Tiranë

Ligj Nr.8512, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara/”*, Dt. Aktit: 15.07.1999, Dt. Miratimit: 22.07.1999, Fletore zyrtare nr. 23, fq. 809, Tiranë

Ligj Nr.8541, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes së SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar/”*, datë 21.10.1999

Ligj Nr.8623, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar/”*, datë 15.6.2000

Ligj Nr.8639, *“Për ratifikimin e /Kartës për organizimin e funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar/”*, datë 13.7.2000

Ligj Nr.8642, *“Për ratifikimin e Konventës Europiane /Për shtypjen e terrorizmit/”*, datë 13.07.2000

Ligj Nr.8646, *“Për ratifikimin e Konventës Europiane /Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit/”*, datë 20.7.2000

Ligj Nr.8705, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore/”* datë 01.12.2000

Ligj Nr.8722, *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në /Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope/”*, datë 26.12.2000

Ligj Nr.8724, *“Për ratifikimin e /Konventës europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht/”*, datë 26.12.2000

Ligj Nr.8733, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 /Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë/”*, Dt. Aktit: 24.01.2001, Dt. Miratimit: 24.01.2001, Fletore zyrtare nr. 4, fq. 100, Tiranë

Ligj Nr.8778, *“Për ratifikimin e /Konventës penale për korrupsionin/”* datë 26.4.2001, ndryshuar me ligjin nr.9369, datë 14.04.2005

Ligj Nr.8865, *“Për ratifikimin e /Konventës ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit/”*, datë 14.03.2002

Ligj Nr.8882, *“Për ratifikimin e Protokollit shtesë të /Marrëveshjes Europiane për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore dhe të raportit shpjegues /”*, Dt. Aktit: 18.04.2002, Dt. Miratimit: 18.04.2002, Fletore zyrtare nr. 16, fq. 492, Tiranë

Ligj Nr.8883, *“Për ratifikimin e “Protokollit të dytë shtesë të /Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike/”*, Dt. Aktit: 18.04.2002, Dt. Miratimit: 18.04.2002, Fletore zyrtare nr. 17, fq. 509, Tiranë

Ligj Nr.8920, *“Për ratifikimin e /Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar/ dhe dy protokolleve shtesë të saj”*, datë 11.07.2002

Ligj Nr.8945, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme/”*, Dt. Aktit: 03.10.2002, Dt. Miratimit: 03.10.2002, Fletore zyrtare nr. 67, fq. 1888, Tiranë

Ligj Nr.8984, *“Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”*, datë 23.12.2002

Ligj nr.9019, *“Për ratifikimin e /Protokollit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali/”*, datë 06.03.2003

Ligj nr.9068, *“Për ratifikimin e /Konventës Europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale/”*, datë 15.05.2003

Ligj Nr.9081, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale”*, nënshkruar në Tiranë më 02.05.2003”, Dt. Aktit: 19.06.2003, Dt. Miratimit: 19.06.2003, Fletore zyrtare nr. 53, fq. 2153, Tiranë

Ligj Nr.9169, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të 21 marsit 1983 /Për transferimin e personave të dënuar/ ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë”*, Dt. Aktit: 22.01.2004, Dt. Miratimit: 22.01.2004, Fletore zyrtare nr. 5, fq. 135, Tiranë

Ligj Nr.9214, *“Për ratifikimin e “Marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit”*, nënshkruar në Kajro më 2.4.2002”, Dt. Aktit: 01.04.2004, Dt. Miratimit: 01.04.2004, Fletore zyrtare nr. 27, fq. 1331, Tiranë

Ligj Nr.9230, *“Për ratifikimin e /Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit/”*, datë 13.05.2004

Ligj Nr.9245, *“Për ratifikimin e /Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin/”*, datë 24.06.2004

Ligj Nr.9307, *“Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”*, Dt. Aktit: 04.11.2004, Dt. Miratimit: 04.11.2004, Fletore zyrtare nr. 90, fq. 6418, Tiranë

Ligj Nr.9427, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të BE-sëlgjikës për bashkëpunimin policor/”, datë 13.10.2005

Ligj Nr.9492, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”, datë 13.3.2006

Ligj Nr.9496, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar/”, Dt. Aktit: 20.03.2006, Dt. Miratimit: 20.03.2006, Fletore zyrtare nr. 28, fq. 940, Tiranë

Ligj Nr.9500, “Për ratifikimin e protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij”, datë 03.04.2006

Ligj Nr.9505, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit/”, Dt. Aktit: 03.04.2006, Dt. Miratimit: 03.04.2006, Fletore zyrtare nr. 40, fq. 1249, Tiranë

Ligj Nr.9539, “Për disa ndryshime në ligjin nr.8498, datë 10.06.1999 /Për ratifikimin e ‘Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale’ dhe të protokollit shtesë/”, Dt. Aktit: 22.05.2006, Dt. Miratimit: 22.05.2006, Fletore zyrtare nr. 57, fq. 1627, Tiranë

Ligj Nr.9590, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare/”, Dt. Aktit: 27.07.2006, Dt. Miratimit: 27.07.2006, Fletore zyrtare nr. 87, fq. 2955, Tiranë

Ligj Nr.9604, “Për ratifikimin e /Konventës së bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore/”, Dt. Aktit: 11.09.2006, Dt. Miratimit: 11.09.2006, Fletore zyrtare nr. 107, fq. 4199, Tiranë

Ligj Nr.9686, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 /Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë/” të ndryshuar”, Dt. Aktit: 26.02.2007, Dt. Miratimit: 26.02.2007, Fletore zyrtare nr. 27, fq. 489, Tiranë

Ligj Nr.9753, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën /Për akses ndërkombëtar në drejtësi/”, Dt. Aktit: 14.06.2007, Dt. Miratimit: 14.06.2007, Fletore zyrtare nr. 80, fq. 2371, Tiranë

Ligj Nr.9799, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane në luftën kundër kriminalitetit/”, Dt. Aktit: 10.09.2007, Dt. Miratimit: 10.09.2007, Fletore zyrtare nr. 124, fq. 3538, Tiranë

Ligj Nr.9871, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale të 20 prillit 1959/”, Dt. Aktit: 11.02.2008, Dt. Miratimit: 11.02.2008, Fletore zyrtare nr. 26, fq. 1229, Tiranë

Ligj Nr.10155, “Për ratifikimin e / Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit/”, Dt. Aktit: 15.10.2009, Dt. Miratimit: 15.10.2009, Fletore zyrtare nr. 150, fq. 6783, Tiranë

Ligj Nr.10162, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit/”, datë 15.10.2009

Ligj Nr.10191, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar/”, Dt. Aktit: 03.12.2009, Dt. Miratimit: 03.12.2009, Fletore zyrtare nr. 181, fq. 8065, Tiranë

Ligj Nr.10193, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), Dt. Aktit: 03.12.2009, Dt. Miratimit: 03.12.2009, Fletore zyrtare nr. 181, fq. 8080, Tiranë

Ligj Nr.10265, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe perkursorëve/”, Dt. Aktit: 15.04.2010, Dt. Miratimit: 14.04.2010, Fletore zyrtare nr. 51, fq. 1861, Tiranë

Ligj Nr.10344, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar/”, Dt. Aktit: 04.11.2010, Dt. Miratimit: 04.11.2010, Fletore zyrtare nr. 159, fq. 8346, Tiranë

Ligj Nr.10378, “Për ratifikimin e /Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për transferimin e personave të dënuar/”, Dt. Aktit: 24.02.2011, Dt. Miratimit: 24.02.2011, Fletore zyrtare nr. 22, fq. 783, Tiranë

Ligj Nr. 10426, “Për ratifikimin e protokollit të tretë shtesë të konventës europiane /Për ekstradimin/”, Dt. Aktit: 02.06.2011, Dt. Miratimit: 02.06.2011, Fletore zyrtare nr. 77, fq. 3134, Tiranë

Ligj Nr.23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 /Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë/ të ndryshuar”, Dt. Aktit: 01.03.2012, Dt. Miratimit: 01.03.2012, Fletore zyrtare nr. 26, fq. 1299, Tiranë

Ligj Nr.53/2012, “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it”, Dt. Aktit: 10.05.2012, Dt. Miratimit: 10.05.2012, Fletore zyrtare nr. 51, fq. 2615, Tiranë

Ligj Nr.100/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10193, datë 03.12.2009 /Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale/”, Dt. Aktit: 18.03.2013, Dt. Miratimit: 18.03.2013, Fletore zyrtare nr. 45, fq. 2035, Tiranë

“Për një rend publik european”, Vendime të zgjedhura të Gjykatës Europiane të të Drejtave të njeriut, Vëllimi I (2001), Tiranë

Qendra e Publikimeve Zyrtare, (2005), *Përmbledhje me Rekomandime të Këshillit të Europës për Prokurorinë*, Tiranë, Shqipëri

Qendra e Publikimeve Zyrtare, (2009), *Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Europiane për të drejtat e Njeriut Kundër Shqipërisë*, Tiranë, Shqipëri

Qendra e Publikimeve Zyrtare, (2010), *Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë*, Tiranë, Shqipëri

Qendra e Publikimeve Zyrtare, (2010), *Përmbledhje Vendimesh Unifikuese të Gjykatës së Lartë* (2000 – 2010), Tiranë, Shqipëri

Burime nga Interneti

<http://conventions.coe.int>

<http://copac.ac.uk/search?&title=mutual+legal+assistance>

<http://drejtësiashqiptare.com/>

http://ec.europa.eu/justice/criminal/judicial-cooperation/legal-assistance/index_en.htm

http://en.wikipedia.org/wiki/History_of_Albania

<http://legislationline.org>

<http://wikipedia.org>

<http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ListeTraites.asp?MA=20&CM=7&CL=ENG>

<http://www.ambalbania.it>

<http://www.europol.europa.eu/>

http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

<http://www.librarialigjore.org>

<http://www.mpj.uranushost.com/dokumenta/aktet%20e%20okb-se.pdf>

<http://www.pp.gov.al/>

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet_Dypaleshe_me_te_gjithavendet.pdf

http://www.siofa.gov.mk/data/file/ustav_ustavni_amandmani_al.pdf

bulevardi: Gjergj Fishta, (ish npv nr.2)
tel: 068 20 16 616
info@uet.edu.al
www.uet.edu.al



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE TË SHQIPËRISË
ME AUTORITETET E HUAJA NË PROCESIN PENAL
(Fokusuar në letërporositë ndërkombëtare)
Ermira Tafani, Janar 2016

<http://www.tandfonline.com/action/doSearch?AllField=Mutual+Legal+Assistan>

<http://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/index.html>

http://www.unodc.org/documents/Publications/Mutual_Legal_Assistance_Ebook_E.pdf